

الله
رسول
محمد

Adnan Oktar
HARUN JAHJA

PARIMET THEMELORE TË ISLAMIT

Thuaj: "O njerëz, ju erdhi e Vërteta nga Zoti
juaj. Kush udhëzohet në rrugën e drejtë, ai është
udhëzuar për dobinë e vet dhe kush e humb
rrugën e drejtë, ka humbur në dëmin e vet,
ndërsa unë nuk jam mbikëqyrësi juaj"

(Sure Junus: 108)



RRETH AUTORIT

Adnan Oktar, i cili shkruan nën pseudonim Harun Jahja, ka lindur në Ankara në vitin 1956. Që nga viti 1980, autori ka botuar shumë libra mbi çështjet lidhur me besimin, shkencën dhe politikën. Ai është i njohur si autor i veprave të rëndësishme të njohura

për demaskimin e mashtrimit të evolucionistëve, pretendimet e tyre të pavlefshme, dhe lidhjeve të errëta në mes të Darwinizmit dhe ideologjive të tilla të përgjakshme si fashizmi dhe komunizmi.

Të gjitha veprat e autorit kanë një qëllim të vetëm, të përcjellin mesazhin e Kur'anit, të inkurajojnë lexuesit të marrin në konsideratë besimin bazë lidhur me çështje të tilla si ekzistenca e Zotit, unitetit dhe botën tjetër, dhe për të ekspozuar e vënë në dukje themelet e sistemeve të dobëta dhe të ideologjive çoroditëse jofetare. Më shumë se 300 veprat e tij, të përkthyer në 72 gjuhë të ndryshme, gëzojnë dhe kanë një rrjet të gjerë lexuesish në të gjithë botën.

Me vullnetin e Zotit, librat e Harun Jahja do të jetë një mjet përmes të cilit njerëzit në shekullin njëzet e një do të arrijnë paqen, drejtësinë, dhe lumturinë e premtuar në Kuran.

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

اللَّهُ
رَسُولُهُ
مُحَمَّدٌ

KOPERTINA E PRAPME

Ky libër është shkruar për ata të cilët së voni janë njohur me Islamin dhe të cilët tashmë kanë dijëni dhe një shkallë të bindjes ndaj Islamit, por e cila mund të ketë pasur origjinën e tyre në burime të papërshtatshme apo të pabaza. Informacioni të cilin njerëzit e grumbullojnë për Islamin është, në të shumtën e rasteve, i kufizuar në atë që paraqesin familjet e tyre, shokët apo librat e caktuara. Mirëpo, informacionit të saktë për Islamin mund t'i qase-mi vetëm duke iu referuar Kuranit, burimit të Islamit.

Kurani është shpallja e fundit e zbritur prej Zotit, si udhëzim për njerëzimin. I vetmi libër i shpallur nga Zoti që ka mbijetuar plotësisht e pandryshuar, është Kurani. Ajo përmban vetëm atë që është shpallur nga Zoti. Zoti zbriti porosinë e Tij, ose me anë të Xhibrilit, ose përmes frymëzimit të drejtpërdrejt të Profetit Muhammed. Kurani përbëhet vetëm prej asaj që iu shpall Profetit Muhammed.

Kurani është udhëzim për të udhëhequr njeriun në rrugën e drejtësisë. Është shpallje e Zotit, e zbritur për të nxjerrë njeriun nga errësira në dritë. Me anë të Kuranit, Zoti ynë, Krijuesi i njeriut dhe i të gjitha gjallesave, udhëzon robërit e Tij në rrugën e drejtë.

Në këtë libër, bazuar në informacionin e ofruar nga Kurani, do të bëjmë fjalë për Zotin, vetitë e Tij, qëllimin e vërtetë të ekzistencës sonë në këtë botë, çfarë duhet të bëjmë për të vepruar në pajtim me të, realitetin e vdekjes dhe atë që na pret, jetën e përtejme.

Ju rekomandojmë që ta lexoni këtë libër me kujdes dhe të mendoni për mësimet e tij, pasi që ato kanë për qëllim që t'ju afrojnë më shumë me Krijuesin tuaj dhe t'ju tregojnë rrugën e lumturisë dhe shpëtimit të përjetshëm.

PARIMET THEMELORE TË ISLAMIT

Thuaj: “O njerëz, ju erdhi e Vërteta nga Zoti juaj. Kush udhëzohet në rrugën e drejtë, ai është udhëzuar për dobinë e vet dhe kush e humb rrugën e drejtë, ka humbur në dëmin e vet, ndërsa unë nuk jam mbikëqyrësi juaj”.

(Sure Junus: 108)

HARUN JAHJA
(ADNAN OKTAR)



PARIMET THEMELORE TË ISLAMIT

Thuaj: "O njerëz, ju erdhi e Vërteta nga Zoti juaj. Kush udhëzohet në rrugën e drejtë, ai është udhëzuar për dobinë e vet dhe kush e humb rrugën e drejtë, ka humbur në dëmin e vet, ndërsa unë nuk jam mbikëqyrësi juaj".

(Sure Junus: 108)

HARUN JAHJA
(Adnan Oktar)



DY FJALË RRETH AUTORIT DHE VEPRAVE TË TIJ

I njohur me emrin HARUN JAHJA, Adnan Oktar, u lind në Ankara në vitin 1956. Pasi kreu studimet fillore dhe të mesme në Ankara, ai studioi për arte në Universitetin Mimar Sinan në Stamboll dhe filozofi në universitetin e Stambollit. Që nga viti 1980, ai ka botuar mjaft libra në lidhje me çështje politike, shkencore, dhe fetare. Harun Jahja është njohur mirë si autor i veprave të rëndësishme, të cilat zbulojnë mashtrimin e evolucionistëve, pohimet e tyre të pavërteta dhe lidhjet e errëta midis Darwinizmit dhe ideologjive gjakësore, të tilla si: fashizmi dhe komunizmi. Veprat e Harun Jahjasë, të përkthyer në 57 gjuhë të ndryshme, përbëjnë një koleksion prej mëse 45,000 faqesh me 30,000 ilustrime. Pseudonimi i tij është një ndërthurje e emrave të Harunit (Aaron) dhe Jahja (John), në kujtim të dy Profetëve të nderuar, të cilët luftuan kundër mohimit të besimit. Vula e Profetit në librat e tij është një simbol i cili është i lidhur me përmbajtjen e tyre. Ky simbol paraqet Kur'anin (Shpalljen e Fundit) dhe Profetin Muhamed (paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të), Profetin e fundit. Nën dritën e udhëzimit të Kur'anit dhe Sunnetit (traditës dhe mësimëve të Profetit), autori i ve vetes si qëllim të hedhë poshtë çdo ngrehinë të ideologjive që mohojnë fenë dhe të thotë "fjalën e fundit" në mënyrë që ta bëjë të heshtë çdo kundërshtim ngritur kundër fesë. Ai e përdor vulën e Profetit të fundit (paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të), i cili arriti urtësinë më të lartë dhe përsosmërinë morale, si një shenjë të qëllimit të tij për të ofruar fjalën e fundit.

Të gjitha veprat e Harun Jahja kanë një qëllim të përbashkët: të japin mesazhin e Kur'anit, të inkurajojnë lexuesit për të menduar mbi çështje që kanë të bëjnë me besimin, si për shembull, ekzistenca e Allahut dhe njëshmëria e Tij dhe besimi në Botën Tjetër dhe njëkohësisht të nxjerrë në pah rrënjët e kalbura të sistemeve antifetare dhe ideologjive të devijuara.

Harun Jahja gëzon një rang të gjerë lexuesish në shumë vende të botës, që nga India në Amerikë, nga Anglia në Indonezi, Poloni, e deri në Bosnjë, Spanjë, Brazil, Malajzi, Itali, Francë, Bullgari, e deri në Rusi.

Disa nga librat e tij mund të gjenden në gjuhën Angleze, Frënge, Gjermane, Spanjolle, Italiane,



Portugeze, Urdu, Arabe, Shqipe, Kineze, Dhivehi (folur në ishujt Mauritius) Ruse, Serbo-Croate (Boshnjake), Polake, Malaje, Turke, Uygur, Indoneziane, Bengali, Daneze dhe Suedeze.

Duke qënë mjaft të vlerësuara në të gjithë botën, këto vepra kanë shërbyer për shumë njerëz si mjet për të gjetur besimin në Zot dhe për të arritur një depërtim më të thellë në besimin e tyre. Mençuria dhe sinqeriteti që i karakterizojnë librat e tij, së bashku me një stil të veçantë që është i lehtë për t'u kuptuar, ndikon drejtpërdrejt çdokënd që i lexon. Ata që i studiojnë me kujdes këta libra, nuk mund të mbrojnë më ateizmin apo ndonjë ideologji tjetër të devijuar apo filozofi materialiste, sepse këta libra karakterizohen nga një ndikim i shpejtë, përfundime të qarta dhe janë të pakundërshtueshëm. Edhe nëse këta njerëz do të vazhdojnë të këmbëngulin në të tyren, nuk do të jetë gjë tjetër veçse një këmbëngulje të kotë, sepse këta libra përmbysin ideologji të tilla që nga themelet. Të gjitha lëvizjet bashkëkohore antifetare tashmë mbrohen ideologjikisht, falë librave të shkruar nga Harun Jahja.

Kjo është, pa dyshim, një rezultat i urtësisë dhe dritës së Kur'anit. Autori në mënyrë modeste dëshiron të shërbejë si një mjet në kërkimin njerëzor të rrugës së drejtë të Allahut. Prej botimit të këtyre materialeve nuk kërkohet asnjë përfitim material.

Ata njerëz që inkurajojnë të tjerët për të lexuar këto libra, për të hapur mendjet dhe zemrat e tyre dhe për t'i udhëzuar ata të bëhen robër të devotshëm të Allahut, kryejnë një shërbim të paçmuar.

Njëkohësisht, do të ishte një humbje kohe dhe energjie për të reklamua libra të tjerë, të cilët krijojnë çoroditje në mendjet e njerëzve, i shpien ata në kaos ideologjik dhe që nuk kanë një ndikim të fortë dhe preciz në largimin e dyshimit prej mendjeve të njerëzve, siç është vërtetuar nga përvoja e përparshme. Për librat që janë shkruar vetëm e vetëm për të nxjerrë në pah fuqinë letrare të shkrimtarit se sa qëllimin fisnik për t'i shpëtuar njerëzit nga mungesa e besimit është e pamundur që të kenë një ndikim kaq të madh. Ata që e venë në dyshim këtë mund të shohin qartë se qëllimi i vetëm i librave të Harun Jahjasë është të mposhtë mosbesimin dhe, njëkohësisht, të përhapë vlerat morale të Kur'anit. Suksesi dhe ndikimi i këtij shërbimi shfaqen qartë në bindjen e lexuesve.

Një gjë duhet të mbahet parasysh: Arsyeya kryesore për vazhdimin e mizorisë, konflikteve dhe telasheve të tjera që po përjetojnë shumica e njerëzve sot është mbizotërimi ideologjik i mosbesimit. Kësaj mund t'i jepet fund vetëm me mposhtjen ideologjike të tij dhe, njëkohësisht, duke transmetuar mrekullitë e krijimit dhe moralin e Kur'anit, në mënyrë që njerëzit të jetojnë sipas tij. Duke patur parasysh gjendjen e botës sot, që po precipiton në një spirale dhune, korrupsioni dhe lufte, është e qartë se ky shërbim duhet të jepet shpejt dhe në mënyrë të suksesshme, përndryshe, do të jetë tepër vonë.

Në këtë drejtim, librat e Harun Jahjasë marrin një rol udhëheqës. Me lejen e Allahut, këto libra do të jenë një mjet, nëpërmjet të cilit njerëzit në shekullin e XXI do të gjejnë paqen, drejtësinë, dhe lumturinë e premtuar në Kur'an.

HARUN JAHJA

Edited by: David Livingstone

ISBN No.: 81-7231-xxxxx

Edition: 2002

Price: -----

Published by Abdul Naeem for
Islamic Book Service
2241, Kucha Chelan, Darya Ganj, Neë Delhi - 110 002 (INDIA)
Ph.: 3253514, 3265380, 3286551 Fax: 3277913
e-mail: ibsdelhi@del2.vsnl.net.in & ibsdelhi@mantraonline.com
ëbsite: <http://ëëë.islamic-india.com>

OUR ASSOCIATES

Islamic Book Service Inc.
136, Charlotte Ave, Hicksville, N. Y. 11801, U.S.A.
Tel: 8700-427, Toll Free: 8662424135

Al Munna Book Shop Ltd.
P.O. Box-3449, Sharjah (U.A.E), Tel: 06-561-5483, 06-561-4650
Branch: Dubai, Tel: 04-43529294

Zainab Foundation
Al-Baraka House, 18-20, Park Street, Slough, Berkshire, SL1 1PD, England, Tel: 533-511

Sartaj Company
P.O. Box-48535, Qualbert-4078, South Africa, Tel: 305-3025
Printed at:
Noida Printing Press, C-31, Sector 7, Noida (U.P.) Ph.: 91-4528211

All translations from the Qur'an are from "The Noble Qur'an: a Neë Rendering of its
Meaning in
English"
by Hajj Abdalhaqq and Aisha Beëley, published by Bookëork, Norëich, UK. 1420 CE/1999
AH.

ëbsite: <http://ëëë.harunyahya.com>
E-mail: info@harunyahya.com

PËRMBAJTJA

HYRJE	10
NUK EKZISTON ZOT TJETËR POS TIJ	13
ZOTI ËSHTË AFËR NJERIUT	17
ZOTI KTRIJOI GJITHÇKA SIPAS NJË URDHRI TË CAKTUAR.....	19
ZOTI KA PUSHTET MBI GJITHÇKA.....	20
ZOTI SHEH DHE DI GJITHÇKA.....	24
TË GJITHA QENIET I NËNSHTROHEN ZOTIT	26
BESIMET E RREJSHME PËR ZOTIN	28
BESIMI NË ZOT I LIRUAR NGA IDHUJTARIA	33
VLERËSIMI I ALLAHUT ME VLERËN E TIJ TË VËRTETË	35
MADHËSHTIA DHE FUQIA E PAFUND E ZOTIT	37
DASHURIA DHE FRIKA NDAJ ZOTIT	42
KURANI ËSHTË UDHËRRËFYES	47
BESIMET NË LIBRAT E SHPALLUR NGA ZOTI DHE BESIMI NË TË DËRGUARIT E TIJ	50
BESIMI NË ENGJËJ	52
NATYRA E PËRKOSSHME E JETËS SË KËSAJ BOTE	53
NJERIU ËSHTË DUKE U SPROVUAR.....	56
VDEKJA NUK ËSHTË FUNDI.....	60
BESIMI NË AHIRET (JETËN E PËRTEJME).....	63
BESIMI NË DITËN E GJYKIMIT.....	65
RINGJALLJA	69
DITA E GJYKIMIT	72
XHENETI DHE XHEHENEMI (PARAJSA DHE FERRI)	74
QËLLIMI ËSHTË TË FITOHET KËNAQËSIA E ZOTIT.....	80
MËKATI DHE PENDIMI.....	83
FEJA ËSHTË NË PAJTIM ME PRIRJEN E NATYRSHME TË NJERËZIMIT	86
BESIMTARËT DUHET TË JENË TË BASHKUAR DHE TË BASHKËPUNOJNË.....	92
FJALA E FUNDIT	96
MASHTRIMI I EVOLUCIONIT	98

HYRJJE



Ky libër është shkruar për ata të cilët së voni janë njohur me Islamin dhe të cilët tashmë kanë dijeni dhe një shkallë të bindjes ndaj Islamit, por e cila mund të ketë pasur origjinën e tyre në burime të papërshtatshme apo të pabaza. Informacioni të cilin njerëzit e grumbullojnë për Islamin është, në të shumtën e rasteve, i kufizuar në atë që paraqesin familjet e tyre, shokët apo librat e caktuara. Mirëpo, informacionit të saktë për Islamin mund t'i qasemi vetëm duke iu referuar Kuranit, burimit të Islamit.

Kurani është shpallja e fundit e zbritur prej Zotit, si udhëzim për njerëzimin. Ndërsa Teurati dhe Ungjilli, dy libra që i kanë paraprirë Kuranit, ishin po ashtu shpallje prej Zotit, me kohë, ato u shtrembëruan dhe humbën vlerën e tyre si fjalë hyjnore e Zotit. Edhe pse ato mund të përm-

bajnë pjesë të fjalës origjinale të Zotit, pjesa më e madhe e tyre përbëhet prej fjalëve dhe ndërhyrjeve të njeriut. I vetmi libër i shpallur nga Zoti që ka mbijetuar plotësisht e pandryshuar, është Kurani. Ajo përmban vetëm atë që është shpallur nga Zoti. Zoti zbriti porosinë e Tij, ose me anë të Xhibrilit, ose përmes frymëzimit të drejtpërdrejt të Profetit Muhammed (savs). Kurani përbëhet vetëm prej asaj që iu shpall Profetit Muhammed (savs), që u zbrit në etapa, për një periudhë njëzet e tri vjeçare.

Në çdo kohë, shpallja menjëherë u shënua me shkrim ose u mbajt në mend, nga ana e shokëve të Profetit. Sot, të gjithë Muslimanët kudo që janë, lexojnë të njëjtin Kuran. Në asnjërën prej kopjeve të tij nuk mund të gjendet asnjë kundërthënie apo mospajtim. (Në ditët tona, Kurani i Uthmanit, Kalifit të tretë, është i ekspozuar në Muzeun në Topkapi, në Stamboll.) Dëshmi se Kurani është prej Zotit është mungesa e plotë e çfarëdo lloj mospajtimi në Kuran. Sipas Librit të Zotit:

A nuk përsiatin ata për Kuranin! Sikur ai të mos ishte prej Allahut, do të gjenin në të shumë kundërthënie. (Sure Nisa: 82)


Kurani është udhëzim për të udhëhequr njeriun në rrugën e drejtësisë. Është shpallje e Zotit, e zbritur për të nxjerrë njeriun nga errësira në dritë. Me anë të Kuranit, Zoti ynë, Krijuesi i njeriut dhe i të gjitha gjallesave, udhëzon robërit e Tij në rrugën e drejtë. Në një ajet, Zoti thotë:

O njerëz, ju ka ardhur këshillë (Kurani) nga Zoti juaj, shërim për zemrat tuaja, udhëzim dhe mëshirë për besimtarët. (Sure Junus: 57)

Ekzistenca e Zotit, njësia e Tij, argumentet e krijimit dhe jeta e jetës së përtëjme, janë ato fakte themelore më të theksuara në Kuran. Në shumë vargje të Kuranit, Zoti e thërret njeriun të mendoj dhe të përsiat mbi urtësinë hyjnore në krijimin e Zotit dhe përkohshmërinë e jetës së kësaj bote dhe përhershshmërinë e jetës së ahiretit. Po ashtu, në Kuran mund të gjejmë edhe historitë e jetëve të profetëve; sinqeritetin e tyre në besim, përkushtimin e tyre ndaj çështjes së Zotit dhe vendosmërinë e tyre në përhapjen e porosisë hyjnore. Më në fund, një numër ajetesh në Kuran na ofrojnë gjithashtu vizionin për mënyrën se si duhet të sillemi në jetët tona të përditshme.

Në këtë libër, bazuar në informacionin e ofruar nga Kurani, do të bëjmë fjalë për Zotin, vetitë e Tij, qëllimin e vërtetë të ekzistencës sonë në këtë botë, çfarë duhet të bëjmë për të vepruar në pajtim me të, realitetin e vdekjes dhe atë që na pret, jetën e përtëjme.

Ju rekomandojmë që ta lexoni këtë libër me kujdes dhe të mendoni për mësimet e tij, pasi që ato kanë për qëllim që t'ju afrojnë më shumë me Krijuesin tuaj dhe t'ju tregojnë rrugën e lumturisë dhe shpëtimit të përjetshëm.



NUK EKZISTON ZOT TJETËR POS TIJ

Esenca e Islamit është të jesh i vetëdijshëm për ekzistencën e Zotit dhe të kuptosh se nuk ekziston zot tjetër pos Tij. Të praktikosh Islamin domethënë të lejosh këtë të vërtetë të manifestohet në çdo aspekt të jetës së njeriut. Sipas Kuranit:

Zoti juaj është një Zot i vetëm! S'ka zot tjetër (të denjë për adhurim), përveç Atij, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit! (Sure Bekare:163)

Shumica e njerëzve mendojnë se materia, substanca që përbën bazën e gjithësisë, ka një ekzistencë absolute, dhe Zotin e konsiderojnë veçse si një ide abstrakte. (Zoti është me të vërtetë mbi atë që ata i përshkruajnë Atij) E vërteta është, megjithatë, se vetëm Zoti ekziston vërtetë dhe se gjithçka tjetër është vetëm krijim i Tij.

E tërë gjithësia dhe gjithçka në të u krijua nga Zoti. Para krijimit të gjithësisë, asgjë nuk ekzistonte, në kuptimin material. Gjithçka ishte mos-ekzistencë. Në momentin kur u krijua gjithësia, Al-Aual (i Pari) dhe Al-Akir (i Fundit) Zoti, i Cili është i pavarur nga koha dhe hapësira, krijoi kohën, materien dhe hapësirën. Kurani i referohet kësaj çështjeje si vijon:

Ai është Krijuesi i qiejve dhe i Tokës, pa shembull të

mëparshëm dhe, kur vendos për diçka, vetëm thotë për të: “Bëhu!” - dhe ajo bëhet. (Sure Bekare: 117)

Përkundër njohurisë së pranuar, Zoti nuk krijoi materien dhe pastaj ta linte atë të pavarur. Gjithçka që ndodh, madje edhe në këtë çast, është paracaktuar nga Zoti. Çdo pikë shiu, çdo fëmijë që çel sytë për herë të parë në këtë dynja, procesi i fotosintezës në bimë, të gjitha funksionet trupore të gjallesave, rrugëtimet e yjeve në galaktikat shumë të largëta, çdo farë që mbinë, apo çfarëdo ngjarje tjetër që mund të na vjen në mendje, apo për të cilën dështojnë të mendojmë, të gjitha janë paracaktuar nga Zoti. Është Zoti Ai i Cili krijon gjithçka. Çdo gjë ndodhë me urdhrin e Tij:

Allahu është Ai, që ka krijuar shtatë qiej dhe po aq toka. Urdhrat e Tij zbresin përmes tyre, që ju ta dini se Allahu është i Fuqishëm për çdo gjë dhe se Ai përfshin gjithçka në diturinë e Tij. (Sure Talak: 12)

A ka më të mirë se Ai, që zë fill krijimin dhe pastaj e ripërsërit atë, që ju jep mjete jetese nga qielli dhe toka?! Vallë, a ka krahas Allahut zot tjetër? Thuaj (o Muhammed): “Sillni provat tuaja, nëse ajo që thoni është e vërtetë!” (Sure Nemi: 64)

Po t'i ishte lënë gjithësia vetvetes, ajo do të çrregullohej, shpartallohej dhe degjenerohej. Mirëpo, baraspesha e përkryer e të gjitha gjërave, nga qelizat e një organizmi të gjallë e deri te yjet në hapësirën e thellë kozmike, të gjitha zbulojnë ekzistencën e diçkaje që i kontrollon ato në çdo

moment, me përsosmërinë e njëjtë si krijimi i tyre i parë. Në çdo skutë të gjithësisë, njeriu gjithmonë do të arrij të njoh një plan të përkryer:

Ai ka krijuar shtatë qiej njërin mbi tjetrin. Nuk mund të gjesh në krijimin e të Gjithëmëshirshmit kurrfarë ceni. Hidhe vështrimin: a sheh ndonjë plasaritje? Pastaj hidhe sërish vështrimin; sytë e tu do të kthehen të lodhur e të molisur. (Sure Mulk: 3-4)

Mohimi se Zoti është Krijuesi dhe veshja e natyrës hyjnore asaj të cilën Ai krijoi, me gjithë dëshmitë e panumërta për të kundërtën, është po aq i pakuptim sa edhe pohimi se një rrokaqiell nuk është ndërtuar prej punëtorëve të ndërtimtarisë, por se është krijuar me anë të vullnetit të lirë të tullave apo me vendosjen e tyre mbi njëra tjetrën si rezultat i rastësisë së kulluar.

Rregulli i përkryer në gjithësi dhe krijimi suprem i gjallesave, na zbulon se ato duhet të jenë krijuar të gjitha nga një Krijues i vetëm. Po të kish zota tjerë, domethënë, të tjerë të aftë për të imponuar vullnetin e tyre, do të mbisundonin parregullsia dhe hutia. Se nuk ekziston zot tjetër pos Tij dhe se asnjë qenie tjetër në gjithësi nuk ka fuqi të ngjashme, rrëfëhet në një ajet të Kuranit si vijon:

Allahu nuk ka zgjedhur për Vete ndonjë bir dhe përveç Atij s'ka asnjë zot tjetër, përndryshe çdo zot do të merrte atë që ka krijuar dhe do të ngriheshin njëri mbi tjetrin. Qoftë i lartësuar Ai nga shpifjet e tyre!

(Sure Muminun: 91)

Në lutjen më poshtë, Profeti Muhammedi (savs) thekson se nuk ekziston zot tjetër pos Allahut dhe një besimtar duhet t'i drejtohet Atij për çdo gjë:

Askush nuk meriton të adhurohet pos Allahut, i Madhërishmi, i Durueshmi. Askush nuk meriton të adhurohet pos Allahut, Zotit të Fronit Madhështor. Askush nuk meriton të adhurohet pos Allahut, Zotit të Qiejve dhe Zotit të Fronit të nderuar. (Buhariu)

Siç theksohet më lartë, nuk ekziston zot tjetër pos Tij. Ai nuk ka djalë. Ai është i lartësuar prej këtyre vetive njerëzore. Nga ajeti më poshtë kuptojmë qartë se ato fe që thonë se Zoti ka një “djalë” janë të larguara nga udha e drejtë. Njësia e Zotit theksohet më tej në Kuran si vijon:

Thuaj: “Ai është Allahu, Një dhe i Vetëm! Allahu është Absoluti, të Cilit i përgjërohet gjithçka në amshim. Ai as nuk lind, as nuk është i lindur. Dhe askush nuk është i barabartë (a i krahasueshëm) me Atë!” (Sure Ihlas: 1-4)

Disa njerëz mendojnë se Zoti gjendet në një vend të caktuar. Besimi se Zoti është lartë në qiell, në një vend të largët në gjithësi, besohet prej shumë njerëzve. E vërteta, megjithatë, është se Zoti është gjithkund dhe rrethon gjithçka. Ai është qenia e vetme e vërtetë dhe absolute, të Cilës të gjitha qeniet i nënshtrohen:

Allahu! Nuk ka zot tjetër (që meriton adhurimin) përveç Tij, të Gjallit, të Përrjetshmit, Mbajtësit të

gjithçkaje! Atë nuk e kaplon as dremitja, as gjumi! Atij i përket gjithçka që gjendet në qiej dhe gjithçka që gjendet në Tokë. Kush mund të ndërhyjë tek Ai për ndokënd pa lejen e Tij? Ai di çdo gjë që ka ndodhur përpara dhe çdo gjë që do të ndodhë pas njerëzve, kurse ata nuk mund të përvetësojnë asgjë nga Dituria e Tij, përveçse aq sa Ai dëshiron. Kursi-u43 i Tij shtrihet mbi qiejt dhe Tokën dhe Ai nuk e ka të rëndë t'i ruajë ato. Ai është i Larti, Madhështori! (Sure Bekare: 255)

Zoti mban gjithçka në zotërimin e Tij në çdo moment të caktuar. Nuk ekziston asnjë krijesë që Ai nuk e mban për balluke. Ai ka pushtet mbi të gjitha gjërat dhe është i lartësuar larg çfarëdo të mete apo paaftësie.



ZOTI ËSHTË AFËR NJERIUT

Shumë njerëz mendojnë se Zoti është shumë larg. Mirëpo, siç thuhet në Kuran: "...Me të vërtetë, Zoti yt i ka përfshirë të gjithë njerëzit me dijen e Tij..." (Sure Isra: 60), Ai është shumë afër. Ai sheh dhe njeh çdo veçori të një qenie njerëzore dhe dëgjon çdo fjalë që ai shqipton. Ai ka dijeni madje edhe për mendimet më intime të njeriut. Kjo rrëfëhet në Kurani si vijon:

Ne e kemi krijuar njeriun dhe, Ne e dimë ç'i pëshpërit atij shpirti i vet. Ne jemi më pranë tij se damari i qafës së vet. (Sure Kaf: 16)

Zoti është aq afër njeriut sa që dëgjon lutjen e çdokujt – madje edhe nëse lutet me zemër – dhe është Ai i cili i përgjigjet asaj:

Kur robërit e Mi (besimtarë) të pyesin për Mua, (thuaju se) Unë jam afër, i përgjigjem lutjeve të lutësit, kur ai më lutet Mua. Prandaj, le t'i përgjigjen thirrjes Sime dhe le të më besojnë Mua, për të qenë në rrugë të drejtë. (Sure Bekare: 186)

Zoti e di atë që njeriu mban fshehur në zemrën e tij. Ai e di nëse ai përfshihet në një punë për të fituar kënaqësinë e Tij apo për të kënaqur epshin e tij. Zoti na përkujton se Ai i di mendimet tona më të fshehta:

...Ta dini se Allahu e di ç'ka në zemrat tuaja, andaj ruajuni prej Tij. Dhe ta dini se Allahu është Falës i madh dhe i Butë. (Sure Bekare: 235)

Edhe nëse ti flet me zë të lartë, (është e kotë, sepse) Ai, me të vërtetë, i di sekretet edhe më të fshehta. (Sure Ta Ha: 7)

I Dërguari i Zotit, Profeti Muhammed (savs) i përkujtoi po ashtu Muslimanët kur ata luten se Zoti është shumë afër tyre duke thënë: "Ju e thërrisni Dëgjuesin, Atë që është shumë afër jush; Atë të Cilin ju e thërrisni është më afër se cilido prej jush." (Buhariu dhe Muslimi)

Pasi që Ai është me ju në çdo moment, Zoti është me ju derisa ju e lexoni këtë libër; Ai sheh atë që ju veproni dhe di atë që ju mendoni. Kjo e vërtetë rrëfëhet në Kuran si vijon:

A nuk e di ti, se Allahu di çdo gjë që është në qiej dhe në Tokë?! Nuk ka bisedë të fshehtë midis tre vetave, që Ai të mos jetë i katërti; as midis pesë vetave e që Ai të mos jetë i gjashti; as kur janë më pak, as kur janë më shumë, që Ai të mos jetë me ata, kudo që të ndodhen; Ai në Ditën e Kiametit do t'i njoftojë ata se çfarë kanë bërë, se, me të vërtetë, Allahu di çdo gjë!
(Sure Muxhadile: 7)



ZOTI KTRIOI GJITHÇKA SIPAS NJË URDHRI TË ÇAKTUAR

Vërtet, Ne çdo gjë e kemi krijuar me masë të paracaktuar. (Sure Kamer: 49)

Fati është pjesë e krijimit të përsosur të Zotit dhe të gjitha ngjarjet, të së kaluarës dhe të ardhmes, janë të njohura për Të si në një “moment të vetëm” të pafund.

Është Zoti Ai i Cili krijoi materien. Ajo që ne quajmë kohë është lëvizja e materies. Koha është një dimension i cili është i lidhur vetëm me njeriun. Vetëm njeriu ndien kalim-

in e kohës; një genie njerëzore mund të njoh ekzistencën e tij vetëm duke qenë se ajo ekziston në kohë. Mirëpo, Zoti është i pavarur nga koha, sepse është Ai i Cili e krijoi atë. Me fjalë tjera, Zoti është i pavarur nga rrjedha e kohës; Zoti nuk ka nevojë të pres për të parë se çfarë do të ndodhë në të ardhmen. Zoti është vërtet i lartësuar mbi të gjitha këto të meta. Zoti është në dijëni për një ngjarje të ardhme (e ardhmja për ne) para se ajo të ndodhë, sepse Zoti, i Pari dhe i Fundit, është i pavarur nga koha dhe sepse Ai është Absoluti dhe i Përrjetshmi. I pavarur nga koha, Zoti është i vetëdijshëm për një ngjarje e cila, nga këndvështrimi ynë, do të ndodhë me mija vite më vonë. Në të vërtetë, është Ai i Cili e nënshtroi, e përcaktoi dhe e krijoi atë. Kjo e vërtetë zbulohet në një ajet si vijon:

S'ka fatkeqësi që godet tokën dhe ju, që të mos jetë e shënuar në Libër (Leuhi Mahfûdh) më parë se ta krijojmë atë. Kjo për Allahun është vërtet e lehtë! (Sure Hadid: 22)



ZOTI KA PUSHTET MBI GJITHÇKA

Zoti, Krijuesi i çdo gjëje, është i vetmi zotërues i të gjitha genieve. Është Zoti Ai i Cili i grumbullon retë e dendura, ngroh dhe ndriçon tokën, ndryshon drejtimin e erërave, i

mban zogjtë pezull në qiell, çan farën, bën që të rrah zemra e njeriut, urdhëron fotosintezën në bimë dhe mban planetët në orbitat e tyre të ndara. Njerëzit rëndom pandehin se dukuri të tilla ndodhin në pajtim me “ligjet e fizikës,” “gravitacionit,” “aerodinamikës,” apo në pajtim me faktorët tjerë fizik; mirëpo, ekziston një gjë që këta njerëz shpërfillin: të gjitha këto ligje fizike u krijuan nga Zoti. Në të vërtetë, i vetmi zotërues i fuqisë në gjithësi është Zoti.

Zoti sundon të gjitha sistemet në gjithësi, pa marr parasysh se a jemi të vetëdijshëm për to, apo nëse jemi duke fjetur, të ulur, duke ecur. E gjithë pafundësia e proceseve në gjithësi, të gjitha thelbësore për ekzistencën tonë, është nën kontrollin e Zotit. Madje edhe aftësia jonë të hedhim një hap të vogël përpara varet nga hollësi të panumërta të paracaktuara hollësisht, përfshirë forcën e gravitacionit të tokës, strukturën e skeletit të njeriut, sistemin nervor dhe muskullor, trurin, zemrën dhe madje edhe shpejtësinë e rrotullimit të tokës.

Atribuimi i ekzistencës së botës dhe tërë gjithësisë rastësisë së plotë është gabim i madh. Rregulli i hollë i tokës dhe gjithësisë i kundërvihet plotësisht mundësisë së krijimit përmes rastësisë, dhe për më tepër, është një argument i qartë i fuqisë së pafund të Zotit. Për shembull, orbita e tokës rreth diellit shmanget vetëm 2.8 mm në çdo 29 km nga rruga e drejtë. Po të ishte ky devijim për 0.3 mm më i gjatë apo më i shkurt, atëherë gjallesat në gjithë tokën ose do të ngriheshin ose do të digjeshin. Ndonëse është pothuajse e

pamundshme madje për një copë mermeri të rrotullohet në të njëjtën orbitë pa ndonjë devijim, toka mban një drejtim të tillë përkundër masës së saj gjigante. Siç thuhet në Kuran: “dhe për çdo gjë Ai ka caktuar masë...” (Sure Talak: 3). Në të vërtetë, rregulli madhështor në gjithësi mbahet si rezultat i sistemeve fantastike të cilat varen nga baraspesha jashtëzakonisht delikate.

Shumë njerëz besojnë në besimin e çoroditur se Zoti “krijoi çdo gjë dhe atëherë i la ato të lira.” Megjithatë, çdo ngjarje, që ndodhë në cilëndo pjesë të gjithësisë, ndodhë vetëm sipas Vullnetit të Zotit dhe nën kontrollin e Tij. Kurani thotë si vijon:

A nuk e di ti, se Allahu di çdo gjë, që është në qiej e në Tokë? Të gjitha këto janë (shënuar) në Libër. Me të vërtetë, kjo është e lehtë për Allahun. (Sure Haxh: 70)

Është shumë me rëndësi që të kuptohet ky fakt për atë i cili përpiqet t'i afrohet Zotit. Lutja e Profetit Muhammed (savs) e cituar më poshtë është një shembull shumë i mirë për këtë:

O Zot: Të gjitha lëvdatat të takojnë Ty; Ti je Zoti i Qiejve dhe Tokës. Të gjitha Lëvdatat të takojnë Ty; Ti je Ai që mban në jetë Qiellin dhe Tokën dhe gjithçka ka në to. Të gjitha Lëvdatat të takojnë Ty; Ti je Drita e Qiejve dhe e Tokës. Fjala Jote është e Vërteta, dhe Premtimi Yt është e Vërteta, dhe Takimi me Ty është e Vërteta, dhe Xheneti është e Vërteta, dhe Zjarri (i Xhehenemit) është e Vërteta, dhe Ora është e Vërteta. O Zot! Ty të nënshtro-

hem, dhe unë besoj në Ty dhe unë varem prej Teje, dhe Ty të pendohem dhe me Ty (dëshmitë/argumentet Tuaja) u kundërvihem kundërshtarëve të mi, dhe Ty ta lë gjykimin (për ata që e refuzojnë porosinë time). O Zot! M'i fal gjynahet e mia që i kam bërë në të kaluarën apo që do t'i bëj në të ardhmen, dhe gjithashtu gjynahet që i kam bërë fshehurazi apo haptazi. Ti je Zoti im i vetëm (të Cilin e adhuroj) dhe nuk ka Zot tjetër për mua (domethënë nuk adhuroj asnjë tjetër pos Teje). (Buhariu)

Proceset e ndërlikuara që ndodhin në trupat e gjallesave janë shembuj mbresëlënës që na ndihmojnë të kuptojmë fuqinë e Zotit. Për shembull, në çdo moment, veshkat tuaja filtojnë gjakun tuaj dhe nxjerrin molekulat e dëmshme jashtë trupit. Ky proces i filtrimit dhe eliminimit, i cili mund të kryhet nga një qelizë e vetme e veshkës, mund të kryhet vetëm përmes një aparati gjigant për hemo-dializë (veshkë artificiale). Një aparat për hemo-dializë është projektuar në mënyrë të ndërgjegjshme nga shkencëtarët. Mirëpo, një veshkë, nuk ndien, apo nuk ka një qendër vendim-marrëse, dhe as aftësinë e të menduarit. Me fjalë tjera, një qelizë e pandërgjegjshme e veshkës mund të kryej detyra të cilat përndryshe kërkojnë një proces të ndërlikuar të menduarit.

Është e mundshme që të ndeshim me miliona shembuj të tillë në gjallesa. Molekulat, që përbëhen nga materia e pandërgjegjshme, kryejnë detyra aq të mrekullueshme që në rastin e kundërt do të mund të na jepnin përshtypjen e vetëdijes. Ndonëse vetëdija e dukshme në këto raste është, natyrisht, e mençurisë dhe diturisë së pakufishme të Zotit.

Është Zoti që projektoi qelizat e veshkës, si edhe molekulat për të cilat folëm dhe i Cili i urdhëron ato që të kryejnë detyrat e tyre përkatëse. Në Kuran, Zoti na informon se ai vazhdimisht u zbret “urdhra” krijesave të cilat Ai i krijoi:

Allahu është Ai, që ka krijuar shtatë qiej dhe po aq toka. Urdhrat e Tij zbresin përmes tyre, që ju ta dini se Allahu është i Fuqishëm për çdo gjë dhe se Ai përfshin gjithçka në diturinë e Tij. (Sure Talak: 12)

Është e qartë se Zoti, i Cili krijoi gjithçka në gjithësi, është padyshim në gjendje t’i ringjall të vdekurit. Në lidhje me këtë fakt, Zoti shpall si vijon:

A nuk e shohin ata se Allahu, i Cili krijoi qiejt dhe Tokën pa u lodhur aspak në krijimin e tyre, është i Fuqishëm t’i ngjallë të vdekurit? Po, Ai është vërtet i Fuqishëm për çdo gjë. (Sure Ahkaf: 33)



ZOTI SHEH DHE DI GJITHÇKA

Njerëzit nuk mund ta shohin Zotin – përveç nëse Ai dëshiron këtë, që paraqet arsyen kryesore pse shumë njerëz shpesh pandehin në mënyrë të gabuar se Zoti nuk mund t’i shoh ata (vërtet, Zoti është i lartësuar prej asaj që ata i përshkruajnë Atij). Zoti sheh dhe ka dijeni për çdo gjë, deri në

hollësinë më të vogël, siç tregohet në një ajet të Kuranit si vijon:

Shikimet njerëzore nuk mund ta arrijnë Atë, ndërkohë që Ai i arrin shikimet e të gjithëve. Ai është Bamirës i pakufi dhe di çdo gjë. (Sure En'am: 103)

Kudo që mund të jetë një person, padyshim se Zoti është me të. Mu në këtë moment, derisa ju lexoni këta rreshta, Zoti ju sheh dhe e di me saktësi atë që ju përshkon mendjen. Kudo që shkoni, apo çfarëdo që bëni, kështu është gjithmonë. Siç e shpjegon Kurani:

Në çfarëdo pune që të jesh, çfarëdo gjëje që të lexosh nga Kurani dhe çfarëdo pune që të bëni (o njerëz), Ne jemi dëshmitarë, kur ju të thelloheni në të. Zotit tënd nuk i fshihet asnjë grimë peshe, në Tokë e në qiell; as më pak nga ajo e as më shumë nuk mbetet pa u shënuar në Librin e qartë. (Sure Junus: 61)

Ai i krijoi qiejt dhe Tokën për gjashtë ditë, pastaj u ngrit mbi Fron. Ai e di se çfarë hyn në Tokë dhe çfarë del prej saj, çfarë zbret prej qiellit dhe çfarë ngjitet drejt tij. Ai është me ju kudo që të gjendeni; Ai sheh gjithçka që bëni. (Sure Hadid: 4)

Profeti Muhammed (savs) gjithashtu i përkujtoi besimtarët që ta kenë parasysh këtë kur tha: "Zoti është mbi Fron dhe asgjë që ju veproni nuk është e fshehtë për Zotin."

I vetëdijshëm për këtë të vërtetë, një besimtar i nënshtrohet Zotit të tij, kërkon mbrojtjen e Tij dhe nuk i frikë-

sohet askujt pos Tij. Urdhri i Zotit për Profetin Musa dhe Harunin, të cilët ngurruan që të shkojnë tek Faraoni për ta thirrur atë në Islam, është një mësim për të gjithë besimtarët:

(Allahu) tha: “Mos u frikësoni! Në të vërtetë, Unë jam me ju, dëgjoj dhe shoh. (Sure Ta Ha: 46)



TË GJITHA QENIET I NËNSHTROHEN ZOTIT

Të gjitha qeniet në gjithësi, të gjalla apo të pajetë, janë nën urdhrin e Zotit. Ato mund të veprojnë vetëm nëse Ai dëshiron këtë. Ato mund t'i kryejnë vetëm ato punë të cilat Ai dëshiron. Për shembull, bletët, të cilat prodhojnë më shumë mjaltë se që ato kanë vërtetë nevojë, nuk do të mund të dinin kurrsesi se mjalti është i dobishëm për njerëzit; dhe as që mund të jenë të vetëdijshme për përbërjen e saktë kimike që e bën atë të dobishëm dhe të shijshëm. Në të vërtetë, përveç se nuk dinë se pse prodhojnë mjaltë me bollëk, as që mund të posedojnë zgjuarsinë për të ndërtuar hojet e rregullta gjashtëkëndëshe, secila prej të cilave është një mrekulli e projektimit dhe matematikës. Është Zoti, të Cilit i nënshtrohen të gjitha qeniet, që bën që bletët të përmushin këto vepra. Fakti se bletët veprojnë në pajtim me urdhrin e Zotit përshkruhet në Kuran si vijon:

Zoti yt e frymëzoi bletën, (duke thënë): “Ndërto shtëpi në male dhe në drurë dhe në atë (kosheret) që kanë ngritur njerëzit! Ushqehu me gjithfarë lloje frutash dhe ec rrugës së Zotit tënd me përulje!” Nga barku i tyre del lëng ngjyrash të ndryshme, në të cilin ka ilaç e shërim për njerëzit. Vërtet që kjo është shenjë për ata që përsiatin.(Sure Nahl: 68-69)

Bindja e bletëve ndaj urdhrave të Zotit në mënyrën se si sillen ato nuk është një anomali. Zoti na jep këtë shembull për të na mundësuar që të kuptojmë se të gjitha qeniet, duke përfshirë edhe njeriun, veprojnë sipas Vullnetit të Tij. Kurani tregon se ky është një argument për ata të cilët mendojnë. Të gjitha qeniet i nënshtrohen plotësisht urdhrimit të Tij:

Atij i përket gjithçka që gjendet në qiej dhe në Tokë. Gjithçka i përulet Atij. (Sure Rum: 26)

Disa religjione konsiderojnë që Shejtani është një qenie e ndarë dhe e pavarur prej Zotit. Disa sosh i veshin fuqi të veçantë Shejtanit. Megjithatë, të dyja këto mendime janë të pasakta. Shejtani, si edhe jobesimtarët të cilët e pasojnë atë, i nënshtrohen Vullnetit të Zotit. Zoti krijoi Shejtanin për ta vënë njeriun në sprovë dhe e pajisi atë me aftësinë dhe me autoritetin për të thirrur njerëzimin në mosbesim. Fjalët e Zotit drejtuar Shejtanit rrëfohen në Kuran:

Allahu tha: “Atëherë dil prej Xhenetit! Me të vërtetë, ti je i mallkuar dhe mallkimi Im do të jetë mbi ty deri në Ditën e Gjykimit”.

Ai tha: “O Zoti im, më jep afat deri në ditën kur do të ringjallen ata!”

Zoti tha: “Në të vërtetë, ty do të jepet afat deri në një ditë të caktuar (kur i fryhet Surit për herë të parë)”.

Ai tha: “Betohem në madhërinë Tënde se unë do t’i mashtroj ata të gjithë, përveç robërve të Tu të sinqertë!”

Zoti tha: “E vërteta është - dhe Unë them vetëm të vërtetën se, do ta mbush Xhehenemin me ty dhe me të gjithë ata që të pasojnë ty”! (Sure Sad: 77-85)

Sikurse edhe njeriu, Shejtani është po ashtu plotësisht nën kontrollin e Zotit dhe i nënshtrohet Vullnetit të Tij. Ai nuk është një qenie që posedon një vullnet të ndarë dhe të pavarur nga Zoti; ai as nuk mund të bjerë vendime të tilla dhe as nuk mund t’i zbatoj ato. Në sprovën e vënë për qeniet njerëzore në këtë jetë, ai është vetëm një qenie që pritet të dalloj të drejtët prej të pandershmëve.



BESIMET E GABUESHME PËR ZOTIN

Teurati dhe Ungjilli, shpalljet e mëhershme prej Zotit, kanë humbur vërtetësinë e tyre origjinale, pasi që fjalët dhe ndërhyrjet e njeriut janë përfshirë në to. Kjo është njëra prej arsyeve pse u zbrit Kurani. Se librat e shenjtë që paraprinë Kuranin u shtrembëruan nga ana e njeriut përshkruhet në

Kuran si vijon:

Mjerë ata që me duart e tyre shkruajnë Librin, e pastaj thonë: “Kjo është prej Allahut” që për këtë të kenë ndonjë dobi të vogël (materiale). Mjerë ata për çfarë kanë shkruar me duart e tyre dhe mjerë ata për çfarë kanë fituar! (Sure Bekare: 79)

Me të vërtetë, një grup ithtarësh të Librit e shtrembërojnë Librin me gjuhët e tyre (ndërsa e lexojnë atë), që ju të mendoni se ai farë leximi është prej Librit (që ka zbritur Allahu), kurse në të vërtetë, nuk është prej Librit. Ata thonë: “Kjo që lexojmë është nga Allahu”, por ajo nuk është nga Allahu. Ata flasin gënjeshtër për Allahun, duke qenë të vetëdijshëm për këtë. (Sure Ali Imran: 78)

Shtrembërimi i Teuratit dhe Dhiatës së Re çoi në përhapjen e besimeve të rrejshme midis pasuesve të tyre. Këta libra të shenjtë përmbajnë besimet dhe idetë që rrjedhin nga jashtë besimit të vërtetë të Zotit. Kjo manifestohet në shtrembërimin e shpalljes së vërtetë dhe në përshkrimin e Zotit si një qenie me dobësi dhe të meta karakteristike për qeniet njerëzore. (Vërtetë, Zoti është i lartësuar nga ajo që ata i përshkruajnë Atij).

Në Teuratin e shtrembëruar, për shembull, është fabrikuar një tregim në të cilin Zoti përshkruhet si një qenie e cila u mposht në një garë të mundjes me Profetin Jakub (as). Në mënyrë të ngjashme, në një tjetër tregim, pohohet se pasi që ka krijuar botën për gjashtë ditë, Zoti u lodh dhe

pushoj në ditën e shtatë. Mirëpo, pasi që Zoti është i lartësuar dhe mbi çdo të metë, nuk mund të lodhet dhe të ketë nevojë për pushim. Kjo në Kuran përshkruhet si vijon:

Ne i kemi krijuar qiejt, Tokën dhe çdo gjë që gjendet midis tyre për gjashtë ditë, pa ndierë lodhje aspak. (Sure Kaf: 38)

A nuk e shohin ata se Allahu, i Cili krijoi qiejt dhe Tokën pa u lodhur aspak në krijimin e tyre, është i Fuqishëm t'i ngjallë të vdekurit? Po, Ai është vërtet i Fuqishëm për çdo gjë. (Sure Ahkaf: 33)

Kjo zbulon se pasuesit e këtyre librave janë shmangur nga rruga e drejtë dhe nuk kanë pasur një kuptim të saktë për Zotin dhe vetitë e Tij.

Kurani, në anën tjetër, është nën mbrojtjen e Zotit dhe është libri i vetëm i shpallur nga Zoti që ka mbetur i pandryshuar. Kurani është libri i Islamit, fesë së vetme të vërtetë:

Sigurisht, Ne e kemi shpallur Kuranin dhe, sigurisht, Ne do ta ruajmë atë. (Sure Hixhr: 9)

Kush kërkon tjetër fe përveç Islamit, nuk do t'i pranohet dhe ai në botën tjetër do të jetë i humbur. (Sure Ali Imran: 85)

Kurani iu referohet besimeve të gabueshme të përvetësuar nga të Krishterët dhe Çifutët, dhe e bën të ditur besimin e vërtetë. Për shembull, thënia e tyre: "Zoti ka djalë (Jezusin)," e cila është një prej parimeve të Krishterimit,

thuhet të jetë thjesht një besim i paarsyeshëm dhe një gënjeshtëri e thënë kundër Zotit:

Ata thonë: “Allahu ka bërë një fëmijë”. I Lavdishëm dhe i Lartësuar qoftë Ai! Përkundrazi, Atij i përket çdo gjë që gjendet në qiej e në Tokë dhe Atij i nënshtrohet gjithçka. Ai është Krijuesi i qiejve dhe i Tokës, pa shembull të mëparshëm dhe, kur vendos për diçka, vetëm thotë për të: “Bëhu!” - dhe ajo bëhet. (Sure Bekare: 116-117)

Disa vargje tjera lidhur me këtë çështje janë si vijon:

O ithtarët e Librit! Mos e kaloni kufirin në besimin tuaj dhe për Allahun thoni vetëm të vërtetën! Mesihu - Isai, i biri i Merjemes, është vetëm i Dërguar i Allahut dhe Fjala e Tij, të cilën ia ka dërguar Merjemes, si dhe shpirt (i krijuar) nga Ai. Pra, besojini Allahut dhe të dërguarve të Tij! Dhe mos thoni: “Tre zota”! Hiqni dorë, se është më mirë për ju! Allahu është vetëm një Zot - qoftë lavdëruar Ai! Ai është tepër i lartësuar për të pasur fëmijë. E Tij është gjithçka që gjendet në qiej dhe në Tokë. Allahu mjafton për rregullimin e gjithësisë. (Sure Nisa: 171)

Ai është Krijuesi i qiejve dhe i Tokës! E si mund të ketë Ai fëmijë, ndërkohë që nuk ka bashkëshorte?! Ai ka krijuar çdo gjë dhe është i Dijshëm për çdo gjë. (Sure En’am: 101)

Besimi i krishterë pohon se Zoti krijoi gjithësinë dhe pastaj e la atë të pavarur. Megjithatë, siç thamë më herët,

Vullneti i Zotit sundon gjithësinë në çdo moment; ajo është vazhdimisht nën kontrollin e Tij. Asgjë nuk mund të ndodhë pa Vullnetin dhe jashtë kontrollit të Tij:

A ka më të mirë se Ai, që zë fill krijimin dhe pastaj e ri-përsërit atë, që ju jep mjete jetese nga qielli dhe toka?! Vallë, a ka krahas Allahut zot tjetër? Thua (o Muhammed): “Sillni provat tuaja, nëse ajo që thoni është e vërtetë!” (Sure Neml: 64)

Me të vërtetë, Allahu mban ekuilibrin e qiejve dhe të Tokës, që të mos shkatërrohen. Kur ato nisin të shkatërrohen, askush nuk mund t’i mbrojë, pos Tij. Me të vërtetë, Ai është i Butë dhe Falës (i gjynaheve). (Sure Fatir: 41)

Për t’iu kundërvënë këtyre nocioneve të rrejshme dhe shumë të tjerave që nuk janë përmendur këtu, Zoti na i jap në Kuran vetitë e Tij të lartësuara. Kjo jo vetëm për t’iu dhënë përgjigje këtyre pohimeve të gabueshme, por po ashtu për t’i udhëzuar ata që janë fajtorë prej tyre në fenë e vërtetë të Zotit.

Çdokush duhet të pranoj se Zoti është Një dhe se asgjë dhe askush nuk mund të krahasohet me Të; ai është i lirë nga çdo e metë. Ai rrethon gjithçka, Ai ushtron sundimin e Tij mbi krijimin në çdo moment, Ai është afër njeriut, Ai ka fuqinë të bëj gjithçka, Ai është i Gjithëmëshirshmi, Ai është i Drejti, Ai është Sunduesi i Ditës së Gjykimit, Ai sheh dhe dëgjon gjithçka dhe është më i lartësuar për nga vetitë.



BESIMI NË ZOT I LIRË NGA IDHUJTARIA

A e ke parë ti atë që epshin e vet e ka marrë për zot? A do t'i bëhesh mbrojtës atij? (Sure Furkan: 43)

“Shirk”, fjala që përdoret për idhujtari në Arabishte nënkupton “ortakëri/shoqërim.” Në Kuran, i referohet përshkrimit shok Zotit, apo mendimit se dikush apo diçka, që quhen idhuj apo zota të rrejtshëm, meriton adhurim përkrah apo përveç Zotit. Ndonëse, idhujtaria nuk kufizohet me adhurimin e totemeve apo qenieve të pajetë. Pasi që është përgjegjësi e njeriut që t’i shërbej Krijuesit të tij dhe të përpiqet për të fituar vetëm kënaqësinë e Tij, ndjekja nga ana e tij e çfarëdo qëllimi tjetër është të adhuroj diçka tjetër pos Zotit. Për shembull, një person do të ishte fajtor për idhujtari nëse do të përpiquej për të fituar kënaqësinë e njerëzve në vend të Zotit. Po kështu, do të ishte përsëri përshkrim shok Zotit nëse qëllimi i jetës së njeriut do të ishte t’i kënaqtekat dhe dëshirat e veta më tepër se sa të fitojë kënaqësinë e Zotit. Shumë njerëz u përshkruajnë karakter hyjnor gjërave si të hollat, pozita, pasuria e kështu me radhë.

Kurani i referohet idhujtarisë së shoqërisë Arabe, e cila veçoi një pjesë të të korrave dhe të bagëtisë së tyre për idhujt e tyre, si vijon:

Ata kanë caktuar për Allahun pjesë nga drithi dhe kafshët shtëpiake, të cilat i ka krijuar Ai dhe thonë sipas hamendjes së tyre: “Kjo është për Allahun, ndërsa kjo është për idhujt tanë”. Mirëpo ajo pjesë që është për idhujt e tyre, nuk arrin te Zoti, kurse ajo që ata e kanë caktuar për Allahun - ajo arrin te idhujt e tyre. Sa gjykim të shëmtuar bëjnë ata! (Sure En’am: 136)

Siç përmendet në ajetin e mësipërm, idhujtarët e ndajnë një pjesë të pasurisë së tyre për Zotin dhe një pjesë tjetër për idhujt e tyre. Kjo është karakteristikë e gabimit të idhujtarëve.


Ta duash një qenie më shumë se Zotin apo ta duash atë ashtu siç duhet njeriu ta duaj Zotin është përsëri një formë e idhujtarisë. Po ashtu, dikush i cili i frikësohet një qenie ashtu si duhet t’i frikësohet Zotit, e hyjnizon atë, pasi që pandeh se ajo qenie posedon një fuqi të veçantë dhe të pavarur nga Zoti.

Mirëpo, Muslimanët besojnë me vendosmëri se çdo gjë është krijuar prej Zotit, se të gjitha çështjet janë të rregulluara prej Tij, se gjërat nuk kanë ndonjë fuqi për të dhënë një rezultat në mënyrë të pavarur, se çdo ngjare është paracaktuar dhe krijuar nga ana e Zotit, se Zoti është poseduesi i vullnetit dhe vendimit përfundimtar. Ky është ai sistem besimi që Zoti na shpall në Kuran. Devijimi nga këto parime, duke besuar se çdo gjë ndodhë vetvetiu, si rezultat i rastësive, duke ia veshur fuqinë për të krijuar disa arsyeve tjera, janë të gjitha forma të përshkrimit të shokëve Zotit.

Zoti nuk fal idhujtarinë:

Vërtet, Allahu nuk fal që të adhurohet dikush apo diçka tjetër veç Atij, por gjnahet e tjera më të vogla ia fal kujt të dojë. Kushdo që i bën shok Allahut (në adhurim), ai me të vërtetë, ka humbur dhe është larguar shumë prej udhës së drejtë. (Sure Nisa: 116)

Kur i Dërguari i Zotit (savs) u pyet: “Cili është gjynahu më i madh në sytë e Zotit?”, ai ka thënë po ashtu: “T”i bësh rival Zotit edhe pse Ai i vetëm të ka krijuar.” (Buhariu)



ULERËSIMI I ALLAHUT ME ULERËN E TIJ TË VËRTETË

Ata nuk e çmojnë Allahun me vlerën e Tij të vërtetë. Vërtet, Allahu është i Fortë dhe i Plotfuqishëm. (Sure Haxh: 74)

Zoti manifeston fuqinë dhe dijeninë e Tij të pafund në çdo gjë. Përsosmëria në çdo pjesë të trupit të njeriut, dijenia në krijimin e një lule, bukuria e ngjyrës dhe aroma e saj, madhështia e qiejve dhe e gjithësisë, rregulli i orbitave të planetëve, peshqit në thellësitë e oqeanëve dhe krijimi i ndërlikuar në çdo gjë që ju shihni rreth jush, janë të gjitha manifestime të qarta të fuqisë dhe pafundësisë së Zotit. Disa jobsimtar, përkundër perceptimit të ekzistencës së

Zotit dhe të fuqisë së pafund të Tij, e mohojnë Atë nga mendjemadhësia. Ata nuk e pranojnë madhështinë e vërtetë të Zotit. Pasi që atyre u mungon urtësia, ata dështojnë të shohin shenjat e qarta të ekzistencës së Zotit dhe të madhësisë së Tij të manifestuara në të gjitha qeniet. Pavëmendja e këtyre njerëzve shprehet në një ajet si vijon:

Eh, sa shumë shenja ka në qiej dhe në Tokë, pranë të cilave ata kalojnë pa ua vënë veshin! (Sure Jusuf: 105)

Vetëm ata të cilët mendojnë mbi qëllimin e krijimit përreth tyre, të cilët kanë aftësi të qartë të dallimit, të cilët përdorin mendjet dhe ndërgjegjet e tyre, mund ta njohin të vërtetën që këto shenja lënë të kuptohet. Ata janë ata të cilët besojnë. Një nga vetitë kryesore të një besimtarit është aftësia e tij për të qenë mendjemprehtë. Besimtarët, të cilët janë të aftë të shfrytëzojnë mendjet e tyre, të liruar nga arsyet e rrejshme, arrijnë të njohin mjeshtërinë dhe fuqinë e Zotit përmes krijimit të Tij dhe në këtë mënyrë arrijnë të kenë vlerësim të drejtë të madhësisë dhe lavdisë së Tij. Një ajet i Kuranit rrëfen se ata të cilët janë të aftë të mendojnë qartë shohin shenjat e Zotit ngado që të kthehen:

Me të vërtetë, në krijimin e qiejve dhe të Tokës, në këmbimin e natës me ditën, në anijet që lundrojnë nëpër det për t'ua sjellë dobi njerëzve, në ujin që Allahu zbret prej qiellit, duke ngjallur përmes tij tokën e vdekur dhe duke shpërndarë gjithfarë gjallesash, në lëvizjen e erërave dhe në retë që qëndrojnë midis qiellit e Tokës, pra, në të gjitha këto, sigurisht që ka shen-

ja për njerëzit me intelekt. (Sure Bekare: 164-)

Një person që është i prirur kështu njeh shenjat e ekzistencës së Zotit ngado që shikon, duke e kuptuar drejt fuqinë e Tij të vërtetë. Besimtarët vazhdimisht përkujtojnë Zotin në mendjet e tyre, ndërsa shumica e njerëzve jetojnë jetët e tyre pa menduar për këto fakte. Në një ajet të Kuranit, sjellja ideale e një Muslimani përshkruhet si vijon:

...për ata që e përmendin Allahun duke qëndruar në këmbë, ndenjor ose shtrirë dhe që meditojnë për krijimin e qiejve dhe të Tokës (duke thënë): "O Zoti Ynë! Ti nuk i ke krijuar kot këto - lartësuar qofsh (nga çdo e metë)! Prandaj na ruaj nga ndëshkimi i zjarrit. (Sure Ali Imran: 191)



MADHËSHTIA DHE FUQIA E PAFUND E ZOTIT

Zoti krijoi rregullin e gjithësisë në mënyrë madhështore për t'i lejuar njeriut që të kuptoj madhësitinë e Tij. Një varg që i referohet këtij rregulli thotë: "...që ju ta dini se Allahu është i Fuqishëm për çdo gjë dhe se Ai përfshin gjithçka në diturinë e Tij..." (Sure Talak: 12). I përballur me madhësitinë e detajeve të këtij rregulli, njeriu mahnitet, duke e pranuar urtësinë, dijeninë dhe fuqinë e pafund të Zotit.

Aq e gjerë është dijenia e Zotit sa që ajo që për ne është

“e pafund” në sytë e Tij tashmë ka marr fund. Çdo ngjarje që ka ndodhur që nga krijimi i kohës, deri në thellësi të përjetshmërisë, u paracaktua dhe përfundoj në sytë e Zotit. (Shih Pafundësia dhe Realiteti i Fatit, nga Harun Jahja) Kjo përshkruhet në Kuran si vijon:

Ne çdo gjë e kemi krijuar me masë të paracaktuar. Ne urdhërojmë vetëm një herë dhe vullneti Ynë përmushet sa çel e mbyll sytë. Ne tashmë i kemi shkatërruar të ngjashmit me ju (në mosbesim). Prandaj, a ka ndonjë që të marrë këshillë?! Çdo bëmë e tyre është shënuar në librat (e engjëjve që regjistrojnë veprat). Çdo gjë, e madhe a e vogël qoftë, është shënuar (në Leuhi Mahfudh). (Sure Kamer: 49-53)

Njeriu duhet të përpiqet të vlerësoj gjerësinë e dijenisë së Zotit dhe të reflektoj për të kuptuar madhësitinë e Tij.

Me miliarda njerëz janë shfaqur në tokë që nga kohët që s’mbahen mend. Prandaj, Zoti krijoi me miliarda gifte të syve, me miliarda shenja të ndryshme të gishtërinjve, me miliarda inde të ndryshme të syve, me miliarda tipe të ndryshme njerëzish... Po të dëshironte Ai, Ai do të mund të krijonte po ashtu me miliarda më shumë. Siç thuhet në Kuran: "... Ai shton në krijim çfarë të dojë. Allahu, me të vërtetë, është i pushtetshëm për çdo gjë." (Sure Fatir: 1)

Zoti posedon gjithashtu fuqinë për të krijuar shumë gjëra tjera përtej imagjinatës sonë të kufizuar. Të gjitha thesaret që Zoti i ka dhuruar në këtë botë për robërit e Tij janë

të përfshira në shikimin e Tij. Ai na zbret ne vetëm atë që Ai dëshiron, gjithçka me masë të caktuar:

Nuk ka asnjë send që të mos gjenden tek Ne thesaret e tij; por prej tij Ne japim me masë të caktuar. (Sure Hixhr: 21)

Kjo gjë, e manifestuar gjithandej në krijimin madhështor të Zotit, vlen si për atë që dimë ashtu edhe për atë që ne nuk dimë. Zoti tërheq vëmendjen për këtë në vargun: "... Ai krijon edhe gjëra që ju nuk i dini." (Sure Nahl: 8), Ai krijon shumë gjëra tjera për të cilat jemi plotësisht të pavetëdijshëm.

Zoti ka krijuar shumë bota dhe qenie të cilat ne nuk mund t'i shohim. Për të kuptuar më mirë mundësinë e ekzistencës së botëve tjera, ne duhet të marrim parasysh si vijon: një fotografi është dy-dimensionale – gjerësia dhe gjatësia. Mirëpo, bota në të cilën jetojmë ne është tre-dimensionale – gjerësia, gjatësia dhe thellësia – (koha mund të konsiderohet si dimension i 4-të). Tjerat tejkalojnë aftësinë tonë të të kuptuarit. Mirëpo, në sytë e Zotit, ekzistojnë edhe dimensione tjera. Engjëjt, për shembull, janë qenie që jetojnë në një dimension tjetër. Sipas Kuranit, engjëjt mund të na shohin dhe dëgjojnë në dimensionin dhe hapësirën në të cilën ata jetojnë. Veç kësaj, dy engjëjt, që rrinë në dy krahë tonë, secili, në çdo moment, regjistron çdo fjalë që ne flasim dhe çdo vepër që bëjmë. E megjithatë, ne nuk i shohim ata. Xhinët janë po ashtu qenie të një dimension tjetër, siç informohemi nga Kurani. Ata, sikur ne qeniet njerëzore, sprovo-

hen po ashtu, gjatë gjithë jetës së tyre dhe në fund do të sillen për t'u gjykuar para Zotit. Megjithatë, ata posedojnë tipare krejtësisht të ndryshme nga njerëzit; ekzistenca e tyre varet nga një sistem i shkakut dhe pasojës krejtësisht i ndryshëm.

Këto janë të gjitha fakte që meritojnë vëmendje të kujdesshme në mënyrë që të fitojmë një kuptim më të mirë të krijimit të shkëlqyeshëm të Zotit. Është në fuqinë e Zotit të krijoj bota, qenie dhe rrethana të reja të panumërta. Veç kësaj, Ai është në gjendje të krijoj secilën prej tyre me një shkallë të pakufishëm të dallimit. Vërtet, në një natyrë të panjohur për ne, Zoti do të krijojë Parajsën dhe Ferrin. Përderisa sistemet që i lihen vetvetes në këtë botë anojnë kah plakja, degjenerohen dhe përfundimisht shuhen, në Parajsë, e pandikuar nga kalimi i kohës, asgjë s'do të shkatërrohet; "lumenj qumështi shija e të cilit nuk do të ndryshojë kurrë" është një shembull për të sqaruar këtë veçori të Parajsës. Trupi i njeriut gjithashtu nuk do të degjeneroj; dhe asgjë asnjëherë nuk do të vjetërsohet. Sipas Kuranit, çdokush në Parajsë do të jetë i një moshe të njëjtë, do të jetojnë së bashku përjetësisht, në gjendjen më të mirë, dhe pa u plakur apo pa humbur bukurinë e tyre. Zoti na informon po ashtu në Kuran se në të do të ketë burime që gëlojnë për ne prej të cilave të pimë. Ferri, në anën tjetër, do të jetë krejtësisht ndryshe, në të, Zoti do të krijojë vuajtje të paimagjinueshme. Askush nuk do të jetë në gjendje që ta përfytyroj dhimbjen që shkaktojnë vuajtjet e tilla derisa nuk

i përjeton ato.

Zoti ka vënë një kufi mbi çdo gjë në këtë botë. Çdo gjë ka një ekzistencë të kufizuar. Duke qenë kështu, për të kuptuar “përjetësinë” dhe fuqinë e pafund të Zotit, ne duhet të përdorim mendjet tona dhe t’i krahasojmë këto ide me diçka që është e njohur. Ne mundemi të dimë vetëm deri në atë shkallë që na e lejon Zoti. Zoti, megjithatë, ka dijeni të pakufishme. Të marrim parasysh shembullin vijues, Zoti ka krijuar 7 ngjyra themelore. Është e pamundshme për ne të përfytyrojmë një ngjyrë tjetër. (Ky rast është e ngjashme me përshkrimin e ngjyrës së kuqe dikujt që ka lindur i verbër; asnjë përshkrim nuk do të ishte i përshtatshëm.) Mirëpo, Zoti është në gjendje të krijoj më shumë se këto ngjyra themelore. Ndonëse, veç nëse Ai ashtu dëshiron, ne kurrë nuk do të jemi në gjendje të kuptojmë atë që tejkalon atë që Ai ka dashur që ne të dimë.


Gjithçka që posa kemi përmendur i takon asaj njohurie që Zoti ka ndarë për ne në këtë botë. Por, një çështje meriton vëmendje të posaçme; pasi që pushteti dhe fuqia e Zotit është e pakufishme, gjithçka mund të ndodhë, dhe në çdo kohë, me vullnetin e Tij. I Dërguari i Zotit, Profeti Muhammed (savs) iu referua po ashtu fuqisë së amshueshme të Zotit kur tha: “Shtatë palë qiej dhe shtatë palë tokë nuk janë më shumë në Dorën e Zotit se sa një farë mustarde në dorën e ndonjërit prej jush.” Zoti shpjegon pafundësinë e dijenisë së Tij në Kuran si vijon:

Sikur të gjithë drurët, që gjenden në Tokë, të ishin

pena e deti bojë shkrimi e t'i shtohen atij edhe shtatë dete të tjera, nuk do të shtereshin fjalët e Allahut. Pa dyshim, Allahu është i Plotfuqishmi dhe i Urti. (Sure Lukman: 27)

Shkurt, pa marr parasysh se sa shumë përpiqemi ta bëjmë këtë, ne kurrsesi nuk do të arrijmë të kuptojmë gjerësinë e dijenisë së Zotit, pasi që ajo është e pakufishme. Ne mund ta kuptojmë atë vetëm aq sa këtë na e lejon Zoti:

Allahu! Nuk ka zot tjetër (që meriton adhurimin) përveç Tij, të Gjallit, të Përrjetshmit, Mbajtësit të gjithçkaje! Atë nuk e kaplon as dremitja, as gjumi! Atij i përket gjithçka që gjendet në qiej dhe gjithçka që gjendet në Tokë. Kush mund të ndërhyjë tek Ai për ndokënd pa lejen e Tij? Ai di çdo gjë që ka ndodhur përpara dhe çdo gjë që do të ndodhë pas njerëzve, kurse ata nuk mund të përvetësojnë asgjë nga Dituria e Tij, përveçse aq sa Ai dëshiron. Kursi-u i Tij shtrihet mbi qiejt dhe Tokën dhe Ai nuk e ka të rëndë t'i ruajë ato. Ai është i Larti, Madhështori! (Sure Bekare: 255)



DASHURIA NDAJ ZOTIT DHE FRIKA NDAJ ZOTIT

Allahu ka thënë: “Mos adhuroni dy zotëra, sepse Ai është një Zot i vetëm, prandaj frikësohuni vetëm prej

Meje!" (Sure Nahl: 51)

Frika ndaj Zotit është njëra prej vetive themelore të një besimtari. Pasi që, është frika ndaj Zotit ajo që e afron një person më afër Zotit, bën që ai të arrijë një besim më të thellë, i mundëson atij që të sillet me përgjegjësi ndaj Zotit në çdo moment të jetës së tij, dhe ushqen përkushtimin e tij ndaj vlerave të Kuranit. Fakti se parimet e mira morale që Zoti pret prej robërve të Tij vijnë me frikën ndaj Zotit vërtohen nga Profeti Muhammed (savs) me këto fjalë:

Kini frikën e Zotit kudo që jeni; nëse e pasoni një vepër të ligë me një të mirë do ta fshini atë; dhe me njerëz silluni në mënyrë të njerëzishme. (Tirmidhiu)

Dështimi për të kuptuar kuptimin e vërtetë të frikës së Zotit bën që disa ta ngatërrojnë atë me lloje tjera të frikave të dynjasë. Mirëpo, frika ndaj Zotit dallon shumë prej të gjitha llojeve tjera të frikës.

Fjala arabe e përdorur në tekstin origjinal të Kuranit (kashijat) shpreh respektin e madh. Në anën tjetër, fjala arabe e përdorur në Kuran për t'iu referuar frikave të dynjasë (hauf) shpreh një lloj të thjeshtë të frikës, sikur frika që ndien njeriu kur ndeshet me një kafshë të egër.

Një shqyrtim i vetive të Zotit shpie drejt një kuptimi më të mirë të këtyre dy llojeve të frikës, të dyjat të shprehura me anë të fjalëve të ndryshme në arabisht. Frikat e dynjasë shkaktohen zakonisht nga një kërcënim i mundshëm. Për shembull, njeriu mund të frikësohet prej të qenit i vararë. Mirëpo, Zoti është i Gjithë-mëshirshëm, Mëshirëploti dhe i

Drejti. Prandaj, frika ndaj Zotit nënkupton shprehjen e respektit ndaj Tij, ndaj të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit dhe të Drejtisë dhe shmangien e tejkalimit të kufizimeve të Tij, rebelimit ndaj Tij dhe të qenit prej atyre të cilët e meritojnë ndëshkimin e Tij.

Pasojat që shkakton në njerëz frika ndaj Zotit e bën këtë ndryshim të dukshëm. I përballur me një frikë vdekjeprurëse, një person bën panik; i pushtuar nga pafuqia dhe dëshpërimi, ai dështon të përdor arsyen e tij dhe të gjej një zgjidhje. Mirëpo, frika ndaj Zotit vë në veprim urtësinë dhe mbështetjen në ndërjegjen e njeriut. Përmes frikës ndaj Zotit, një person nxitet t'i shmanget asaj që është e keqe, e degjeneruar dhe që ka gjasë t'i shkaktoj atij dëm fizik ose mental. Frika ndaj Zotit ushqen urtësinë dhe largpamësinë. Në një ajet të Kuranit, Zoti na bën me dije se urtësia dhe gjykimi i drejtë fitohet përmes frikës ndaj Zotit:

O besimtarë! Nëse i frikësoheni Allahut, Ai do t'ju japë aftësinë e të gjykuarit drejt, do t'ju lirojë nga gjynahet tuaja dhe do t'ju falë. Allahu zotëron mirësi të madhe. (Sure Enfal: 29)

Frikat e dynjasë i shkaktojnë shqetësim njeriut. Mirëpo, frika ndaj Zotit jo vetëm që i jap shkas forcës së shtuar shpirtërore, por gjithashtu edhe qetësisë së mendjes.

Përmes frikës ndaj Zotit njeriu iu shmanget atyre veprimeve të këqija me të cilat nuk është i kënaqur Zoti. Një varg i Kuranit thotë: "... Allahu nuk i do njerëzit arrogantë e mburravecë." (Sure Nisa': 36). Një person që i frikësohet

Zotit përpiqet me mish e shpirt të përmbahet prej mburrjes dhe të përfshihet sa më shumë në punë të mira për të fituar dashurinë e Zotit. Për atë arsye, frika ndaj Zotit dhe dashuria ndaj Zotit janë reciprokisht të veçanta.

Frika ndaj Zotit, në të vërtetë, largon pengesat që pengojnë afrimin tek Zoti dhe të fituarit e dashurisë së Tij. Pengesa e parë prej tyre është epshi i njeriut. Prej Kuranit, ne mësojmë se ekzistojnë dy anë të shpirtit; njëra që frymëzon të keqen dhe ligësinë dhe tjetra, ruajtjen nga çdo prirje ndaj të keqes.

...Për shpirtin dhe për Atë që e ka përsosur, duke ia bërë të njohur atij të keqen e të mirën! Vërtet, kushdo që e pastron shpirtin, do të shpëtojë, ndërsa kushdo që e shtyp atë (me punë të këqija), do të dështojë. (Sure Shems: 7-10)

Lufta kundër kësaj të keqe dhe mosnënshtrimi asaj, kërkon fuqi shpirtërore. Kjo fuqi buron nga frika ndaj Zotit. Një person që i frikësohet Zotit nuk robërohet nga egoizmi i shpirtit të tij. Frikë-respekti që ai ndien për Zotin e largon atë prej mendimeve dhe veprave që nuk e meritojnë kënaqësinë e Tij. Një ajet i Kuranit na informon se vetëm ata të cilët i frikësohen Zotit do të jenë të kujdesshëm ndaj paralajmërimeve që u janë komunikuar atyre:

Në të vërtetë, paralajmërimi yt i sjell dobi vetëm atij që ndjek Këshillën (Kuranin) dhe i frikësohet të Gjithëmëshirshmit, edhe pa e parë Atë. Këtij jepi lajmin e mirë për falje gjynahesh dhe shpërblim bujar!

(Sure Ja Sin: 11)

Njeriu duhet të përpiqet për të ndier një frikë më të thellë ndaj Zotit. Ai duhet të mendoj për krijimin e Zotit dhe të pranoj mjeshtërinë dhe fuqinë supreme të paraqitur në çdo hollësi të tij për të arritur këtë ndjenjë fisnike. Të menduarit e tij duhet t'i mundësojë atij të arrij kuptim më të mirë të madhësisë së Tij dhe të rris frikë-respektin e tij. Vërtet, Zoti na urdhëron:

O besimtarë! Kijeni frikë Allahun ashtu si i takon Atij dhe vdisni vetëm duke qenë myslimanë! (Sure Ali Imran: 102)

Prandaj frikësojuni Allahut sa të mundeni, dëgjoni e binduni dhe shpenzoni për bamirësi në të mirën tuaj. Ata që e ruajnë veten nga lakmia e saj, pikërisht ata janë të fituarit. (Sure Tegabun: 16)

Sa më shumë që një besimtar i frikësohet Zotit, aq më shumë e do Atë. Ai e pranon më mirë bukurinë e krijimit të Zotit. Ai fiton aftësinë për të njohur shumëllojshmërinë e njerëzve, natyrën, kafshët dhe në çdo gjë rreth tij, si shëmbëllime të vetive madhështore të Zotit. Rrjedhimisht, ai fillon të ndiej një dashuri më të thellë për këto mirësi, si edhe për Zotin, Krijuesin e tyre.

Një person i cili e kupton këtë fshehtësi di po ashtu se ç'është dashuria ndaj Zotit. Ai e do Zotin, mbi dhe para çdo gjëje tjetër dhe kupton se të gjitha qeniet janë vepër e krijimit të Tij. Ai i do ato në pajtim me kënaqësinë e Zotit. Ai i do besimtarët që i janë nënshtruar Atij, por ndien neveri për

ata të cilët janë të pabindur ndaj Tij.

Dashuria e vërtetë që e bën njeriun të lumtur, që i sjell atij gëzim dhe qetësi, është dashuria e Zotit. Format tjera të dashurisë, që ndjehen për qenie tjera pos Zotit, në fjalët e Kuranit, dashuri e veçantë për idhujtarët dhe që si pasojë shpie drejt dhimbjes, pikëllimit, trishtimit dhe ankthit. Dashuria e idhujtarëve dhe dashuria që besimtarët ndiejnë për Zotin krahasohen në një ajet si vijon:

E megjithatë, disa njerëz zgjedhin (për të adhuruar) në vend të Allahut (zota) të tjerë, (duke i konsideruar) si të barabartë me Atë dhe duke i dashur siç duhet Allahu. Por ata që besojnë, e duan shumë më tepër Allahun... (Sure Bekare: 165)



KURANI ËSHTË UDHËRRËFYES

Ky është Libri në të cilin nuk ka dyshim. Ai është udhërrëfyes për të devotshmit (Sure Bekare: 2)

Kurani është fjala e Zotit. Zoti ka shpallur Kuranin për ta prezantuar Vetveten, për t'ju komunikuar njerëzve qëllimin e ekzistencës së tyre, për t'i informuar ata për natyrën e kësaj jete, bazën e sprovës së tyre në këtë botë dhe përgjegjësitë e tyre ndaj Krijuesit të tyre, për t'ju dhënë atyre lajmin e mirë për ahiretin dhe për t'ju treguar se çka

përbën parimet e mira morale. Kurani iu shpall Profetit Muhammed (savs) nga Xhibrili. I liruar prej çfarëdo shtrembërimi të mundshëm, është Libër për të cilin njerëzit do të mbajnë përgjegjësi në Ditën e Gjykimit. Në një ajet, Zoti na informon se Kurani është nën mbrojtjen e Tij:

Sigurisht, Ne e kemi shpallur Kuranin dhe, sigurisht, Ne do ta ruajmë atë. (Sure Hixhr: 9)

Stili unik i Kuranit dhe urtësia supreme e mësimeve të tij, është dëshmi e qartë e të qenit të tij fjalë e Zotit. Veç kësaj, Kurani ka shumë veti të mrekullueshme, që vërteton se është shpallje e Zotit. Një numër zbulimesh shkencore, të cilat janë zbuluar vetëm në shekujt 20 dhe 21, u shpallën në Kuran 1400 vjet më parë. Ky informacion, e cila ishte e pamundur të verifikohet në mënyrë shkencore në kohën e shpalljes së Kuranit, ka vërtetuar edhe njëherë se është fjalë e Zotit.

Një karakteristikë tjetër e rëndësishme e Kuranit është se – në kundërshtim me Teuratin dhe Ungjillin – ai nuk përmban asnjë kundërshti çfarëdo qoftë. Kjo është megjithatë dëshmi e mëtejme se është fjalë e Zotit. Zoti përkujton njerëzimin për këtë fakt si vijon:

A nuk përsiatin ata për Kuranin! Sikur ai të mos ishte prej Allahut, do të gjenin në të shumë kundërthënie. (Sure Nisa: 82)

Kurani është udhërrëfyes për njerëzimin. Ai është po ashtu kriteri përfundimtar me anën e të cilit dallohet e drejta nga e gabuara, për të cilën arsye një tjetër emër për

Kuranin është emri “Furkan,” domethënë “Dalluesi”:

...Ai ka zbritur edhe Dalluesin (e së vërtetës nga e pavërteta). Ata që nuk besojnë shpalljet e Allahut, i pret dënim i ashpër; Allahu është i Plotfuqishëm dhe i Zoti për shpagim. (Sure Ali Imran: 4)

Kurani është libër që këshillon njerëzimin:

Ky (Kuran) është shpallje e qartë për njerëzit, me qëllim që ata të marrin paralajmërim nëpërmjet tij, që ta dinë se Allahu është Një Zot i Vetëm dhe që të këshillohen njerëzit e mençur! (Sure Ibrahim: 52)

Kurani është shpallja e fundit nga Zoti dhe do të mbetet e tillë deri në Ditën e Gjykimit. Edhe pse Teurati dhe Ungjilli ishin shkrime të shenjta të vërteta në kohën kur ato u shpallën, ato e kanë humbur vlerën e vërtetësisë së tyre, për arsytet e shpjeguara më herët. Zoti na informon se, në sytë e Tij, Islami është feja e vetme:

Kush kërkon tjetër fe përveç Islamit, nuk do t’i pranohet dhe ai në botën tjetër do të jetë i humbur. (Sure Ali Imran: 85)



BESIMI NË

LIBRAT E SHPALLUR NGA ZOTI DHE BESIMI NË TË DËRGUARIT E TIJ

Që prej kohës kur Profetit Adem (as) zbriti në tokë, Zoti i ka dërguar të dërguar çdo kombi, për t'iu komunikuar atyre ekzistencën e Zotit dhe të ahiretit, dhe për t'iu komunikuar porosinë hyjnore. Disa prej këtyre të dërguarve janë ata profetë emrat e të cilëve përmenden në Kuran dhe të cilëve u janë shpallur librat. Një Musliman nuk guxon të bëj dallim midis tyre, por duhet t'i respektoj të gjithë ata në mënyrë të barabartë, pasi që ata të gjithë ishin profetë të fesë së vërtetë. Zoti i urdhëron Muslimanët të besojnë në të gjithë profetët, pa bërë dallim:

Thoni: “Ne besojmë në Allahun, në atë që na është shpallur neve (Kuranin), në atë që i është shpallur Ibrahimit, Ismailit, Is’hakut, Jakubit dhe Esbatëve (12 bijve të Jakubit), në atë që i është dhënë Musait e Isait dhe në atë që u është dhënë profetëve nga Zoti i tyre. Ne nuk bëjmë kurrfarë dallimi midis tyre dhe vetëm Allahut i përulemi”. (Sure Bekare: 136)

I vetmi libër ndaj të cilit është përgjegjës njerëzimi në kohën tonë është Kurani, i shpallur Profetit Muhammed (savs). Pasi që, siç bën me dije Kurani, librat e mëhershëm, të cilët në fillim u shpallën për t'ia komunikuar të vërtetën

njerëzimit, më vonë u ndryshuan përmes plotësimeve dhe heqjeve:

Mjerë ata që me duart e tyre shkruajnë Librin, e pastaj thonë: “Kjo është prej Allahut” që për këtë të kenë ndonjë dobi të vogël (materiale). Mjerë ata për çfarë kanë shkruar me duart e tyre dhe mjerë ata për çfarë kanë fituar! (Sure Bekare: 79)

Për këtë arsye, Islami u shpall nga Zoti si religjionin përfundimtar të Zotit. Në një ajet të Kuranit, urdhëron si vijon:

...Sot jua përsosa fenë tuaj, e plotësova dhuntinë Time ndaj jush dhe zgjodha që Islami të jetë feja juaj. (Sure Ma'ide: 3)

Kurani na bën me dije po ashtu se Profeti Muhammed (savs) është profeti i fundit:

Muhammedi nuk është babai i askujt prej burrave tuaj, por është i Dërguari i Allahut dhe vula e profetëve; Allahu është I Gjithë-dijshëm për çdo gjë. (Sura al-Ahzab: 40)

Rrjedhimisht, religjioni i vetëm i vërtetë për të gjitha kohërat, që nga epoka e Profetit Muhammed (savs), deri në Ditën e Ringjalljes, është Islami, dhe burimi i tij, Kurani.



ENGJËJ

BESIMI NË


Engjëjt, siç na informon Kurani, janë robërit e Zotit, të cilët zbatojnë urdhrat e Tij. Zoti u ka caktuar atyre detyra të ndryshme. Xhibrili, për shembull, ju dërgon shpalljet hyjnore profetëve. Ekzistojnë engjëjt në secilën anë të një njeriu, duke shkruar çka do që ai bën; engjëjt që i mirëpresin njerëzit në Parajsë dhe ata engjëjt të cilët janë roje të Xhehenemit; engjëjt të cilët marrin shpirtrat e njerëzve, engjëjt të cilët i ndihmojnë besimtarët, engjëjt të cilët u komunikojnë të dërguarve se cilët nga mesi i njerëzve të pabindur do të marrin ndëshkimin e Zotit, engjëjt të cilët japin lajmin e mirë për një të porsalindur të dërguarve. Engjëjt janë qenie të bindura, të cilat nuk janë kurrë arrogante, por që vazhdimisht e lavdërojnë Zotin:

Allahut i përulet në sexhde çdo gjallesë, në qiej dhe në Tokë, edhe engjëjt, të cilët nuk janë kryelartë. (Sure Nahl: 49)

Gjatë historisë, engjëjt i kanë dërguar njerëzimit porositë e Zotit. Engjëjt u janë paraqitur shumë profetëve, dhe, në disa raste, besimtarëve të sinqertë, si Merjemja, dhe u kanë komunikuar atyre urdhrat dhe urtësinë hyjnore të Zotit. Zoti na informon për besimin në engjëjt në Kuran, duke e bërë atë parakusht të besimit në Kuran për Islamin. Në një ajet të Kuranit, thuhet se besimi në engjëjt është veti e një

besimtari:

I Dërguari beson në atë (Kuranin) që i është shpallur nga Zoti i tij e po ashtu dhe besimtarët: të gjithë besojnë në Allahun, engjëjt e Tij, librat e Tij dhe të dërguarit e Tij (duke thënë): “Ne nuk bëjmë dallim mes asnjërit prej të dërguarve të Tij”. Ata thonë: “Ne dëgjojmë dhe bindemi. Faljen Tënde kërkojmë, o Zoti Ynë dhe te Ti do të kthehemi!” (Sure Bekare: 285)



NATYRA E PËRKOSSHME E JETËS SË KËSAJ BOTE

Jeta e kësaj bote është sprovë për njerëzimin. Edhe pse Zoti ka krijuar joshje të panumërta për njeriun në këtë botë, Ai po ashtu e ka paralajmëruar atë që të mos merret së tepërmi me to e të harroj Zotin dhe fenë e Tij. Në një ajet të Kuranit, Zoti shpall se zbukurimi i kësaj bote është i përkohshëm dhe se kënaqësia e vërtetë është Parajsja, si shpërblim për kënaqësinë e Zotit:

Çdo gjë që gjendet në Tokë, Ne e kemi bërë stoli për të, për të provuar se kush prej tyre punon më mirë. (Sure Kehf: 7)

Ta dini, se jeta në këtë botë, nuk është tjetër veçse lojë,

dëfrim e zbukurim, si dhe mburrje ndërmjet jush e rivalitet për më shumë pasuri dhe fëmijë! Ajo i shëmbëllen bimës, e cila pas shiut rritet dhe i gëzon bujqit, por më vonë zverdhet, thahet dhe mbetet pa vlerë. Në botën tjetër ju presin vuajtje të mëdha ose falja e Allahut dhe kënaqësia e Tij; jeta në këtë botë është vetëm kënaqësi e rreme. (Sure Hadid: 20)

Përderisa besimtari i gëzon po ashtu ato mirësi që përshkruhen si kënaqësi të kësaj bote, për dallim nga jobesimtari, ai nuk i konsideron ato si qëllimin e jetës së tij. Ai mund të dëshiroj t'i posedoj ato, por vetëm me qëllim që t'i falënderohet Zotit dhe t'i përdor ato për të fituar kënaqësinë e Zotit. Ai nuk i ndjekë ato për shkak të lakmisë. Sepse, ai është i vetëdijshëm se ajo që është e kësaj bote është jetëshkurtër sikurse vet jeta e tij. Ai është i vetëdijshëm se, pas vdekjes së tij, këto gjëra nuk do t'i sjellin dobi atij. Veç kësaj, ai e di se nëse ndjekë vetëm gjërat e dynjasë, me çmimin e qëllimeve më fisnike, ai për to sakrifikon ahiretin e tij. Në një ajet të Kuranit, kjo e vërtetë e rëndësishme rrëfëhet si vijon:

Burrave u është hijeshuar dashuria për gjërat e dëshiruara: për gratë, fëmijët, arin dhe argjendin e grumbulluar, kuajt e bukur, bagëtitë dhe arat e lëruara. Këto janë kënaqësitë e kësaj jete, por shumë më i mirë është kthimi tek Allahu. (Sure Ali Imran: 14)

Joshja e gjërave të kësaj bote është një faktor thelbësor në sproven që i është vënë njeriut në këtë botë. Shejtani shfry-

tëzton pandërprerë joshjet në përpjekjet e tij për të mashtruar njeriun. Megjithatë, besimtarët janë ata të cilët, edhe pse mund të joshen nga tundime të tilla, janë të vetëdijshëm për vlerën e tyre të vërtetë. Duke e ditur se këto janë mirësi të përkohshme të kësaj bote dhe se ata me anë të tyre vihen në sprovë, joshjet mashtruese të këtyre gjërave nuk i mashtrojnë ata. Për këtë arsye, ata nuk mashtrohen nga Shejtani dhe janë në gjendje të shpëtojnë vetveten nga vuajtja e përjetshme. Në Kuran, Zoti paralajmëron njerëzimin si vijon:

O njerëz! Pa dyshim, premtimi i Allahut (Dita e Gjykimit) është i vërtetë, prandaj të mos ju mashtrojë kurrsesi jeta e kësaj bote dhe të mos ju mashtrojë djalli për Allahun. (Sure Fatir: 5)

Në anën tjetër, ata të cilët nuk kanë besim dhe kështu janë të privuar nga urtësia, ndiejnë një prirje të brendshme ndaj kësaj bote. Nën ndikimin e Shejtanit, ata e bëjnë arritjen e gjërave të përkohshme të kësaj bote qëllimin përfundimtar të jetëve të tyre. Gjendja e këtyre njerëzve përshkruhet si vijon:

Por ju doni këtë jetë (kalimtare) e për jetën tjetër nuk kujtoheni! (Sure Kijame: 20-21)



ËSHTË DUKE U SPROVUAR

NJERIU

Zoti ka krijuar çdo gjë në pajtim me urtësinë e Tij hyjnore dhe shumë gjëra i ka vënë në shërbim të njeriut. Pa dyshim, shumë gjëra në gjithësi, nga sistemi diellor e deri në përmasën e oksigjenit në atmosferë, prej kafshëve që na sigurojnë mishin dhe qumështin e deri te uji, janë krijuar për të shërbyer njeriun. Nëse ky fakt pranohet si i qartë, rezulton se është e palogjikshme të mendohet se kjo jetë nuk ka qëllim. Padyshim se kjo jetë ka një qëllim, që Zoti e shpjegon si vijon:

Xhindet dhe njerëzit i kam krijuar vetëm që të Më adhurojnë. (Sure Dharijat: 56)

Vetëm një numër i vogël i njerëzve e kuptojnë këtë qëllim të krijimit dhe jetojnë jetët e tyre në pajtim me të. Zoti na ka dhuruar jetën në tokë për të na provuar nëse do të jetojmë në pajtim me këtë qëllim. Ata të cilët i shërbejnë Zotit sinqerisht, dhe ata të cilët ngrenë krye kundër Tij, do të dallohen nga njëri tjetri në këtë dynja. Të gjitha ato mirësi (trupit, shqisat, prona e tij...) që i janë dhënë njeriut në këtë dynja, janë një mjet përmes të cilit Zoti e sprovon atë. Në një ajet të Kuranit, Zoti shpall si vijon:

Ne e krijuam njeriun nga një pikë farë e përzier, për ta sprovuar dhe e bëmë që të dëgjojë dhe të shohë. (Sure Insan: 2)

Detyra e njeriut në këtë botë është të ketë besim në Zotin dhe në ahiret, të sillet në pajtim me urdhrat e Kuranit, të respektoj kufijtë e përcaktuar nga Zoti dhe të përpiqet të fitoj kënaqësinë e Tij. Sprovat e vazhdueshme të kësaj jete me kalimin e kohës zbulojnë ata njerëz të cilët janë të përkushtuar për t'i përmbushur këto detyra. Pasi që Zoti kërkon një besim të drejtë dhe të sinqertë, i cili është besim i tillë që nuk mund të arrihet vetëm duke thënë: “Unë besoj” – njeriu duhet të demonstroj se ka besim të vërtetë në Zotin dhe në fenë e Tij, dhe se ai nuk do të shmanget nga rruga e drejtë pavarësisht nga dhelpëritë e Shejtanit. Po ashtu, ai duhet të demonstroj se nuk do t'i pasojë jobesimtarët dhe as që do të parapëlqej dëshirat e vetes së tij mbi kënaqësinë e Zotit. Reagimi i tij ndaj ngjarjeve në jetën e tij do t'i zbulojë të gjitha këto cilësi. Zoti do të krijojë disa vështirësi, gjatë të cilave njeriu duhet të tregoj durim, për të shfaqur shkallën e devotshmërisë së tij ndaj besimit në Zotin. Ky fakt në Kuran shpallet si vijon:

Vërtet mendojnë njerëzit, se do të lihen të thonë “Ne besojmë”, pa u vënë në provë?! (Sure Ankebut: 2)

Në një ajet tjetër, Zoti thotë se ata të cilën thonë: “Ne besojmë” do të sprovohen:

A mendoni se do të hyni në Xhenet, pa i provuar Allahu ata që kanë luftuar prej jush dhe pa i provuar ata që kanë duruar? (Sure Ali Imran: 142)

Duke qenë kështu, zhgënjimi përballë vështirësive nuk do të ishte përgjigja e drejtë që mund t'i lejohet vetvetes.

Vështirësitë e tilla mund të jenë sprova të rënda apo vetëm probleme të vogla të përditshme. Një besimtar duhet të konsideroj çdo rrethanë të tillë si pjesë të sprovës së përcaktuar për të, të ketë besim në Zotin dhe të sillet në pajtim me kënaqësinë e Tij. Në një ajet të Kuranit, këto vështirësi me të cilat përballen besimtarët rrëfohen si vijon:

Sigurisht që Ne do t'ju provojmë me frikë dhe uri, me dëmtim të pasurisë, të njerëzve dhe të të lashtave! Prandaj, përgëzoji të duruarit, (Sure Bekare: 155)

Profeti Muhammed (savs) i ka paralajmëruar po ashtu besimtarët për këtë, duke thënë: “Kushdo që e ka pranuar atë (sprovën e Zotit), do të shijojë Kënaqësinë e Zotit dhe kushdo që është i pakënaqur me të, do të shkaktojë Pakënaqësinë e Zotit.” (Tirmidhiu)

Jo vetëm që vështirësitë, por edhe mirësitë në këtë dynja do të shërbejnë për të sprovuar njeriun. Zoti e sprovon njeriun me çdo të mirë që Ai ia jap njeriut, për të parë se a do të jetë apo jo falënderues. Po ashtu, Zoti krijon rrethana të shumta përmes të cilave njeriu përvetëson një qëndrim të caktuar. Gjatë këtyre sprovave, njeriu mund të formoj një vendim, ose në pajtim me kënaqësinë e Zotit, ose në pajtim me veten e tij. Nëse ai e pranon një ngjarje të tillë si sprovë prej Zotit dhe e përshtatë sjelljen e tij në përputhje me të për të fituar kënaqësinë e Allahut, atëherë ai arrin sukses në sprovën e tij. Mirëpo, nëse vendimi i tij është në pajtim me urdhrat e shpirtit të tij, do të jetë një gjynah, për të cilin do

të pendohet shumë në ahiret, si edhe burim ankthi në këtë botë, pasi që kjo do ta mendojë ndërgjegjen e tij.

Vërtet, Zoti krijoi gjithçka që ndodhë në këtë botë si sprovë. Ato ngjarje që konsiderohen të jenë “rastësi” e kulturuar apo “fat i keq” nga të padijshmit, janë në të vërtetë rrethana të krijuara në pajtim me urtësitë më të mëdha të një plani hyjnor. Lidhur me këtë, Zoti jap shembullin e Hebrenjve të cilët thyen urdhëresën e Sabatit, të joshur nga bollëku i peshqve:

Pyeti ata për qytetin që gjendej në bregdet dhe për çfarë i gjeti banorët e tij kur thyen urdhëresën e Sabatit (së shtunës)! Atë ditë u vinin peshqit me shumicë, ndërsa ditëve tjera që nuk i kremtonin, nuk u vinin. Kështu, Ne i vumë në provë, sepse bënë punë të mbrapshta. (Sure A'raf: 163)

Hebrenjtë mund të kenë menduar se peshku ju ofrua një të Shtunë “rastësisht,” por, kjo ndodhi ishte paracaktuar si një sprovë për ta prej Zotit. Siç e bën të qartë ky shembull, ekziston një qëllim hyjnor dhe një sprovë në çdo ndodhi në jetë. Gjithçka që i ndodhë një besimtari është përcaktuar në mënyrë që ai të ketë këtë mendim në mendje dhe që të përpiqet të ketë sukses në sprovën e vet dhe të përvetësoj një formë të sjelljes që është në pajtim me pëlqimin e Allahut.



VDEKJA NUK ËSHTË FUNDI

Çdo njeri do ta shijojë vdekjen! Ne ju vëmë në provë me të keqe dhe me të mirë dhe te Ne do të ktheheni. (Sure Enbija': 35)

Vdekja, e cila padyshim se do të na ndodhë të gjithëve, është një e vërtetë me shumë rëndësi në jetën e njeriut. Kurrë nuk mund të dimë me saktësi se çfarë do të përjetojmë për një orë apo madje në momentin vijues. Duke qenë kështu, është e qartë se sa e gabueshme do të ishte të planifikojmë jetët tona duke u mbështetur ne ngjarjet që mund të mos ndodhin kurrë. Vdekja, në anën tjetër, është gjëja e vetme e cila është e sigurt se do të ndodhë me siguri. Vetëm pranimi i kësaj të vërtete themelore na bën të kuptojmë se ne duhet të mbështesim jetët tona në pajtim me të. Vdekja është po ashtu pjesë e sprovës së njeriut. Zoti na informon në Kuran se Ai krijoi vdekjen dhe jetën për ta vënë njeriun në sprovë.

Ai i ka krijuar jetën dhe vdekjen, për t'ju provuar se kush prej jush do të veprojë më mirë; Ai është i Plotfuqishmi dhe Falësi i madh. (Sure Mulk: 2)

Vdekja është fundi vetëm i jetës së kësaj bote – pra fundi i sprovës – dhe fillimi i jetës tjetër. Për këtë arsye, besimtarët nuk i frikësohen vdekjes. Mendimi për vdekjen nuk i

shqetëson ata, sepse çdo moment i jetës së tyre jetohe në kërkim të veprave të mira si përgatitje për ahiretin. Por, jobesimtarëve vdekja u shkaktonte shqetësim të madh, pasi që ata e kuptojnë atë si asgjësim të plotë. Prandaj, ata i shmangen çdo mendimi për vdekjen. Por është e kotë. Asnjë shpirt s'mund t'i shmangët vdekjes kur të ketë arritur koha e përcaktuar për të:

Kudo që të gjendeni, do t'ju arrijë vdekja, madje, qofshi edhe në kështjellat më të forta... (Sure Nisa: 78)

T'i shmangesh mendimit për vdekjen është t'i shmangesh të vërtetës. Pasi që në fund vdekja do t'i vijë njeriut herët a vonë, është gjë e urtë që të sillemi duke mbajtur gjithnjë në mendje mendimin për vdekjen. Kjo është natyra e arsyeshme në përputhje me të cilën veprojnë besimtarët. Derisa t'i arrij vdekja, ata bëjnë vepra të mira, ashtu siç na urdhëron Allahu në Kuran:

Dhe adhuroje Zotin tënd derisa të të vijë vdekja! (Sure Hixhr: 99)

Të menduarit për vdekjen forcon shpirtin e njeriut. Ai e ndalon epshin e njeriut që të mos e devijoj atë, duke u joshur prej sprovave të rrejshme të kësaj bote. Ai rrenjos në të vendosmërinë dhe përkushtimin për t'ju shmangur të gjithave formave të sjelljes me të cilat Allahu është i pakënaqur. Kjo është arsyeja që një besimtar duhet të mendoj shpesh për vdekjen, duke mos harruar kurrë se të gjithë njerëzit, duke përfshirë atë vet, një ditë do të vdesin.

Nga Kurani, ne mësojmë atë që në të vërtetë i ndodhë atij që vdes, dhe çfarë ai apo ajo vërtet përjeton apo ndien. Kur ne e shohim dikën duke vdekur, ne vetëm vrojtojmë “vdekjen biologjike” të tij. Mirëpo, e vërteta është se, personi që është duke vdekur, edhe pse në një dimension krejtësisht tjetër, përballët me engjëjt e vdekjes. Nëse ai është jobesimtar, vdekja e vet i shkakton atij dhimbje të madhe. Engjëjt e vdekjes, pas nxjerrjes së shpirtit të tij, e rrahin dhe e mendojnë atë. Tronditja e jobesimtarit përshkruhet si vijon:

...Ah sikur t'i shihje keqbërësit gjatë agonisë së vdekjes, kur engjëjt zgjasin duart (duke thënë): “Dorëzoni shpirtat tuaj! Sot ju do të ndëshkoheni me dënim poshtërues për shkak të të pavërtetave që keni thënë për Allahun dhe që keni shpërfillur shpalljet e Tij”. (Sure En'am: 93)

E çfarë do të bëjnë ata, kur engjëjt do t'ua marrin shpirtin, duke i rrahur në fytyrat dhe shpinat e tyre?! Kjo, sepse ata pasuan atë që shkakton zemërimin e Allahut dhe urreyen pëlqimin e Tij e kështu, Ai ua zhvlerësoi atyre veprat. (Sure Muhammed: 27-28)

Në anën tjetër, vdekja premtion gëzim dhe lumturi të madhe për besimtarët. Për dallim nga jobesimtarët, shpirtat e të cilëve shkulen prej tyre dhunshëm, shpirtat e besimtarëve nxjerrën prej tyre butësisht (Sure Nazi'at: 2). Kjo përvojë është e ngjashme me rastin e shpirtit në gjumë, i cili e lëshon trupin dhe lëviz për në një dimension tjetër (Sure Zumer: 42)

Allahu ua merr shpirtat atyre që u ka ardhur çasti i vdekjes dhe atyre që nuk kanë vdekur, por që janë në gjumë. Pastaj Ai ndal shpirtin e atij që i është caktuar vdekja, ndërsa të tjerëve ua lë deri në një kohë të caktuar. Me të vërtetë, këto janë shenja për njerëzit që mendojnë. (Sure Zumer: 42)

Ata do të hyjnë në Xhenetet e Adnit, ku rrjedhin lumenj dhe ku ka gjithçka, që ata dëshirojnë. Kështu i shpërblen Allahu punëmirët, të cilëve engjëjt ua marrin shpirtat, duke qenë të pastër. U thonë atyre: "Shpëtimi qoftë mbi ju! Hyni në Xhenet, si shpërblim për veprat që keni kryer!" (Sure Nahl: 31-32)



BESIMI NË AHIRET

(JETËN E PËRTEJME)

Jeta e kësaj bote, nuk është gjë tjetër, veçse argëtim dhe lojë. Ndërsa jeta e botës tjetër, pikërisht ajo është jeta e vërtetë. Veç sikur ta dinin! (Sure Ankebut: 64)

Njeriun e pret ose shpërblimi ose ndëshkimi në fund të kësaj prove domethënë jetës së kësaj bote. Ata të cilët kryejnë vepra të mira dhe kanë besim në Zotin, fitojnë kënaqësinë e Zotit dhe shpërblehen me një Parajsë të përjetshme.

Mirëpo, të ligët, ata të cilët e mohojnë Zotin dhe tejkalojnë kufijtë e Tij, meritojnë Ferrin, ku ata do të takojnë ndëshkimin e përjetshëm.

Njeriu kurrë nuk zhduket në të vërtetë. Që nga momenti që jemi krijuar, fillon jeta jonë e amshueshme. Domethënë, ne tashmë kemi filluar jetën tonë të përjetshme. Me të mbaruar të sprovës sonë, dhe menjëherë pas momentit të kalimit (tranzicionit), të cilin ne e quajmë vdekje, ne do të jetojmë në përjetësi. Se a do të jetohet ajo kohë në vuajtje apo në lumturi varet nga përkushtimi i njeriut ndaj Fjalës së Zotit, Kuranit, dhe në përpikërinë e tij për t'i respektuar kufijtë e Tij. I tërë ky sistem, gjithësia, bota, qeniet njerëzore dhe çdo gjë e krijuar për qeniet njerëzore, janë projektuar për një qëllim përfundimtar; jetën në ahiret. Zoti na bën me dije se ekzistenca e njeriut në këtë botë nuk është e paqëllim dhe se, në ahiret, pas jetës së shkurt të tij në këtë botë, njeriu do t'i duhet të jap përgjegjësi për veprat e tij:

Mos vallë, keni menduar që Ne ju kemi krijuar kot dhe që nuk do të ktheheshit te Ne (për t'ju gjykuar)?!"
(Sure Mu'minun: 115)

Jeta e përjetshme është një mirësi madhështore krahasuar me jetën shumë të shkurtër të tanishme, e cila nuk është më shumë se një "moment". Është me të vërtetë mëshirë e madhe që, si shpërblim për pasimin e atyre prirjeve themelore që janë të natyrshme për një qenie njerëzore – siç është posedimi i besimit dhe kërkimi i kënaqësisë së Allahut, Zoti i dhuron atij shpërblimin e jetës së përjetshme

në Parajsë:

Ata që besojnë dhe bëjnë vepra të mira, Ne do t'i vendosim në pallatet e Xhenetit, ku rrjedhin lumenj; aty do të qëndrojnë përgjithmonë. Sa i bukur është shpërblimi i atyre që punojnë mirë, (Sure Ankebut: 58)

Jeta e ahiretit është e rëndësishme në kuptimin se ajo përfaqëson manifestimin e drejtësisë së pakufishme të Zotit, si edhe dhurimin e mirësive të pafund të Tij. Ahireti do të jetë vendi ku çdo gjë që bën njeriu në këtë botë do të shpagueshet, ku drejtësia dhe mëshira do të mbizotërojnë. Drejtësia absolute e ahiretit përshkruhet në një ajet si vijon:

... Thuaju: "Kënaqësitë e kësaj jete janë të vogla. Jeta tjetër është më e mirë për ata që e kanë frikë Allahun e s'bëjnë gjynahe. Juve nuk do t'ju bëhet asnjë fije padrejtësi. (Sure Nisa: 77)

Zoti, i Cili posedon fuqinë për të krijuar gjithçka, padyshim se mund të krijoj ahiretin:

Vallë, a nuk është i Zoti Ai që krijoi qiejt dhe Tokën, t'i rikrijojë ato? Po! Ai është Krijuesi i çdo gjëje dhe i Gjithëdijshmi! (Sure Ja Sin: 81)



BESIMI NË DITËN E GJYKIMIT

"Se Ora (e Kiametit) do të vijë, gjë për të cilën s'ka

dyshim dhe se Allahu do t'i ringjallë ata që janë në varre.” (Sure Haxh: 7)

Dita e Gjykimit është dita kur kohëzgjatja e përcaktuar për këtë gjithësi mbaron. Atë ditë, sprova e vënë mbi njerëzimin do të mbarojë dhe kjo botë, arena e kësaj sprove, do të shpërbëhet. Ky është fundi i premtuar nga Zoti në Kuran. Se jeta fizike e kësaj gjithësie do të mbarojë është një fakt i vërtetuar me anë të vrojtimeve shkencore. Në Kuran, një numër ajetesh që përshkruajnë Ditën e Gjykimit janë si vijon:

Dhe kur t'i fryhet një herë Surit, kur toka dhe malet të ngrihen lart e të tharmohen me një goditje shkatërrimtare, atëherë do të ndodhë Ngjarja e pashmangshme (Kiameti). Dhe do të çahet qielli, që atë ditë do të jetë i thyeshëm. (Sure Hakka: 13-16)

Në Ditën e Gjykimit, Zoti do të ringjallë njerëzit të cilët kanë vdekur:

Pastaj, ju me siguri që do të ringjallen në Ditën e Kiametit. (Sure Mu'minun: 16)

Atë ditë, Zoti do t'i tubojë njerëzit dhe do t'i ringjallë të gjithë ata:

Allahu! Nuk ka zot tjetër të vërtetë përveç Atij. Ai do t'ju mbledhë në Ditën e Kiametit, për të cilën nuk ka dyshim aspak! E kush është në fjalë më i vërtetë se Allahu? (Sure Nisa: 87)

Dita e Zgjimit/Ngjitjes është dita kur çdo njeri do të

qëndrojë në praninë e Zotit dhe çdo vepër e mundshme që është kryer do të zbulohet:

Atë Ditë do të mbeteni zbuluar dhe asnjë fshehtësi e juaja nuk do të mbetet pa u shfaqur: (Sure Hakka: 18)

Dhe në Ditën e Kiametit, Ne do të vendosim peshore të sakta e askush nuk do të pësojë asnjë padrejtësi. Ne do të sjellim (për gjykim) çdo vepër, qoftë kjo edhe sa pesha e një kokrrë sinapi. Ne jemi të mjaftueshëm për llogaritje. (Sure Enbija: 47)

Dita e Ringjalljes është ajo kohë kur Zoti do t'i jap fund ekzistencës fizike të gjithësisë, tokës dhe çdo gjëje në të. Në atë moment, Zoti, Krijuesi i gjithë atyre ligjeve, do t'i bëjë të gjitha ligjet fizike të padobishme, që do të zgjidhin një zinxhir të fatkeqësive të pashembullta që tejkalojnë imagjinatën e njeriut.

Një sërë baraspeshash delikate na e bëjnë të mundur jetën në këtë botë. Largësia e botës ndaj diellit dhe shpejtësia me të cilën ajo sillet rreth boshtit të saj, janë vendosur në mënyrë të përkryer për hir të mbijetesës së njeriut në këtë planet. Forca e gravitacionit, atmosfera që shërben si një çati për të mbrojtur tokën prej trupave qiellor që mund ta shkatërrojnë atë dhe shumë sisteme tjera të ngjashme janë krijuar të gjitha në mënyrë të veçantë. Është Allahu, Zoti i botëve, i Cili krijoi këto baraspesha të akorduara në mënyrë të përsosur për të mundësuar jetën, madje edhe para se të ekzistonte njeriu. Është Allahu i Cili mban

gjithësinë në çdo moment:

Me të vërtetë, Allahu mban ekuilibrin e qiejve dhe të Tokës, që të mos shkatërrohen. Kur ato nisin të shkatërrohen, askush nuk mund t'i mbrojë, pos Tij. Me të vërtetë, Ai është i Butë dhe Falës (i gjynaheve). (Sure Fatir: 41)

Atë moment që Zoti do të ndalojë funksionimin e këtyre baraspeshave delikate të larmishme, çdo gjë do të zhduket. Ai moment do të jetë Dita e Gjykimit. Njerëzit shpirtrat e të cilëve do të përjetojnë Ditën e Gjykimit do të lemerisen nga llahtari i asaj dite:


O njerëz, frikësojuni Zotit tuaj, sepse dridhja e Orës (së Kiametit), është vërtet një ngjarje e madhe! Ditën, që do të shihni atë, çdo grua me fëmijë në gji do ta harrojë fëmijën e saj dhe çdo grua shtatzënë do ta hedhë barrën e vet. Njerëzit do t'i shihni si të dehur, ndonëse ata nuk do të jenë të dehur, por dënimi i Allahut është i ashpër. (Sure Haxh: 1-2)

Qysh do të mbroheni ju, nëse mbeteni jobesimtarë, Ditën në të cilën fëmijët do të thinjen? (Sure Muzzemmil: 17)

Zoti na informon se cilat gjëra të tjera do të ndodhin në Ditën e Gjykimit:

**Kur Dielli të mblidhet e të humbë shkëlqimin;
kur yjet të rrëzohen
dhe malet të lëvizin tutje;**

kur devetë barrse të braktisen
 dhe egërsirat të tubohen;
 kur detet të vlojnë
 dhe shpirtrat të bashkohen (me trupat);
 kur foshnja e varrosur për së gjalli të pyetet
 për çfarë faji ishte vvarë;
 kur fletët të shpërndahen
 dhe qielli të zhvishet;
 kur Xhehenemi të flakërojë
 dhe Xheneti të afrohet:
 atëherë çdokush do të marrë vesh çfarë kishte përgatitur
 (për këtë Ditë). (Sure Tekuir: 1-14)



RINGJALLJA

Ai na sjell shembull, duke harruar krijimin e vet dhe
 thotë: “Kush do t’i ngjallë eshtrat kur të kalben?”
 Thuaj: “Do t’i ngjallë Ai që i krijoi ato për herë të parë;
 Ai ka njohuri të plotë për çdo krijesë; (Sure Ja Sin: 78-

79)

Ringjallja është një rikrijim i jetës pas vdekjes. Vdekja nuk është ndërprerje e ekzistencës. Bota, të cilën Zoti e ka krijuar për ta sprovuar njeriun, do të shërbej për të caktuar vendin e tij në jetën e përtejme. Pas vdekjes, çdo njeri do të rikrijohet në një trup të ri dhe do të fillojë jetën e tij në ahiret, ku Zoti do ta vendos atë ose në Ferr ose në Parajsë, varësisht nga veprat e tij në këtë botë. Ringjallja e njerëzimit është gjë e lehtë për tu bërë për Zotin. Në një ajet, ngritja e gjithë njerëzve së bashku në Ditën e Gjykimit përshkruhet si vijon:

Jemi Ne ata që japin jetën dhe vdekjen. Te Ne do të kthehet çdo gjë! Atë Ditë, toka do të hapet e ata do të dalin me nxitim. Për Ne është e lehtë t'i mbledhim ata të gjithë. (Sure Kaf: 43-44)

Ca njerëz dyshojnë se Zoti mund ta ringjallë njeriun. Mirëpo, është Zoti Ai i Cili së pari krijoi njeriun nga asgjëja, dhe prandaj, padyshim se ka fuqi që ta sjellë atë përsëri në jetë. Zoti na bën me dije për këtë të vërtetë në Kuran:

O njerëz, nëse ju dyshoni në ringjalljen, mendoni si Ne ju kemi krijuar prej dheut, pastaj prej pikës së farës, pastaj prej droçkave të gjakut, pastaj prej një cope mishi me trajtë të plotë ose jo të plotë, për t'ju bërë të qartë! Dhe Ne e mbajmë në mitër atë që duam deri në kohën e caktuar. Pastaj ju nxjerrim si fëmijë e pas kësaj do të arrini moshën e pjekurisë. Disa nga ju

vdesin e disa ngelin deri në pleqëri të thellë, që të mos dinë asgjë nga ajo që kanë ditur më parë. Dhe ti e sheh tokën të tharë, por, kur Ne lëshojmë ujë mbi të, ajo trazohet dhe gufon dhe prej saj mbijnë gjithfarë lloj bimësh të mrekullueshme në çift. Kjo ndodh (që ta dini) se Allahu është e Vërteta, se Ai i ringjall të vdekurit, se Ai është i Fuqishëm për çdo gjë, (Sure Haxh: 5-6)

Për të na dhënë një shembull të këtij rikrijimi, Zoti na tërheq vëmendjen ndaj fenomeneve natyrore që na rrethojnë. Pas shiut, Zoti ringjall dheun e vdekur dhe shterpë ku asgjë s'mund të rritej ashtu që bëhet përsëri i frytshëm. Në mënyrë të ngjashme, sjellja e njeriut përsëri në jetë pas vdekjes së tij është gjë e lehtë për Allahun:

Ai i dërgon erërat si lajmëtare të mëshirës së Tij. Kur erërat lëvizin retë e rënda me shi, Ai i çon ato tek ndonjë vend i vdekur, ku lëshon shi dhe me anë të tij nxjerr lloj-lloj frutash; po kështu do t'i ringjallë edhe të vdekurit. Këta janë shembuj që t'ua vini veshin. (Sure A'raf: 57)

Çdo gjë është e lehtë për Allahun. Kurani thotë se krijimi apo ringjallja e njerëzimit është sikurse ajo e një njeriut të vetëm:

Krijimi dhe ringjallja e ju të gjithëve është njësoj si krijimi i një njeriu të vetëm. Vërtet, Allahu i dëgjon dhe i sheh të gjitha. (Sure Lukman: 28)



DITA E GJYKIMIT

Ata pyesin: “Kur do të jetë Dita e Gjykimit?” (Sure Dharijat: 12)

Është e sigurt ajo që ju premtohet dhe çdo shpërblim e dënim do të ndodhë! (Sure Dharijat: 5-6)

Zoti e mban njeriun përgjegjës për veprat e tij. Çdo person, i cili është sprovuar në këtë botë, do të thirret për të dhënë llogari për veprat e tij në Ditën e Gjykimit. Atë ditë, ai do të dëshmojë se nuk është mbajtur e fshehtë prej Zotit dhe do të zbulohet çdo vepër e mirë apo e keqe:

Për Ditën, kur ata do të paraqiten të zbuluar, kur asgjë e tyre nuk do të jetë e fshehtë për Allahun. Kujt i përket pushteti i asaj dite? Allahut, të Vetmit, Ngadhënjimtarit! Atë ditë, çdo njeri do të shpërblehet sipas asaj që ka punuar; atë ditë nuk ka padrejtësi! Allahu, me të vërtetë, është i shpejtë në llogari. (Sure Gafir: 16-17)

Njeriu nuk e merr gjithherë ndëshkimin që e meriton në këtë botë. Megjithëse Zoti ju jap disa syresh kohë, Ai na informon se do ta paguajnë shtrenjtë për të gjitha veprat e këqija në ahiret. Duke qenë kështu, nuk është gjë e mençur

që ata të cilët bëjnë vepra të paligjshme të pandehin se i janë shmangur ndëshkimit, vetëm për arsye se i janë shmangur ligjit dhe kështu nuk u ndëshkuan në këtë botë. Në Ditën e Gjykimit, ata do të shohin se njeriu nuk mund të mbaj asgjë të fshehtë prej Zotit. Me emrin e Tij “el Hafiz” (Ai që ruan çdo gjë në hollësi), Zoti di për secilën vepër të njeriut dhe i urdhëron engjëjt e Tij të mbajnë shënim. Zoti na bën me dije për këtë fakt në Kuran:

Dy engjëjt i rrinë atij nga e djathta dhe e majta, dhe, për çdo fjalë që ai thotë, ka pranë vetes një mbikëqyrës të gatshëm (për ta shënuar atë). (Sure Kaf: 17-18)

Zoti, i Cili ka dijeni për çdo gjë deri në hollësinë më të vogël, i Cili është dëshmitar i çdo momenti të jetës së njeriut, qoftë nëse ai e shqipton me zë një fjalë apo e mban të fshehtë në zemrën e tij, do ta gjykojë njeriun me drejtësi në Ditën e dhënies së llogarisë, kur do të bëhet plotësisht i njohur atributi i drejtësisë së Zotit:

Dhe në Ditën e Kiametit, Ne do të vendosim peshore të sakta e askush nuk do të pësojë asnjë padrejtësi. Ne do të sjellim (për gjykim) çdo vepër, qoftë kjo edhe sa pesha e një kokrrë sinapi. Ne jemi të mjaftueshëm për llogaritje. (Sure Enbija: 47)

Zoti, i Drejti, është pafundësisht i mëshirshëm dhe i butë ndaj robërve të Tij. Zoti premton se ai i cili bën një vepër të mirë do të pranojë dhjetë sikur ajo, ndërsa ai i cili bën një vepër të keqe do të shpërblehet vetëm me atë që meriton:

Kush bën një vepër të mirë, do të shpërblehet dhjetëfish.

Kush bën një vepër të keqe, do të dënohet vetëm sipas gjy-nahut që ka bërë dhe nuk do t'i bëhet kurrfarë padrejtësie. (Sure En'am: 160)

Në kohën e dhënies së llogarisë, njerëzit do të çohen ose në Parajsë ose në Ferr, varësisht nga ana nga e cila kanë marr librat e tyre:

Ai, të cilit do t'i jepet libri i tij në dorën e djathtë, do ta ketë të lehtë llogarinë dhe do të kthehet i gëzuar te të afërmit e tij. Kurse ai, të cilit do t'i jepet libri i tij pas shpinës, do të lutet për të vdekur dhe në zjarr do të digjet, sepse ai jetonte i shku-jdesur në familjen e tij, duke menduar se kurrë nuk do të kthehej (për të dhënë llogari). Po, Zoti i tij, sigurisht që i ka ndjekur të gjitha punët e tij! (Sure Inshikak: 7-15)



XHENETI DHE XHEHENEMI

Nuk janë të barabartë banorët e Xhehenemit dhe banorët e Xhenetit; banorët e Xhenetit do të jenë të fituarit. (Sure Hashr: 20)

Kur Zoti krijoi Profetin Adem (as), njeriun e parë në tokë, dhe gruan e tij, Ai i vendosi ata në Xhenet. Mirëpo, siç na bën me dije Kurani, në Xhenet, Ademi dhe gruaja e tij u joshën nga e keqja dhe shkelën ndalesën e Zotit.

Kjo histori na mundëson të arsyetojmë që njeriu ka prir-

je të vlerësoj bukurinë dhe vlerën e një gjëje të bukur nëse mund ta krahasoj atë me diçka të keqe. Ai e kupton ligësinë e të keqes nëse e njih atë që është e mirë. Vlera e një gjëje mund të vlerësohet me anë të krahasimit. Pasi që së pari ishin vendosur në Xhenet, Profeti Adem (as) dhe gruaja e tij nuk kishin qenë kurrë në një vend që do të mund të krahasohej me Xhenetin dhe kështu dështuan në vlerësimin e dalimit. Prandaj, njerëzve të cilët përndryshe do të dështonin në vlerësimin e mirësive dhe përsosmërisë së Xhenetit, ju është dhënë mundësia për të krahasuar duke qenë së pari të krijuar në këtë botë, një vend ku e mira dhe e keqja ekzistojnë njëkohësisht.

Me qëllim të krahasimit më të mirë, në Ditën e Gjykimit, kur çdo njeri do të ringjallet, Zoti do t'i tubojë të gjithë njerëzit rreth Xhehenemit dhe pastaj do të shpëtojë ata besimtarë të cilët ishin të vëmendshëm ndaj respektimit të kufijve të Tij. Ai i cili e sheh Xhehenemin me sytë e tij padyshim se do të kuptojë, nga përvoja e tij, se Xheneti është shpëtim dhe mirësi e madhe:

Për Zotin tënd! Ne do t'i tubojmë ata dhe djajtë, pastaj do t'i sjellim ata të gjunjësuar rreth Xhehenemit! Pastaj do të ndajmë prej çdo grupi atë që ka qenë më kokëfortë ndaj të Gjithëmëshirshmit. Ne pastaj e dimë më së miri se kush prej tyre e ka merituar të digjet në të. Dhe nuk ka asnjë prej jush që të mos arrijë tek ai (Xhehenemi). Kjo është vendosur prerazi nga Zoti yt. Pastaj do t'i shpëtojmë ata që kanë qenë besimtarë dhe do t'i lëmë keqbërësit të gjunjësuar në të. (Sure

Merjem: 68-72)

Ata që besojnë dhe bëjnë vepra të mira, Ne do t'i shpiem në kopshte të Xhenetit, nëpër të cilat rrjedhin lumenj. Aty do të qëndrojnë vazhdimisht e përgjithmonë. Ky është premtimi i vërtetë i Allahut. E kush është më i vërtetë se Allahu në fjalë?! (Sure Nisa: 122)

Ata të cilët kanë zgjedhur rrugën e gabuar, edhe pse u paralajmëruan dhe u udhëzuan për në rrugën e drejtë, do të vendosen në Xhehenem, ku do t'i nënshtrohen një ndëshkimi të përjetshëm. Padyshim, kjo është përmbushja e drejtësisë së pafund të Zotit:

Jobesimtarët do të shtyhen grupe-grupe në Xhehenem dhe, kur të arrijnë atje, do të hapen dyert e tij dhe rojtarët do t'u thonë atyre: "A nuk ju kanë ardhur të dërguar midis jush, të cilët ju lexonin shpalljen e Zotit tuaj e ju tërhiqnin vërejtjen për takimin e kësaj dite?!" Mohuesit do të thonë: "Po, është e vërtetë!" E kështu përmbushet fjala e Allahut për dënimin e mohuesve. (Sure Zumer: 71)

Natyra e njeriut është qenësisht e prirur ndaj praktikimit të vlerave dhe karakterit të lavdëruar në Kuran. Ky është modeli i besimtarit që kënaq Zotin. Zoti ia qartëson njeriut atë që është e keqe dhe atë që është e mirë. Veç kësaj, Zoti i ka dhuruar njeriut sytë, veshët, një zemër dhe aftësinë e gjykimit, me anë të së cilës të bëj dallimin e të mirës prej të keqes. Pasi që, përmes këtyre cilësive, njeriu mundet lehtësisht të njohë ekzistencën dhe madhësitinë e Zotit, dhe të

ketë besim në Të, është e qartë se ata të cilët zgjedhin të mos besojnë nuk e meritojnë të trajtohen njëjtë si besimtarët. Zoti përshkruan se si do të dallohen këto dy grupe në ahiret si vijon:

Allahu i thërret njerëzit për në Shtëpinë e shpëtimit (Xhenet) dhe udhëzon kë të dojë në rrugën e drejtë. Ata që bëjnë vepra të mira, do të kenë shpërblim të mirë, madje edhe më tepër! Fytyrat e tyre nuk do t'i mbulojë as errësira, as poshtërimi. Ata do të jenë banorë të Xhenetit, në të cilin do të banojnë përherë. Kurse ata që bëjnë vepra të këqija, do të kenë dënim gjegjës për atë të keqe. Ata do t'i mbulojë poshtërimi, pa pasur askënd që t'i mbrojë nga dënimi i Allahut, me fytyrat e tyre si të ishin të mbuluara me copa të errëta nate. Këta do të jenë banorët e zjarrit dhe aty do të qëndrojnë përgjithmonë. (Sure Junus: 25-27)

Zoti jap një përshkrim të jetës në Xhenet. Ai ua premtion këtë jetë atyre të cilët besojnë dhe sillen në mënyrë të drejtë në këtë botë. Ky është lajmi i mirë që u komunikohet besimtarëve:

Ata janë të afërtit (tek Allahu),

në kopshtet e kënaqësisë.

Shumica e tyre janë prej të lashtëve,

ndërsa një pakicë prej brezave të mëvonshëm.

Ata do të qëndrojnë në divane të stolisura me ar e gurë të çmuar,

të mbështetur në to përballë njëri-tjetrit.
Do t' u sillen rreth (për shërbim) djelmosha përherë të rinj,
me kupa, ibrikë dhe gota me pije të kulluar, që rrjedh e prej së cilës nuk do t' u dhembë koka dhe nuk do t' u humbë mendja,
e me fruta të cilat do t' i zgjedhin vetë dhe mish shpendësh që ua ka ënda.
Për ata ka edhe hyrie symëdha, të ngjashme me margaritarët e ruajtur, si shpërblim për atë që kanë punuar.
Aty nuk do të dëgjojnë biseda të kota, as fjalë gjynahesh,
por vetëm fjalët "Paqe, paqe"!
E njerëzit e së djathtës – sa të nderuar që janë fatlumët!
Ata do të qëndrojnë në mes të lotusëve pa gjemba dhe bananeve të mbushura me fruta,
nën hije të gjera,
pranë një uji rrjedhës,
dhe mes frutave të llojllojshme,
të cilat kurrë nuk sosen, as nuk janë të ndaluara;
dhe në shtroje të ngritura (ku i presin hyrijet),
të cilat Ne i kemi krijuar në një formë të veçantë (jo të

lindura),
dhe i kemi bërë ato virgjëresha,
të dashura për bashkëshortët e tyre dhe moshatare me
ta,
për njerëzit e së djathtës.
Janë shumë nga të lashtët

e shumë edhe nga të mëvonshmit. (Sure Vakia: 11-40)

Ndërsa Zoti u jap besimtarëve lajmin e mirë të Xhenetit, një vend i lumturisë dhe shpëtimit me mirësi të panumërta. Ai po ashtu i bën me dije jobesimtarët se ata do të dërgohen në Xhehenem. Kurani jap një përshkrim të Xhehenemit, një vend i vuajtjes së padurueshme:

**Po njerëzit e së majtës – sa të poshtëruar janë fatkeqët!
Ata do të jenë në afshin përcëllues të zjarrit dhe ujit të
valuar**

**dhe nën hijen e një tymi të zi,
e cila nuk do të jetë as e freskët e as e këndshme.**


**Ata, para kësaj, jetonin në luks
dhe në vazhdimësi bënë gjynahe të rënda,
duke thënë: “Vallë, pasi të vdesim e të bëhemi pluhur
e eshtra,**

vërtet do të ringjallemi?!

Vallë, edhe të parët tanë të lashtë?!”

**Thuaju (o Muhammed): “Me siguri, edhe të parët, edhe
të**

mbramët,
do të tubohen në një ditë të caktuar.
Dhe atëherë ju, o jobesimtarë të humbur,
me siguri që do të hani nga pema e zekumit,
me të cilën do të mbushni barkun.
Pastaj do të pini ujë të valuar,
madje do të pini ashtu siç pi deveja e etshme".
Kështu do të jetë gostia e tyre në Ditën e Llogarisë!
(Sure Vakia: 41-56)



QËLLIMI ËSHTË QË TË ARRIHET KËNAQËSIA E ZOTIT

Thuaj: "Unë jam urdhëruar që ta adhuroj Allahun me përkushtim të sinqertë.(Sure Zumer: 11)

Me të kuptuar shtrirjen e fuqisë së pafund të Zotit, të harrosh ekzistencën e Tij dhe të mbetesh i pavëmendshëm është thjeshtë mashtrim i vetvetes. Ajo që Zoti kërkon prej

qenieve njerëzore është që ata të përpiqen të fitojnë kënaqësinë e Tij si prioritetin e tyre të vetëm në jetë.

Pasi që është Zoti Ai i Cili krijoi njeriun, i siguroj atij riskun (mjetet për jetesë) dhe gjithë të mirat tjera dhe i Cili i premtoi atij jetën e amshueshme në ahiret, do të ishte një akt i mosmirënjohjes që njeriu të kërkoj kënaqësinë e të tjerëve, apo kënaqësinë e unit të tij, si qëllimin e tij kryesor. Ndëshkimi për një mosmirënjohje të tillë është zjarri i përjetshëm i xhehenemit.

Ekzistojnë dy zgjidhje që mund të bëj njeriu; ai mundet ose të mbështes jetën e tij në kënaqësinë e Zotit dhe kështu të fitoj shpërblimin e Xhenetit të Tij, ose të zgjedh rrugën e cila shpie në Xhehenem. Nuk ekziston opsioni i tretë për të. Kjo shprehet qartë në ajetin në vazhdim:

Cili është më i mirë, ai që themelet e godinës së vet i vë në përkushtimin ndaj Allahut dhe në kënaqësinë e Tij apo ai që themelet e godinës së tij i vë në bregun e gërryer dhe që rrokulliset me të në zjarrin e Xhehenemit?! Allahu nuk e udhëzon në rrugë të drejtë popullin keqbërës. (Sure Teube: 109)

Ato vlera të lavdëruara në Kuran janë ato që bazohen krejtësisht në atë që arrin kënaqësinë e Zotit. Për shembull, vet-sakrifikimi, i cili është i dashur për Zotin, vlen vetëm nëse njeriu nuk pret asnjë shpërblim për të, por vetëm të arrij të fitoj kënaqësinë e Zotit. Në Kuran rrëfëhet se besimtarët sillen në mënyrë të drejtë vetëm e vetëm për të fituar

miratimin e Zotit:

Ata i ushqejnë të varfrit, jetimët dhe të zënët rob edhe pse vetë janë nevojtarë, duke thënë: “Ne ju ushqejmë vetëm për hir të Zotit. Për këtë, nuk duam shpërblim e as falënderim! (Sure Insan: 8-9)

I Dërguari i Zotit, Profeti Muhammed (savs) ka thënë po ashtu në një hadith se kënaqësia e Zotit duhet gjithmonë të mbahet mbi kënaqësinë e njeriut:

Kushdo që përpiqet të fitoj kënaqësinë e Zotit me çmimin e pakënaqësisë së njerëzve, do të fitojë Kënaqësinë e Zotit dhe Zoti do të bëj që njerëzit të jenë të kënaqur me të. Dhe kushdo që përpiqet të fitoj kënaqësinë e njerëzve me çmimin e pakënaqësisë së Zotit, do të fitoj pakënaqësinë e Zotit dhe Zoti do të bëj që njerëzit të jenë të pakënaqur me të. (transmetuar nga Ibn Hibban në Sahihun e tij)

Nderi dhe kënaqësia më e madhe që njeriu mund të arrij ndonjëherë është kënaqësia e Zotit. Zoti bën që robërit e Tij të jenë të kënaqur me Të përmes mirësive të panumërta që Ai ju dhuron atyre. Në një ajet të Kuranit, shpërblimi i besimtarëve të cilët janë të kënaqur me Zotin, dhe me të cilët Zoti është i kënaqur, rrëfëhet si vijon:

Shpërblimi i tyre është te Zoti i tyre: kopshtet e Adnit, nëpër të cilat rrjedhin lumenj e ku do të banojnë përherë. Allahu është i kënaqur me ata, por dhe ata janë të kënaqur me Atë. Kjo është dhurata për ata që e kanë frikë Zotin e vet. (Sure Bejine: 8)

Kënaqësia e Zotit nuk fitohet vetëm duke kryer vepra të caktuara adhurimi në kohë të caktuara. Kënaqësia e Allahut fitohet po ashtu duke u sjellë në mënyrë të drejtë gjatë gjithë jetës. Ajeti në vazhdim na bën me dije se e tërë jeta e një besimtare duhet të orientohet drejt një qëllimi të vetëm:

Thuaj: “Në të vërtetë, namazi im, kurhani im, jeta ime dhe vdekja ime, i përkasin vetëm Allahut, Zotit të botëve.(Sure En’am: 162)



MËKATI DHE PENDIMI

Njëra prej arsyeve për ndarjen e njerëzve nga feja është se ata e konsiderojnë veten të pafalshëm për arsye të shqetësimit që ndiejnë për gjynahet që kanë bërë. Shejtani përpiket vazhdimisht të rrënjos dëshpërim të tillë në qeniet njerëzore. Njeriut i cili ka bërë një gjynah, ai vjedhurazi ia pëshpërit porosinë: “Ti je i keq dhe i pabindur ndaj Zotit.” Nëse ka bërë vetëm pak gjynahe, Shejtani e josh atë që të bëj edhe më shumë gjynahe. Drejt qëllimit të tij, Shejtani përdor ndjenjën e turpërimit që ndjen njeriu ndaj Zotit, por manipulon me këtë ndjenjë për ta larguar njeriun edhe më larg prej Zotit.

Megjithatë, si gjithë të tjerët, kjo dredhi e Shejtanit është dredhi e dobët. Fakti se dikush ka bërë një gjynah nuk do të

thotë se është mallkuar prej Zotit dhe se kurrë nuk do të jetë në gjendje të pasojë më rrugën e drejtë. Jo vetëm një gjynah të thjeshtë, por madje edhe po të bënte gjynahet më të mëdha, pa pushim, ai gjithmonë do të ketë mundësinë të pendohet dhe të kthehet kah Zoti. Zoti na bën me dije në Kuran se Ai do të fal çdo person i cili pendohet sinqerisht për gjynahet e tij, domethënë, kërkon faljen e Tij dhe mbetet i vendosur për të mos bërë të njëjtin gjynah përsëri:

Ndërsa atij që pendohet pas të këqijave të tij dhe përmirësohet, Allahu ia pranon pendimin, sepse Ai është vërtet Falës dhe Mëshirëplotë. (Sure Ma'ide: 39)

Zoti posedon mëshirë të pafund. Në një ajet të Kuranit, ai ju jap lajmin e mirë robërve të Tij: "...Unë jam Pranuesi i pendimeve dhe Mëshirëploti." (Sure Bekare: 160). Secili individ e ka mundësinë për t'u penduar. Zoti madje pranoi pendimin e Hebrenjve, të cilët devijuan dhe adhuruan një idhull që ata e punuan prej ari, pasi që besuan në Të, dhe i fali ata:


Dhe, kur Musa i tha popullit të vet: "O populli im, ju vetëm vetes i bëtë keq, kur e adhuroat viçin si zot! Prandaj kthehuni të penduar te Krijuesi juaj dhe vritni njëri-tjetrin! Kjo është më mirë për ju në sy të Krijuesit tuaj. Ai jua fali gabimin, sepse Ai i pranon shumë pendimet dhe është Mëshirëploti". (Sure Bekare: 54)

Pas pendimit dhe të kërkuarit falje Zotit, një person

mundet po ashtu të bëhet i pavëmendshëm, duke bërë të njëjtin mëkat përsëri. Në të vërtetë, kjo gjë mund të përsëritet shumë herë. Mirëpo, nëse ai person pendohet një herë e mirë dhe është i vendosur të mos mëkatoj përsëri, ai mund të shpresoj për mëshirën e Zotit.

Sidoqoftë, sikurse është rasti me çdo çështje, faktor me rëndësi është sinqeriteti. Një vepër jo e sinqertë është e papranueshme në shikimin e Zotit. Nëse një person nuk është i vendosur për t'i dhënë fund bërjes së mëkateve dhe thotë: "Në fund do të pendohem," ai është haptazi i pasinqertë, gjë që ka gjasa t'i sjell pikëllim njeriut. Zoti paralajmëron ata të cilët arsyetojnë në këtë mënyrë si vijon:

Allahu është pranues i pendimit vetëm për ata që bëjnë ndonjë të keqe nga padituria dhe pendohen shpejt. Pra, këtyre Allahu ua pranon pendimin. Allahu është i Gjithëdijshëm dhe i Urtë. Nuk pranohet pendimi i atyre që vazhdimisht bëjnë të këqija e, kur u afrohet vdekja, atëherë thonë: "Unë tani me të vërtetë po pendohem". As për ata që vdesin duke qenë jobesimtarë. Për këta, Ne kemi përgatitur dënim të dhembshëm. (Sure Nisa: 17-18)



RELIGJIONI ËSHTË NË PAJTIM ME PRIRJEN NATYRORE TË NJERËZIMIT

Drejtohu me përkushtim në fenë e pastër monoteiste, natyrën fillestare, në të cilën Allahu i ka krijuar njerëzit... (Sure Rum: 30)

Padyshim, është Zoti i Cili e njih më së miri natyrën e njeriut, të cilin Ai Vet e ka krijuar. Duke qenë kështu, Ai është Ai i Cili më së miri i njih nevojat e njerëzve dhe mënyrën se si t'i plotësoj ato. Nga mënyra se si të mbaj mirëqenien fizike të njeriut, e deri tek mënyra se si të mbetet shpirtërisht i fortë apo se si të arrij një jetë të kënaqshme shoqërore, të gjitha janë mirë të njohura për Zotin. Për shembull, një qenie njerëzore, për nga natyra, e tërheqin të gjitha format e mëshirës, dashurisë dhe sjelljes së drejtë. Ai pret që ndaj tij të sillen me mëshirë dhe dhembshuri. Ai e urren dhe i shmanget padrejtësisë, imoralitetit dhe të gjitha formave të ligësisë. Ai ndjehet ashtu me Vullnetin e Zotit, pasi që Zoti ka rrënjësuar këto vlera si pjesë e natyrës njerëzore, ai e do të mirën dhe i shmanget të keqes.

Ekzistojnë disa vlera themelore në Kuran që Zoti e urdhëron njeriun t'i përvetësoj, të jetë i dhembshur, i mëshirshëm, i besueshëm, i ndershëm dhe i përlulur dhe t'i

shmanget tiranisë, padrejtësisë dhe të keqes. Me fjalë tjera, ajo që kërkohet nga feja e Islamit, të cilën Zoti ia ka shpallur njerëzimit dhe ndaj të cilës njeriu është i prirur në mënyrë të natyrshme, janë sikur dryni dhe çelësi që e hap atë, në harmoni të plotë me njëri tjetrin. Zoti na bën me dije për këtë të vërtetë në Kuran si vijon:

Drejtohu me përkushtim në fenë e pastër monoteiste, natyrën fillestare, në të cilën Allahu i ka krijuar njerëzit. S'ka ndryshim të krijimit të Allahut. Kjo është feja e drejtë, por shumica e njerëzve nuk e dinë. (Sure Rum: 30)

Nëse njerëzit nuk i respektojnë kufijtë e përcaktuar nga Zoti në Kuran, ata i bëjnë padrejtësi vet shpirttrave të tyre. Pasi që, duke mos qenë në gjendje të përvetësojnë vlerat që janë në pajtim me krijimin e tyre, ata përvetësojnë sjellje kundër vet natyrës së tyre; kjo jo vetëm se u shkakton shqetësim atyre vet, por i bën ata po ashtu të papërshtatshëm për shoqërinë. Siç shpallet këtu:

...Allahu nuk u bën njerëzve asnjë të keqe, por njerëzit i bëjnë keq vetvetes. (Sure Junus: 44)

Duhet të kemi parasysh se njeriu mund të jetoj vetëm sipas vlerave të lavdëruara nga feja e Islamit nëse e ndjen atë sinqerisht, me një dëshirë të sinqertë. Një fe e cila imponohet me forcë është si e papranueshme në sytë e Zotit, ashtu edhe shkak për shtimin e njerëzve të pasinqertë, të cilëve iu referohet si hipokritë në Kuran. Kjo shpie drejt formimit të një strukture të padëshiruar shoqërore.

Zoti urdhëron që njerëzit nuk duhet të detyrohen në emër të fesë:

S'ka detyrim në fe, sepse tashmë është dalluar e drejta nga e shtrembra! Ai që mohon idhujt (dhe gjithçka që adhurohet në vend të Allahut) dhe beson në Allahun, ka siguruar lidhjen më të fortë, e cila nuk këputet kurrë. Allahu dëgjon dhe di gjithçka. (Sure Bekare: 256)

Rrjedhimisht, feja e Islamit nuk ushtron trysni në njerëz në asnjë fushë; përkundrazi, ofron bazën mbi të cilën mund të themelohet liria e vërtetë e ndërgjegjes. Një person i cili përvetëson vlerat e Kuranit nuk mund të kufizohet në asnjë mënyrë. Pasi që ai jeton në pajtim me besimin e tij me vullnetin e tij dhe përmes përdorimit të gjykimit të tij, ai ndjehet gjithmonë i kënaqur dhe i qetë.

Ata të cilët, në anën tjetër nuk iu qëndrojnë besnik këtyre vlerave fetare, nuk mund të arrijnë kurrë lirinë të cilën e gëzojnë besimtarët, për arsye të normave dhe traditave të panumërta që mbisundojnë në shoqëri. Shoqëritë që dëshetojnë të jetojnë në pajtim me vlerat e Islamit i formulojnë vet vlerat dhe kriteret, duke përqafuar ndalesat dhe në këtë mënyrë, me veprimin e tyre, vetëm se e kufizojnë lirinë që ju është dhuruar nga Zoti. Duke qenë kështu, ata të cilët janë të larguar prej fesë mbeten të privuar nga liria shpirtërore, për arsye të rregullave të pavend dhe sanksioneve që shoqëria ju ka imponuar, si edhe shumë parimeve që ata vet pa nevojë i përvetësojnë.

Forca kryesore që e lidh njeriun, më e madhe se çdo ligj i shoqërisë, është degjenerimi i shpirtit të tij. Dëshirat e papërmbytura janë burim i shqetësimit të vazhdueshëm të tij. Ato ushqejnë tek ai ndjenjat e pasigurisë dhe frikës për të ardhmen. Për shkak të këtyre prirjeve negative brenda vetvetes, ai ngatërrohet në një luftë të vështirë me ndjenjat dhe dëshirat e ndryshme të tij. Shpirti i tij urdhëron me këmbëngulje atë që të grumbulloj më shumë pasuri, të fitoj më shumë para apo të fitoj admirimin e të tjerëve. Mirëpo, këto janë dëshira të pangopura. Etja për pasuri është një pasion i rrënjosur thellë, i përbashkët për shumë njerëz. Megjithatë, përbushja e kësaj dëshire vetëm se nxit dëshira të mëtejme të rrejshme. Në thelb, dëshirat e dynjasë gjithnjë prirën të bëhen pjesë e një rrethi vicioz.

Ndërsa ata që banojnë në Medinë dhe që e kanë pranuar besimin qysh më parë, i duan mërgimtarët që vijnë në Medinë dhe në zemrat e tyre nuk ndejnë kurrfarë rëndimi, për atë, që u është dhënë atyre, por duan t'u bëjnë më mirë mërgimtarëve sesa vetes, edhe pse vetë janë nevojtare. Kushdo që ruhet nga lakmia e vetvetes, me siguri që do të jetë fitues. (Sure Hashr: 9)

Njeriu e arrin lirinë vetëm kur të pushojë së qeni rob i pasioneve të tij. Që nga ky moment e tutje, kënaqja e dëshirave të pafund të përmendura më lart më në fund ndalon të jetë qëllimi i tij në jetë. Ai fillon një jetë në të cilën fitimi i kënaqësisë së Zotit bëhet qëllimi i tij i vetëm, qëllim për të cilin Zoti e krijoi atë.

Kjo është liria e vërtetë; të qenit rob i Zotit dhe në këtë mënyrë duke e liruar vetveten nga çdo gjë tjetër pos Zotit. Kjo është arsyeja pse gruaja e Imranit u lut në këtë mënyrë:

“Zoti im, unë Ty ta kam kushtuar atë që është në barkun tim, që të shërbejë vetëm Ty; andaj, pranoje prej meje! Se Ti, me të vërtetë, dëgjon dhe di çdo gjë.”
(Sure Ali Imran: 35)

Për të njëjtën arsye, Ibrahim i tha babait të tij:

“O babai im, përse adhuron atë që as nuk dëgjon, as nuk sheh e as që mund të të sjellë ndonjë dobi? (Sure Merjem: 42)

Gjatë historisë, të dërguarit të cilët Zoti ia dërgoi njerëzimit i thirrën ata të shpëtojnë vetveten nga degjenerimi i shpirtrave të tyre apo të bërit rob qenieve njerëzore, për t’i shërbyer vetëm Zotit. Vetëm kur të shpëtojnë vetveten nga një çoroditje e tillë, e cila është në kundërshtim me qëllimin e krijimit të tyre, ata mund të gjejnë prehje. Pikërisht për këtë arsye i dërguari i Zotit (savs) është përshkruar në Kuran si një person i cili: “i liron njerëzit nga barrët e tyre të rënda dhe prej zinxhirëve që i kishin rrethuar ata”:

...dhe atyre që ndjekin të Dërguarin Tonë, Profetin që nuk di shkrim e lexim, të cilin ata do ta gjejnë të shënuar në shkrimet e tyre, në Teurat dhe Ungjill. Ai do t’i urdhërojë ata të bëjnë vepra të mira dhe do t’i ndalojë nga të këqijat; do t’ua lejojë të mirat e do t’ua ndalojë të këqijat, duke i liruar nga barrët e rënda dhe vështirësitë që kanë pasur. Prandaj, ata që do ta beso-

jnë, përkrahin dhe nderojnë atë, duke ndjekur dritën që është zbritur me të, pikërisht ata janë të fituarit.” (Sure A’raf: 157)

Një faktor tjetër në pajtimin e Islamit me natyrën njerëzore është thjeshtësia e tij. Zoti e ka bërë fenë, të cilën Ai e ka shpallur si një fe në përputhje me krijimin e qenies njerëzore, të lehtë për tu zbatuar. Ky fakt theksohet në shumë ajete:

Allahu dëshiron që t’jua lehtësojë (barrët), pasi njeriu është krijuar si një qenie e pafuqishme. (Sure Nisa: 28)

Allahu dëshiron që t’jua lehtësojë dhe jo që t’jua vështirësojë. (Sure Bekare: 185)

Sa për atë që beson dhe bën vepra të mira, atij i takon shpërblimi më i mirë dhe do t’i premtojmë atij lehtësira.” (Sure Kehf: 88)

Prej pikës së farës e krijon dhe i jep përmasa të rregullta. Më pas ia lehtëson rrugën (e lindjes) (Sure Abasa: 19-20)


Kjo thjeshtësi vlen gjithashtu edhe për aktet e adhurimit. Sa i përket rritit të agjërimit, një detyrë fetare që zbatohet gjatë muajit Ramazan, Zoti urdhëron si vijon:

Muaji i Ramazanit është ai, në të cilin ka zbritur Kurani, që është udhërrëfyes për njerëzit, plot me shenja të qarta për rrugën e drejtë dhe dallues (i së mirës nga e keqja). Pra, kushdo nga ju që dëshmon këtë muaj, le të agjërojë! Sa i përket atij që është i sëmurë ose gjendet në udhëtim e sipër (le të agjërojë

më vonë) aq ditë sa nuk i ka agjëruar. Allahu dëshiron që t'jua lehtësojë dhe jo që t'jua vështirësojë. Ai dëshiron që të plotësoni numrin e ditëve të agjërimit dhe që ta madhëroni Allahun (në fund të agjërimit), për shkak se ju ka drejtuar në rrugë të drejtë e që ta falënderoni Atë. (Sure Bekare: 185)

Si përfundim, Islami është një fe që është në përputhje të plotë me natyrën e njeriut. Pasi që Zoti i Cili është i kënaqur me Islamin si fe për njeriun, dhe është Ai i Cili e ka krijuar atë. Zoti nuk dëshiron vështirësi por lehtësi për robërit e Tij dhe ka përcaktuar si fe të tyre ato vlera të cilat më së miri përshtaten me nevojat, dëshirat dhe mënyrën e jetës së tyre. Në një ajet të Kuranit, Zoti ynë urdhëron si vijon:

...Sot, dëshpërohen ata që nuk besojnë dhe kanë humbur çdo shpresë, që t'ju largojnë prej fesë suaj. Mos u frikësoni prej tyre, por kini frikë prej Meje! Sot jua përsosa fenë tuaj, e plotësova dhuntinë Time ndaj jush dhe zgjodha që Islami të jetë feja juaj... (Sure Ma'ide: 3)



BESIMTARËT

**DUHET TË JENË
TË BASHKUAR DHE TË BASHKËPUNOJNË**

Të gjithë mbahuni fort për litarin e Allahut (Kuranin)

dhe mos u përçani! Kujtoni dhuntinë e Allahut për ju, sepse, kur ishit në armiqësi, Ai i pajtoi zemrat tuaja e, në saje të dhuntisë së Tij, u bëtë vëllezër. Dhe ju ishit buzë greminës së zjarrit, ndërsa Ai ju shpëtoi prej saj. Kështu, Allahu jua shpjegon shpalljet e Veta, që ju të drejtoheni në udhën e drejtë.(Sure Ali Imran: 103)

Njerëzit përgjithësisht kanë prirje të krijojnë miqësi me të tjerët të cilët posedojnë cilësi të ngjashme të karakterit. Ata parapëlqejnë njerëzit të cilët ndajnë botëkuptim të njëjtë mbi jetën, ju gëzohen gjërave të njëjta dhe me të cilët mund të shkojnë mirë. Si rrjedhojë, ata të cilët ndajnë pikëpamje të njëjta në mënyrë të pashmangshme ndërtojnë një lidhje të fortë mes tyre. Njerëzit e ndershëm dhe të sinqertë joshin njerëz të ndershëm dhe të sinqertë siç janë ata; ata nuk krijojnë miqësi me njerëz të lig. Njerëzit të cilët janë të pandershëm dhe që janë të prirur për ligësi, në anën tjetër, janë të prirur të shoqërohen me të tjerët të cilët janë të pandershëm.

Besimtarët, të cilët janë grupi i vetëm, mes gjithë të tjerëve, me karakterin e të cilëve Zoti është i kënaqur, duhet, në pajtim me urdhrin e Zotit dhe në pajtueshmëri me prirjen e tyre natyrore, të qëndrojnë gjithmonë të bashkuar.

Vërtet, ky është një akt adhurimi i urdhëruar nga Zoti në Kuran. Zoti i urdhëron besimtarët të qëndrojnë të bashkuar me besimtarët tjerë dhe të mos iu binden atyre të cilët janë mosrespektues:

Dhe qëndro me ata që i luten Zotit të vet në mëngjes dhe

mbrëmje, duke dëshiruar Fytyrën (kënaqësinë) e Tij dhe mos i shmang sytë nga ata (tek të tjerët), duke dëshiruar stolitë e shkëlqimin e kësaj jete. Mos dëgjo atë zemrën e të cilit ia kemi lënë mospërfillëse ndaj përmendjes Sonë e, që shkon pas dëshirave të veta, duke shkelur çdo kufi në veprimet e veta.(Sure Kehf: 28)

Besimtarët janë grupi i vetëm i njerëzve në tokë që kërkojnë kënaqësinë e Zotit. Ata përvetësojnë vetëm tiparet e karakterit me të cilat është i kënaqur Zoti. Mirëpo, këto vetvetiu nuk mjaftojnë; është e domosdoshme që të ekzistoj një mjedis ku këto vlera të mund të praktikohen dhe njerëzit të cilët ato të mund të ushtrohen. Zoti kërkon prej nesh që të jemi të drejtë, të sillemi me dhembshuri dhe zemërgjerësi, të urdhërojmë atë që është e drejtë dhe të përvetësojmë vlerat e lavdëruara në Kuran. Mirëpo, njeriu nuk mund t'ju qëndroj besnik këtyre vlerave pa ekzistencën e njerëzve tjerë. Me fjalë tjera, për të qenë një person i mëshirshëm dhe vet-flijues, njeriu duhet të jetë pranë njerëzve të cilët dinë të vlerësojnë përsosmërinë e karakterit, si edhe të meritojnë një kujdes të tillë. Këta njerëz janë besimtarët.

Asnjë besimtar i sinqertë nuk dëshiron të shoqërohet me dikën i cili nuk sillet ashtu si urdhëron Zoti, i cili nuk ka përvetësuar vlerat e Kuranit, dhe si rrjedhojë, i cili dëshiron të jetë pranë njerëzve tjerë të pamend siç është ai vet. Veç kësaj, ai nuk ushqen dashuri ndaj njerëzve të cilët nuk respektojnë besimet, të cilët e dënojnë atë për shkak të bes-

imit të tij në Zotin dhe të jetuarit e jetës sipas vlerave të fesë dhe që dëshiron që ta largojë atë nga shoqëria dhe të sillet me të në mënyrë armiqësore:


O besimtarë, mos i bëni miq armiqtë e Mi dhe tuajt, duke u shprehur atyre dashuri, ndërkohë që ata kanë mohuar të vërtetën, që ju ka ardhur dhe kanë dëbuar të Dërguarin dhe ju, vetëm se besonit në Allahun, Zotin tuaj. Nëse keni dalë luftëtarë në rrugën Time dhe për kënaqësinë Time dhe fshehurazi u shfaqni atyre dashuri, atëherë gaboheni. Unë e di çfarë fshihni dhe çfarë bëni haptazi. Secili prej jush që vepron ashtu, është shmangur nga rruga e drejtë. (Sure Mumtehine: 1-2)

Zoti na bën me dije se nuk është e drejtë të ushqehet dashuri ndaj njerëzve të tillë dhe as që të shoqërohemi me ta dhe shton se besimtarët duhet gjithmonë të qëndrojnë me besimtarët tjerë:

O besimtarë! Frikësojuni Allahut dhe bëhuni me ata që janë të sinqertë (në fjalë dhe në vepra)! (Sure Teube: 119)

Natyrisht, një besimtar duhet t'ju afrohet të gjithëve, përfshirë jobesimtarët, në një mënyrë miqësore dhe tolerante dhe të sillet me ta me drejtësi. Mirëpo, sjellja me tolerancë dhe drejtësi ndaj jobesimtarëve është shumë e ndryshme nga përvetësimi i vërtetë i tyre si shokë të afërm. Një besimtar i zgjedh vetëm ata të cilët janë besimtarë sikur ai për shokë të tij. Ky është urdhri i Zotit:

Miqtë dhe mbrojtësit tuaj janë vetëm Allahu, i Dërguari i Tij dhe besimtarët që falin namazin dhe japin zekatin, duke qenë të përlulur (në adhurim) ndaj Allahut. (Sure Ma'ide: 55)



FJALA E FUNDIT

Faktet e përshkruara në këtë libër janë ato që janë më të rëndësishmet në lidhje me këtë jetë. Pasi që njeriu është një genie e cila u krijua nga Zoti dhe në fund tek Ai do të kthehet, asgjë nuk mund të jetë më e rëndësishme se sa njohja e Zotit dhe si t'i shërbehet Atij.

Prandaj, ju duhet t'i kushtoni vëmendjen e duhur këtyre fakteve dhe të rishikoni qëllimet e tuaja në jetë dhe, po të jetë nevoja, t'i riorientoni veprimet tuaja dhe drejtimin e jetëve tuaja në dritën e fakteve vijuese.

A e njihni Zotin, Krijuesin tuaj?

A e falënderoni Atë?

A jeni të vetëdijshëm për Librin që Ai ju ka zbritur si udhërrëfyes për në rrugën e drejtë?

Apo, çfarë jeni duke bërë për të jetuar në pajtim me këtë Libër?

Ne ju sigurojmë se këto janë çështjet më të rëndësishme që kanë të bëjnë me jetën tuaj. Çdo gjë tjetër do të kalojë apo do të vdes, por Zoti do të mbetet përjetësisht. Gjithashtu edhe premtimi i Zotit, domethënë, Dita e Gjykimit dhe ahireti, do të ekzistojnë. Ju do të vdisni një ditë, dhe pastaj

prapë do të ringjalleni, dhe do të thirreni tek Zoti për të dhënë llogari për veprat tuaja.

Mos harroni se të dyja, si një jetë e lumtur në këtë botë dhe një jetë e hareshme në ahiret, varen nga shërbimi juaj i Zotit. Kjo është arsyeja pse Zoti ju krijoi. Nënshtroni qëllimit të krijimit tuaj, adhuroni Atë dhe drejtojuni Atij.

Ai është Zoti i qiejve, i Tokës dhe i gjithçkaje që është midis tyre, prandaj, vetëm Atë adhuroje dhe bëhu i qëndrueshëm në adhurimin ndaj Atij. A njeh ti ndokënd që ka Emrin e Tij?! (Sure Merjem: 65)

Mashtrimi i evolucionit

Darvinizmi, me fjalë të tjera teoria e evolucionit, u prezantua me qëllim të mohimit të faktit të Krijimit, por që në të vërtetë nuk është asgjë përveç një marrëzi e dështuar joshkencore. Kjo teori, e cila pretendon se jeta lindi rastësisht nga materia e pajetë, u zhvlerësua nga faktet shkencore të rregullit të mrekullueshëm në gjithësi dhe në gjallesa, si edhe me anë të zbulimit të rreth 300 milion fosileve që zbulojnë se evolucionit nuk ka ndodhur kurrë. Në këtë mënyrë, shkencë vërtetoi faktin se All-llahu krijoi gjithësinë dhe gjallesat në të. Propaganda që zhvillohet sot për të mbajtur në jetë teorinë e evolucionit mbështetet kryekëput në shtrembërimin e fakteve shkencore, interpretimin e paragjykuar dhe gënjeshttrat dhe pavërtetësitë e maskuara si shkencë.

Mirëpo kjo propagandë nuk mund ta fsheh të vërtetën. Fakti se **teoria e evolucionit është mashtrimi më i madh në historinë e shkencës** ka ardhur në shprehje shumë e më shumë në botën shkencore gjatë 20-30 viteve të fundit. Hulumtimet e bëra pas viteve të 80-ta në veçanti kanë zbuluar se pohimet e Darvinizmit janë krejtësisht të pabaza, gjë që është thënë nga një numër i madh i shkencëtarëve. Në Shtetet e Bashkuara të Amerikës në veçanti, shumë shkencëtarë prej fushave të ndryshme si biologjia, biokimia dhe paleontologjia pranojnë

gjymtinë e Darwinizmit dhe e përdorin faktin e krijimit për ta shpjeguar zanafillën e jetës.

Ne kemi ekzaminuar rënien e teorisë së evolucionit dhe provat e krijimit në mënyrë shumë të hollësishme shkencore në shumë prej punimeve tona dhe vazhdojmë ta bëjmë këtë. Duke pasur parasysh rëndësinë e madhe të kësaj çështjeje, do të jetë shumë e dobishme që ta bëjmë një përmbledhje të saj këtu.

Dwshtimi shkencor i Darwinizmit

Teoria e evolucionit, si **një doktrinë pagane** që i ka fillimet në Greqinë e lashtë, u përqaftua gjerësisht në shekullin e nëntëmbëdhjetë. Zhvillimi më i rëndësishëm që e bëri teorinë temën kryesore të botës së shkencës ishte botimi në vitin 1859 i librit *Origjina e Llojeve të Çarls Darwinit*. Në këtë libër, ai doli me pretendimin se llojet e ndryshme në tokë nuk janë krijuar veç e veç, por rrjedhin nga një stërgjysh i përbashkët dhe kanë ndryshuar nga njëra-tjetra nëpërmjet ndryshimeve të vogla me kalimin e kohës. **Teoria e Darvinit nuk mbështetet në asnjë zbulim shkencor konkret, siç e pranoi edhe ai vet, ajo ishte vetëm një "supozim".** Veç kësaj, ashtu siç e pranoi Darvini në kapitullin e gjatë të librit të tij të titulluar *"Vështirësitë e Teorisë"*, teoria dështoi përballë një sërë çështjesh vendimtare.

Darvini mbështeti të gjitha shpresat e tij në zbulimet e reja shkencore, të cilat shpresonte që do të zgjidhnin këto

vështirësi. Mirëpo, në kundërshtim me atë që ai shpresonte, zbulimet shkencore zgjeruan përmasat e këtyre vështirësive. Disfata e darvinizmit përballë shkencës mund të përmblihdhet në tre tituj kryesorë:

- 1) Teoria nuk arrin të shpjegoj se si ka zënë fill jeta në tokë.
- 2) Nuk gjendet asnjë zbulim shkencor që tregon se “mekanizmat e evolucionit” të propozuara nga kjo teori, posedojnë asnjë force evoluese.
- 3) Të dhënat fosile provojnë pikërisht të kundërtën e ideve të parashtruara nga kjo teori.

Në këtë pjesë, do të shtjellojmë në vija të përgjithshme këto tri çështje themelore:

Pengesa e parë e pakapërcyeshme: Zanafilla e jetës

Teoria e evolucionit pretendon se të gjitha speciet rrjedhin nga një qelizë e vetme e shfaqur në Tokën primitive 3.8 miliardë vjet më parë. Si është e mundur që një qelizë e vetme të ndërtojë miliona specie të gjalla e të komplikuar dhe, nëse me të vërtetë ka ndodhur diçka e tillë, përse nuk gjendet asnjë gjurmë në të dhënat fosile janë disa nga pyetjet në të cilat teoria nuk është në gjendje të jap përgjigje. Por në fillim, duhet të pyetemi: **Si u krijua kjo “qelizë e parë”?**

Meqë teoria e evolucionit e mohon krijimin dhe çfarëdo ndërhyrje të mbinatyrshme, ajo supozon se “qeliza e parë” është shfaqur rastësisht pa asnjë projektim, planifikim apo

rregullim, përbrenda ligjeve të natyrës. Sipas kësaj teorie, materia e pajetë duhet të ketë krijuar rastësisht qelizën e gjallë. Por kjo hipotezë bie ndesh me ligjet më të pakundërshtueshme të biologjisë.

"Jeta rrjedh nga jeta"

Darvini, në librin e tij, nuk ka folur kurrë mbi zanafillën e jetës. Koncepti primitiv shkencor në periudhën kur jetoi ai supozonte se gjallesat zotërojnë një konstrukt shumë të thjeshtë. Sipas teorisë së krijimit të rastësishme që besohet në mesjetë, lëndët e pajetë/inorganike, duke u bashkuar, mund të formojnë një qenie të gjallë. Në atë periudhë ishte shumë i përhapur mendimi se insektet formoheshin nga tepricat e ushqimeve, ndërsa minjtë nga gruri. Për të provuar diçka të tillë janë bërë eksperimente nga më të çuditshmet: Një leckë e ndotur me pak grurë mbi të, në një anë, ndërsa në anën tjetër një shkencëtar, duke pritur që pas një kohe të formoheshin minj.

Gjithashtu mendohej se shfaqja e krimbave në një copë mishi ishte dëshmi e krijimit të vetvetishëm/spontan. **Por më vonë do të kuptohej se ata krimba nuk formoheshin vetvetiu në mish, por nga larvat e padukshme për syrin që silleshin nga mizat.**

Madje edhe kur Darvini shkroi librin Origjina e Llojeve, besimi se bakteret formoheshin nga materia e pajetë ishte një

gjë e pranuar gjerësisht në botën e shkencës.

Por vetëm 5 vite pas botimit të librit të Darvinit, Lui Paster shpalli përfundimet e arritura pas shumë studimeve dhe eksperimenteve të gjata që rrëzuan plotësisht krijimin spontan, i cili përbënte gur-themelin e teorisë së Darvinit. Në ligjëratën e tij triumfale në Sorbonë në vitin 1864, Pasteri tha: “Kurrë më nuk do të rimarr veten krijimi spontan prej grushtit vdekjeprurës të dhënë nga ky eksperiment i thjeshtë.”¹

Mbrojtësit e teorisë së evolucionit i kundërshtuan për një kohë të gjatë zbulimet e Pasterit. Mirëpo shkenca, e cila po përparonte duke nxjerrë në dritë ndërtimin kompleks të qelizës së organizmit të gjallë, e përforcoi edhe më tepër pavlefshmërinë e pretendimeve mbi krijimin e rastësishëm të jetës.

Përpjekjet e pafrytshme të shekullit njëzet

Evolucionisti i parë, i cili u mor me çështjen e zanafillës së jetës në shekullin e njëzet ishte biologu i njohur rus Aleksandër Oparin, i cili u mundua të provonte, me anë të një sërë tezash të hedhura nga vetë ai në vitet 1930, se qeliza e gjallë mund të krijohet rastësisht. Por këto punime do të dilnin të pasuksesshme dhe Oparin do të detyrohej ta bënte këtë rrëfim:

Mirëpo, fatkeqësisht, çështja e zanafillës së qelizës përbën ndoshta pikën më të errët të gjithë studimit të evolucionit të organizmave.²

Pasuesit evolucionist të Oparinit u munduan të bënin eksperimente për të gjetur një zgjidhje për këtë çështje. Më i njohuri nga këto eksperimente ishte ai që u ndërmor në vitin 1953 nga kimisti amerikan Stenli Miler, i cili, duke bashkuar gazrat, që ai pretendonte se kishin ekzistuar në atmosferën primitive në një ambient eksperimental dhe duke i ekspozuar ato ndaj një burimi të jashtëm energjie, Milleri formoi disa molekula organike (aminoacide) të pranishme në strukturën e proteinave.

Mezi kishin kaluar disa vite para se të zbulohesh se ky eksperiment, i cili atëherë u paraqit si një hap i rëndësishëm në emër të evolucionit, ishte i pavlefshëm, sepse atmosfera e përdorur në këtë eksperiment ishte shumë më e ndryshme nga kushtet reale të Tokës.³

Pas një periudhe të gjatë heshtjeje, Milleri pranoi se atmosfera e përdorur nga ai nuk ishte reale.⁴

Të gjitha përpjekjet evolucioniste që u ndërmorën gjatë shekullit të njëzet për të shpjeguar zanafillën e jetës përfunduan pa sukses. Xhefri Bada, gjeo-kimisti i njohur nga Instituti Skrips i San Diegos, në një artikull të botuar në vitin 1998 në revistën "Earth", pranon këtë fakt:

*Sot, duke e lënë pas shekullin e njëzet, akoma përballemi me problemin më të madh të pazgjidhur që kishim kur hymë në shekullin e njëzet: Si zuri fill jeta në tokë?*⁵

Ndërtimi i ndërlikuar i jetës

Shkaku kryesor që çëshkja mbi zanafillën e jetës ka hyrë në një dilemë të tillë është se madje ata organizma të gjallë që mendohej të jenë më të thjeshtat kanë ndërtim jashtëzakonisht të ndërlikuar. Qeliza e një gjallesë është shumë më e ndërlikuar se të gjitha produktet teknologjike që ka arritur të prodhojë njeriu. **Sot, madje edhe në laboratorët më të përparuara të botës, duke bashkuar materie kimike organike, nuk do të mund të arrijmë kurrë të përfitojmë një qelizë të vetme.**

Kushtet që nevojiten për formimin e një qelize janë aq të shumta sa kurrë nuk mund të shpjegohen me rastësi. Probabiliteti që proteinat, njësia bazë e qelizës, të sintetizohen rastësisht është 1 në 10950 (për një proteinë mesatare me 500 aminoacide). Në matematikë probabilitetet më të vogla se 1050 konsiderohen të pamundura.

Molekula e ADN-së përmban informacionet gjenetike si një bankë informacionesh me kapacitet të pabesueshëm. Nëse do ta hidhnim në letër informacionin që përfshin ADN-ja e njeriut, do të krijohej një bibliotekë me 900 volume enciklopedike me nga 500 faqe secili.

Në këtë pikë shfaqet një dilemë shumë interesante: ADN-ja mund ta kopjoj/përsëris vetveten vetëm me ndihmën e disa proteinave të specializuara (enzimave). Mirëpo, sinteza e këtyre enzimave mund të realizohet vetëm me anë të informacionit të koduar në ADN. Pasi që ato të dyja janë të varura nga njëra tjetra, ato duhet të ekzistojnë në të njëjtën kohë për kopjim/përsëritje. Kjo e sjellë skenarin se jeta ka zënë fill vetvetiu në një rrugë pa krye. Prof. Lesli Orgel, një evolucionist

me reputacion nga Universiteti i San Diegos në Kaliforni, e pranon këtë fakt në botimin e revistës Scientific American të Shtatorit të vitit 1994:

Është krejtësisht e pamundshme që proteinat dhe acidet nukleike, duke qenë të dyja komplekse për nga ndërtimi, të jenë krijuar vetvetiu në të njëjtin vend dhe në të njëjtën kohë. Po ashtu duket e pamundshme ta kemi njëren pa tjetrën. Dhe kështu, në shikim të parë, njeriut do t'i duhej të vjen në përfundimin se, në të vërtetë, jeta kurrë nuk ka mundur të zë fill me anë të mjeteve kimike.⁶

Padyshim, nëse është e pamundur që jeta të ketë zënë fill nga shkaqet natyrore, atëherë duhet të pranohet se jeta u "krijua" në mënyrë të mbinatyrshe. Ky fakt zhvlerëson në mënyrë të qartë teorinë e evolucionit, qëllimi kryesor i së cilës është të mohoj krijimin.

Mekanizmat imagjinarë të evolucionit

Cështja e dytë e rëndësishme që e bën teorinë e Darvinit të pavlefshme është se të dy konceptet e paraqitura nga kjo teori si "mekanizma të evolucionit", u kuptua se në të vërtetë nuk zotërojnë asnjë forcë evoluese.

Darvini e mbështeti hipotezën e tij në tërësi në mekanizmin e "seleksionimit natyror." Rëndësia që i jepte këtij mekanizmi mund të kuptohet fare lehtë edhe nga titulli i librit të tij: Origjina e Llojeve nëpërmjet seleksionimit natyror"...

Seleksionimi natyror pohon se ato gjallesa që janë më të

fuqishme dhe që i përshtaten më mirë kushteve natyrore të vendbanimeve të tyre do të mbijetojnë në luftën për jetë. P.sh., në një kope sorkadhesh që kërcënohet prej kafshëve të ndryshme grabitqare, do të mbijetojnë vetëm ato sorkadhe që vrapojnë më shpejt. Kështu që kopeja e sorkadheve do të përbëhet nga individët më të fortë dhe më të shpejtë. Mirëpo, sigurisht që ky mekanizëm nuk mund të shkaktojë evoluimin e sorkadheve e t'i kthejë në një lloj tjetër gjallese, për shembull, në kuaj.

Për këtë arsye, **mekanizmi i seleksionimit natyror nuk zotëron asnjë forcë evoluese. Edhe Darvini ishte i ndërgjegjshëm për këtë realitet**, ndaj në librin e tij *Origjina e Llojeve* u detyrua të pohonte:

Seleksionimi natyror s'mund të bëjë asgjë përderisa nuk shfaqen dallime dhe ndryshime të dobishme individuale.⁷

Ndikimi i Lamarkut

Si mund të formoheshin këto ndryshime të dobishme? Darvini, kësaj pyetjeje u mundua t'i përgjigjej nga këndvështrimi i të kuptuarit primitiv të shkencës së asaj kohe. Sipas biologut francez Shevalie Lamark (1774-1829), i cili ka jetuar para Darvinit, gjallesat ia përcollën brezit pasardhës të gjitha ndryshimet fizike, të cilat kishin fituar gjatë jetës së tyre. Ai pohonte se këto cilësi, të cilat u akumuluan nga një brez në tjetrin, bënë që të formohen specie të reja. Për shembull, ai pohonte se gjirafat evoluuan nga antilopat gjatë përpjekjeve të

tyre për të arritur gjethet e pemëve të larta, qafat e tyre u zgjatën nga njëri brez në tjetrin

Edhe Darvini ka dhënë shembuj të ngjashëm. Në librin e tij Origjina e Llojeve, për shembull, ai thotë se disa arinj për të gjetur ushqim në thellësi të detit me kohë u shndërruan në bale-na.⁸

Por zbulimet e Gregor Mendelit (1822-1884) të ligjeve të trashëgimisë, të cilat u saktësuan nga shkencat e gjenetikës, e cila lulëzoi në shekullin e njëzet, hedhën poshtë plotësisht legjendën e përcjelljes së karakteristikave të fituara në brezat pasardhës. Kështu, u vërtetua përfundimisht se seleksionimi natyror ishte një mekanizëm joefektiv.

Neo-darvinizmi dhe mutacionet

Për të gjetur një zgjidhje, darvinistët nxorën në dritë “Teorinë Sintetike Moderne”, apo siç njihet ndryshe Neo-Darvinizmin, në fund të viteve 1930. Neo-Darvinizmi shtoi mutacionet, të cilat janë shtrembërime të formuara në gjenet e gjallesave për shkak të faktorëve të tillë të jashtëm si rrezatimi apo gabimet në përsëritje, si “shkaqe të ndryshimeve të dobishme” përveç mutacionit natyror.

Modeli, i cili edhe sot e ruan vlerën në emër të evolucionit, është Neo-Darvinizmi. Sipas kësaj teorie miliona gjallesa në botë u formuan si rezultat i një procesi me anën e të cilit organe të shumta komplekse të këtyre organizmave (p.sh., veshët, mushkëritë dhe krahët) iu nënshtruan “mutacioneve,”

domethënë çrregullimeve gjenetike. Por ekziston një fakt i prerë shkencor që plotësisht e hedh poshtë këtë teori: Mutacionet nuk i zhvillojnë gjallesat, përkundrazi, ato janë gjithmonë të dëmshme.

Arsyeja për këtë është shumë e thjeshtë: **ADN-ja zotëron një ndërtim shumë të ndërlikuar dhe çdo ndikim spontan mbi këtë molekulë, mund vetëm t'i shkaktojë dëm asaj.** Gjeneticisti amerikan B. G. Ranganathan e shpjegon këtë fakt si në vazhdim:

Së pari, mutacionet e vërteta janë shumë të rralla në natyrë. Së dyti, shumica e mutacioneve janë të dëmshme pasi që janë të rastësishme, më parë se ndryshime të rregullta në strukturën e gjeneve; çfarëdo ndryshimi i rastësishëm në një sistem tejet të rregullt do të ndikojë për të keq, jo për të mirë. Për shembull, nëse një tërmet do të dridhte një ndërtim tejet të rregullt siç është një ndërtesë, do të ndodhte një ndryshim i rastësishëm në kornizën e ndërtesës, i cili sipas të gjitha gjasave, nuk do të ishte një përmirësim.⁹

Nuk çudit fakti se deri më sot nuk është vëzhguar asnjë rast i ndonjë mutacioni të dobishëm, domethënë, i cili është parë të zhvilloj kodin gjenetik. Është vërtetuar se të gjitha mutacionet janë të dëmshme. Është kuptuar se mutacioni, i cili është paraqitur si një “mekanizëm i evolucionit,” është në të vërtetë një dukuri gjenetike që dëmton gjallesat dhe i lë të gjymtuara. (Efekti më i zakonshëm i mutacionit në qeniet njerëzore është kanceri.) Natyrisht, një mekanizëm shkatërrues nuk mund të jetë “mekanizëm evolutiv.” Seleksionimi natyror, në anën tjetër, “s’ mund të bëj asgjë i vetëm,” siç e pranoi edhe Darvini.

Ky fakt na tregon se **nuk ekziston ndonjë “mekanizëm evolutiv” në natyrë**. Pasi që nuk ekziston asnjë mekanizëm evolutiv, asnjë proces i tillë i imagjinuar i quajtur “evolucion” nuk ka mundur të ndodhë.

Të dhënat fosile: asnjë gjurmë e formave kalimtare

Të dhënat fosile janë treguesi më i qartë se skenari që sugjerohet nga teoria evolucionit nuk ka ndodhur kurrë.

Sipas kësaj teorie, të gjitha gjallesat kanë evoluar nga një paraardhës. Një specie, e cila ekzistonte më parë, me kalimin e kohës, u shndërrua në diçka tjetër dhe të gjitha speciet u krijuan në këtë mënyrë. Me fjalë të tjera, ky transformim u zhvillua gradualisht gjatë një periudhe të gjatë prej qindra miliona vjetësh.

Po të kishte qenë kështu, lloje të shumta kalimtare duhej të kishin ekzistuar dhe jetuar brenda kësaj periudhe të gjatë transformimi.

Për shembull, disa krijesa gjysmë peshk–gjysmë zvarranik duhej të kishin jetuar në të kaluarën të cilat kishin fituar disa tipare zvarranikësh, përveç tipareve të peshkut të cilat ato tashmë i kishin. Apo duhej të kishin ekzistuar disa zvarranik-zogj, të cilët fituan disa tipare të zogjve përveç tipareve të zvarranikëve që ato tashmë i kishin. Meqë këto gjallesa do të duhej të kishin ekzistuar në një periudhë kalimtare, gjallesat duhet të kenë qenë të gjymtuara dhe me një sërë të metash. Evolucionistët, këto qenie imagjinare që besojnë të kenë jetuar

në të kaluarën, i quajmë “forma kalimtare”.

Nëse me të vërtetë do të kishin ekzistuar gjallesa të tilla në të kaluarën, atëherë do të duhej të kishte me miliona dhe madje miliarda sosh për nga numri dhe llojllojshmëria. Ajo që është më me rëndësi, mbetjet e këtyre qenieve të çuditshme do të duhej të haseshin në të dhënat fosile. Darvini, në librin Origjina e Llojeve, këtë fakt e shpjegon kështu:

Nëse teoria ime është e vërtetë, atëherë forma kalimtare të panumërta që lidhin speciet e të njëjtit grup, duhet të kenë ekzistuar me siguri... Si rrjedhim, provat për ekzistencën e tyre të mëparshme do të mund të gjendeshin vetëm në mbetjet fosile.”¹⁰

Megjithatë, Darvini ishte më se i vetëdijshëm se ende nuk ishin gjetur fosile të këtyre formave të ndërmjetme. Ai e konsideronte këtë si pengesë madhore për këtë teori. Në një kapitull të librit të tij të titulluar “Vështirësitë e Teorisë,” ai shkroi:

Përse, nëse llojet kanë prejardhje nga llojet tjera përmes ndryshimeve delikate graduale, nuk shohim gjithandej forma të panumërta kalimtare? Përse nuk është e gjithë natyra në rrëmujë në vend se llojet të jenë, siç i shohim, të definuara mirë? ... Por, pasi që sipas kësaj teorie duhet të kenë ekzistuar forma të panumërta kalimtare, përse nuk i gjejmë ato të ngulitura në koren e tokës? ... Përse atëherë nuk është çdo formacion gjeologjik dhe çdo shtresë përplot me hallka të tilla kalimtare? Gjeologjia sigurisht nuk zbulon çfarëdo zinxhiri të tillë organik të shkallëzuar në mënyrë të përsosur; dhe kjo, mbase, është kundërshtimi më i dukshëm dhe më serioz që mund t'i bëhet teorisë sime.¹¹

Shpresat e venitura të Darvinit

Mirëpo, edhe pse janë bërë shumë kërkime intensive për të gjetur fosilet që nga mesi i shekullit të nëntëmbëdhjetë në mbarë botën, **ende nuk është gjetur asnjë formë kalimtare**. Të gjitha fosilet, në kundërshtim me atë që shpresonin evolucionistët, tregojnë se **jeta në Tokë u shfaq krejt papritur dhe plotësisht e formuar**.

Një paleontolog i njohur britanik, Derek V. Ager, edhe pse një evolucionist, e pranon këtë realitet:

*Problemi ynë është ky: Tek analizojmë me hollësi të dhënat fosile në nivelin e klasave apo llojeve, **hasim gjithmonë e më tepër jo evolucion gradual, por shpërthim të papritur të një lloji në llogari të një tjetri.***¹²

Me fjalë të tjera, **te fosilet e gjetura, të gjitha llojet e gjallesave shfaqen papritmas dhe në formën e tyre të përfunduar, pa asnjë formë të ndërmjetme në mes**. Kjo është pikërisht e kundërta e supozimeve të Darvinit. Për më tepër, kjo është një provë shumë e fortë **që të gjitha gjallesat janë krijuar**. I vetmi shpjegim që një specie e gjallë të shfaqet papritmas e plotë dhe pa paraardhës nga i cili të ketë evoluar është se ajo u krijua. Kjo e vërtetë është pranuar po ashtu nga biologu i mirënjohur evolucionist Douglas Futuyuma:

Krijimi dhe evolucioni, në mes tyre, shter shpjegimet e mundshme për zanafillën e gjallesave. Organizmat ose janë shfaqur në tokë të zhvilluara plotësisht, ose jo. Në rast se nuk

janë zhvilluar gradualisht, ato duhet të jenë zhvilluar nga specie që kanë ekzistuar më parë me anë të ndonjë procesi modifikimi. Në rast se janë shfaqur plotësisht të zhvilluara, ato me të vërtetë duhet të jenë krijuar nga ndonjë intelekt i plot-fuqishëm.¹³

Fosilet tregojnë se qeniet e gjalla u shfaqën në Tokë të formuara plotësisht dhe në gjendje të përkryer. Me fjalë të tjera “origjina e llojeve,” në kundërshtim me supozimin e Darvinit, nuk është evolucioni, por **Krijimi**.

Përralla e evolucionit të njeriut

Çështja që trajtohet më shpesh nga mbrojtësit e teorisë së evolucionit është prejardhja e njeriut. Mendimi darvinist mbi këtë çështje thotë se qeniet njerëzore moderne që jetojnë sot kanë evoluar nga disa krijesa të ngjashme me majmunët. Gjatë kësaj periudhe të supozuar, e cila mendohet të ketë filluar rreth 4-5 milionë vjet më parë, pretendohet se kanë jetuar “forma kalimtare” midis njeriut modern dhe të parëve të tij. Ka katër “kategori” bazë në gjithë këtë skenar të imagjinuar:

1. Australopiteku
2. Homo habilis
3. Homo erektus
4. Homo sapiens

Evolucionistët i japin emrin “Australopitek” (që do të thotë “majmuni i jugut”), të ashtuquajturit paraardhës të parë të njeriut të ngjashëm me majmunët. Këto qenie të gjalla nuk janë

në fakt asgjë tjetër, përveçse një specie e zhdukur majmuni. Kërkimet e shumta të Lordit Solli Cukerman dhe Profesorit Çarlls Oksnard, dy anatomistë me famë botërore nga Anglia dhe SHBA-ja, rreth mbetjeve të australopitekëve tregojnë se këto qenie i përkisnin një lloji të majmunit të zhdukur dhe se nuk kishin asnjë ngjashmëri me qeniet njerëzore. 14

Evolucionistët e quajnë fazën tjetër të evolucionit njerëzor “homo,” domethënë “njeri”. Sipas këtij pretendimi, qeniet e gjalla të serisë “homo” ishin më të zhvilluara se australopitekët. Evolucionistët i vendosën fosilet e këtyre krijesave të ndryshme pranë njëra-tjetrës me një renditje të caktuar dhe përpiluan një plan imagjinar evolucioni. Ky plan është imagjinar, sepse faktikisht asnjë lidhje evolucionare mes këtyre klasave të ndryshme nuk është provuar. Ernst Majër, njëri prej mbrojtësve më të rëndësishëm të teorisë së evolucionit në shekullin e njëzet në librin e tij Një argument i gjatë pohon se: “në veçanti (enigmat) historike si zanafilla e jetës apo e Homo sapiensit, janë tejet të vështira dhe mund madje t’i bëjnë ballë një shpjegimi përfundimtar të kënaqshëm.”¹⁵

Kur konturojnë zinxhirin Australopitek > Homo Habilis > Homo Erektus > Homo Sapiens, evolucionistët nënkuptojnë se këto specie kanë qenë paraardhëse të njëra-tjetrës. Mirëpo, zbulimet më të fundit të paleo-antropologëve tregojnë se Austrolopiteku, Homo Habilis dhe Homo Erektus kanë jetuar në të njëjtën periudhë në pjesë të ndryshme të botës.¹⁶

Për më tepër, një segment i caktuar njerëzish i klasifikuar si Homo Erektus ka jetuar deri në kohërat moderne. **Homo sapiens, Neandertalët dhe Homo Sapiens Sapiens (njeriu mod-**

ern) kanë bashkëjetuar në të njëjtin rajon.¹⁷

Kjo, sigurisht, provon përfundimisht se këto specie nuk ishin paraardhëse të njëra-tjetrës. Stefën Xhej Gould, njëri prej paleontologëve të universitetit të Harvardit, megjithëse është evolucionist, e shpjegon qorrrokakun në të cilin gjendet teoria darviniste në këtë mënyrë:

Çfarë i ndodhi shkallës sonë, nëse bashkekzistojnë tri linja hominide (A. Afrikanus, Robust Australopitekët robust (shtat-mëdhenj) dhe H. Habilis) që nuk rrjedhin nga njëra-tjetra? Për më tepër, asnjë nga të tre nuk shfaq ndonjë tendencë evolutive gjatë qëndrimit të tyre në tokë.¹⁸

Me pak fjalë, i gjithë skenari i evolucionit njerëzor që po mbahet gjallë me ndihmën e vizatimeve të ndryshme të krijesave imagjinare “gjysmë-majmun-gjysmë-njeri”, që shfaqen në media apo libra shkollorë, domethënë, sinqerisht, me anë të metodave propagandistike, s’janë gjë tjetër **veçse një mit pa asnjë bazë shkencore**.

Lordi Solli Cukerman, një nga shkencëtarët më të njohur dhe më të spikatur të Mbretërisë së Bashkuar, e ka studiuar këtë çështje për vite me radhë dhe ka kryer një punë kërkimore 15-vjeçare mbi fosilet e Australopitekut. Edhe pse evolucionist, ai arriti në përfundimin se, në të vërtetë, nuk ekziston asnjë pemë gjenealogjike midis majmunit dhe njeriut.

Cukerman gjithashtu bëri një “spektër interesant të shkencave”, duke i radhitur ato nga ato që ai i konsideronte si më shkencoret tek ato që i konsideronte si më joshkencoret. Sipas spektrit të Cukermanit, më “shkencoret,” duke marrë parasysh mbështetjen e tyre në argumente, janë shkenca e fizikës dhe

kimisë. Më pas vijnë shkencat biologjike dhe pastaj shkencat shoqërore. Në fund fare, në pjesën që konsiderohet të jetë si pjesa më “joshkencore”, radhitet “perceptimi jashtë-shqisor” – konceptet si telepatia dhe shqisa e gjashtë – dhe në fund të fundit u vendos “evolucioni i njeriut”. Cukerman shpjegon kështu arsyetimin e tij:

Më pas zhvendosim regjistrin e të vërtetës objektive në drejtim të atyre fushave të shkencës të konsideruara si shkenca biologjike, si p.sh. perceptimi jashtë-shqisor apo interpretimi i historisë së fosileve të njeriut, ku për (evolucionistin) besnik gjithçka është e mundur – dhe ku besimtari i zjarrtë (i evolucionit ndonjëherë është në gjendje të besojë shumë gjëra kontradiktore në të njëjtën kohë.¹⁹

Përralla e evolucionit njerëzor nuk është gjë tjetër veçse një përmbledhje e “disa interpretimeve të paragjykuara të fosileve të zhvarrosura prej njerëzve të caktuar, të cilët ndjekin verbërisht teorinë e tyre.

Formula e Darvinit!

Përveç të gjitha provave teknike me të cilat jemi marrë gjer më tani, le ta shtjellojmë njëherë, se çfarë paragjykimi kanë evolucionistët me një shembull të thjeshtë që të kuptohet madje edhe prej fëmijëve:

Teoria e evolucionit pohon se jeta u krijua rastësisht. Sipas këtij pohimi, atomet e pajetë dhe të pavetëdije u bashkuan për të for-

muar qelizën dhe pastaj ata disi formuan gjallesat tjera, duke përfshirë edhe njeriun. Le të mendojmë për këtë. Kur i bashkojmë elementet që janë bazë e ndërtimit jetës si karboni, fosfori, nitrogjeni dhe potasiumi, vetëm një grumbull formohet. Pa marrë parasysh se çfarë trajtimi i nënshtrohet, ky grumbull atomev nuk mund të formojë madje as edhe një gjallesë të vetme. Nëse dëshironi, le ta formulojmë një "eksperiment" në lidhje me këtë çështje dhe ta shtellojmë në emër të evolucionistëve atë që ata vërtet e pohojnë pa e shprehur zëshëm me emrin

"formula e Darvinit":

Le të vendosin materialistët plot materiale të pranishme në përbërjen e gjallesave si fosfori, nitrogjeni, karboni, oksigjeni, hekuri dhe magnezi në fuçi të mëdha. Veç kësaj, le të shtojnë në këto fuçi çfarëdo lloj materiali që nuk ekziston në kushte normale, por që ata mendojmë se është i domosdoshëm. Le të shtojnë në këtë përzierje aq sa të dëshirojnë amino acide – të cilat nuk kanë mundësi të formohen në kushte natyrore – dhe proteina – që një e vetme e ka probabilitetin e formimit 10 në 950 – sa të duan. Le t'ia ekspozojnë këto përzierje deri në masën që dëshirojnë nxehtësisë dhe lagështisë. Le t'i përziejnë këto me çfarëdo pajisje të përparuar teknologjike që të duan. Le t'i vënë shkencëtarët më të shquar pranë këtyre fuçive. Le të presin këta ekspert me radhë pranë këtyre fuçive për miliarda dhe trilionë vite. Le të lejohen të përdorin të gjitha llojet e kushteve që ata besojnë të jenë të domosdoshme për formimin e një njeriu. Pa marrë parasysh se çfarë bëjnë, ata nuk mund ta krijojnë një njeri prej këtyre fuçive, të themi një profesor që ekzaminon strukturën e qelizës së tij nën një mikroskop elek-

tronik. Ata nuk mund të krijojnë gjirafa, luanë, bletë, kanarina, kuaj, delfinë, trëndafila, orkide, zambakë, karafila, banane, portokaj, molla, hurma, domate, pjeptra, shalqi, fiq, ullinj, rrush, pjeshka, pallonj, fazanë, flutura shumëngjyrëshe apo me miliona gjallesa si këto. Me të vërtetë, ata nuk do të mund të përfitonin as edhe një qelizë të vetme prej cilësdo prej tyre.

Thënë shkurt, **atomet e pavetëdijshme nuk mund të formojnë qelizën** duke u bashkuar. Ato nuk mund të marrin një vendim të ri dhe ta ndajnë këtë qelizë më dysh dhe pastaj të marrin vendime tjera dhe të krijojnë profesorët të cilët së pari shpikin mikroskopin elektronik dhe pastaj ekzaminojnë strukturën e qelizës së vet nën atë mikroskop. **Materia është një grumbull i pavetëdijshëm, i pajetë dhe ajo vjen në jetë me krijimin e lartë të All-llahut.**

Teoria e evolucionit, e cila pohon të kundërtën e kësaj, është një gjykim plotësisht i gabuar i kundërt me arsyen. Të menduarit madje edhe vetëm për pak kohë për pohimet e evolucionistëve zbulon këtë të vërtetë, sikurse në shembullin më lartë.

Teknologjia e syrit dhe veshit

Një çështje tjetër që mbetet pa përgjigje nga teoria e evolucionit është cilësia e shkëlqyer e perceptimit të syrit dhe veshit.

Para se të kalojmë te syri, le t'i përgjigjemi shkurtimisht pyetjes "Si shohim ne?" Rrezet e dritës që vijnë nga një objekt, bien në retinën e syrit duke dhënë një imazh të përmbysur të

objektit. Këtu, këto rreze drite transformohen në sinjale elektrike nga qelizat dhe pastaj përcillen në një zonë të vogël në pjesën e prapme të trurit, ku ndodhet “qendra e shikimit”. Këto sinjale elektrike perceptohen në këtë qendër të trurit si imazh pas një sërë procesesh. Le të mendojmë pak, duke u bazuar në këto njohuri teknike.

Truri është i izoluar tërësisht nga drita. Kjo do të thotë se pjesa e brendshme e trurit është në errësirë të plotë dhe drita nuk arrin atje. Qendra e shikimit është një vend në errësirë të plotë ku nuk hyn kurrë dritë. Ka mundësi që të jetë vendi më i errët që ekziston. Megjithatë, ne shikojmë një botë të ndritshme plot dritë në këtë errësirë të plotë.

Imazhi i formuar në sy është kaq i mprehtë dhe i qartë, sa që as teknologjia e shekullit njëzet nuk ka arritur ta realizojë. Për shembull, shikoni librin që jeni duke e lexuar, duart me të cilat e mbani atë dhe pastaj ngrini kokën dhe shikoni përreth. A keni parë ndonjëherë një imazh të tillë të mprehtë e të qartë si ky në ndonjë vend tjetër? Edhe ekrani më i zhvilluar i televizorit i prodhuar nga prodhuesi më i fuqishëm i televizorëve në botë nuk mund të sigurojë një imazh aq të mprehtë për ju. Ky është një imazh tre-dimensional, me ngjyra dhe jashtëzakonisht i pastër.

Për vite të tëra, mijëra inxhinierë janë përpjekur të prodhojnë një televizor tre-dimensional, i cili mund të arrijë cilësinë e shikimit të syrit. Ata kanë arritur të shpikin një sistem TV tre-dimensional, por ai nuk mund të shihet pa vendosur një palë syze speciale 3-D. Për më tepër, bëhet fjalë vetëm për një tre-dimensional artificial. Sfondi është më i mjegulluar, ndërsa

plani i parë duket sikur është dekor prej letre. Asnjëherë s'ka qenë e mundur të arrihet një imazh me cilësinë e syrit. Edhe në kamera apo në televizor, ka një humbje të cilësisë së imazhit.

Evolucionistët pretendojnë se mekanizmi që prodhon këtë imazh të mprehtë e të qartë është formuar krejt rastësisht. Nëse dikush do t'ju thoshte se televizori në dhomën tuaj është formuar si rezultat i bashkimit të rastësishëm të miliona atomeve, çfarë do të mendonit ju? Si mund ta bëjnë atomet atë që mijëra njerëz s'e bëjnë dot?

Nëse një pajisje që prodhon një imazh më primitiv se **syri nuk mund të jetë formuar rastësisht**, atëherë është shumë e qartë që edhe syri apo imazhi që shikohet prej tij nuk mund të jenë krijuar rastësisht. E njëjta gjë vlen edhe për veshin. Veshi i jashtëm i kap tingujt dhe i drejton te veshi i mesëm, i cili ia përcjell veshit të brendshëm duke i përforcuar ato. Veshi i brendshëm ia dërgon valët zanore trurit, duke i kthyer në sinjale elektrike. Ashtu si me shikimin, procesi i dëgjimit përfundon në qendrën e dëgjimit në tru.

Ajo që thamë për syrin është e vërtetë edhe për veshin. Do të thotë, **truri është i izoluar nga tingujt**, ashtu si është i izoluar edhe nga drita: asnjë tingull nuk mund të depërtojë brenda. Prandaj, s'ka rëndësi sa zhurmë ka jashtë, brenda trurit mbi-zotëron një qetësi absolute. Megjithatë edhe tingujt më të mprehtë perceptohen nga truri. Në trurin tuaj, i cili është i izoluar nga tingujt, ju dëgjoni simfoninë e ekzekutuar nga një orkestër apo zhurmat në një vend të mbushur plot me njerëz. Megjithatë, nëse bëhet një matje ekzakte e nivelit të tingujve në trurin tonë në këto momente, do të kuptonim se një

qetësi absolute mbizotëron aty.

Ashtu si në rastin e imazhit, dekada të tëra përpjekjesh kanë kaluar për të krijuar dhe riprodhuar tinguj sa më të afërt me origjinalin. Rezultatet e këtyre përpjekjeve janë regjistruarit e zërit, sistemet HI-FI dhe sistemet e ndryshme për kapjen e tingujve. Pavarësisht nga teknologjia e përparuar dhe përpjekjet e mijëra inxhinierëve e ekspertëve, nuk është përfituar asnjë tingull që të ketë të njëjtën mprehtësi dhe qartësi si tingulli që kapet nga veshi. Mendoni për sistemet HI-FI të cilësisë më të lartë të prodhuar nga kompania më e madhe e industrisë së muzikës. Edhe në këto pajisje, kur regjistrohet zëri, humbet një pjesë e cilësisë. Kur ndizni një HI-FI gjithmonë dëgjoni një zhurmë të lehtë para se të fillojë muzika. Veshi i njeriut asnjëherë nuk e kap një tingull të shoqëruar me zhurmë; ai e kap tingullin pikërisht ashtu siç është, i mprehtë e i qartë. Kështu ka qenë gjithmonë që nga **krijimi i njeriut**.

Deri më sot, asnjë aparat vizual apo regjistruar i bërë nga njeriu nuk ka qenë aq i ndjeshëm dhe i suksesshëm në marrjen e të dhënave shqisore si syri dhe veshi. Mirëpo, për sa i përket të pamurit dhe të dëgjuarit, një e vërtetë shumë më madhështore qëndron pas gjithë kësaj.

Kujt i takon ndërgjegjja që sheh dhe dëgjon në brendi të trurit?

Kush shikon një botë joshëse në trurin tonë, dëgjon simfonitë dhe cicërimën e zogjve dhe ndien aromën e trëndafilut?

Nxitjet që vijnë prej syve, veshëve dhe hundës së një personi

shkojnë në tru si impulse nervore elektro-kimike. Në librat e biologjisë, fiziologjisë dhe biokimisë, mund të gjeni shumë hollësi për mënyrën se si ky imazh formohet në tru. Mirëpo, kurrë nuk do të mund të ndesheni me faktin më të rëndësishëm: Kush i pranon këto impulse nervore elektro-kimike si imazhe, tinguj, aroma dhe ngjarje shqisore në tru? **Ekziston një ndërgjegje në tru që i pranon gjithë këto pa ndier ndonjë nevojë për një sy, vesh apo hundë.** Kujt i takon kjo ndërgjegje? Natyrisht se nuk u takon nervave, shtresës yndyrore dhe neuroneve që e përbëjnë trurin. Kjo është arsyeja pse darvinistët-materialist, të cilët besojnë se gjithçka përbëhet prej materies, nuk mund të japin përgjigje në këto pyetje.

Sepse **kjo ndërgjegje është shpirti i krijuar prej All-llahut**, i cili nuk ka nevojë as për syrin për të shikuar imazhet dhe as për veshin për t'i dëgjuar tingujt. Për më tepër, nuk ka nevojë për trurin për të menduar.

Çdo njeri që e lexon këtë fakt të qartë shkencor do të duhej të mendonte thellë për All-llahun e Gjithëfuqishëm dhe të ketë frikë dhe të kërkoj strehim tek Ai, sepse Ai ngjesh tërë gjithësinë në një vend plotësisht të errët prej disa centimetrave kub në një formë tre-dimensionale, me ngjyra, me hije dhe të ndritshme.

Një besim materialist

Informacioni që kemi paraqitur deri tani tregon se **teoria e evolucionit është një pretendim që bie hapur në kundërshtim me faktet shkencore.** Pretendimi i teorisë në lidhje me prejard-

hjen e jetës është në kundërshtim me shkencën, mekanizmat e evolucionit të propozuara nga kjo teori nuk kanë asnjë forcë evolutive, dhe fosilet tregojnë se **format e nevojshme kalimtare nuk kanë ekzistuar kurrë**. Prandaj, teoria e evolucionit duhet të hidhet poshtë si një ide joshkencore. Në këtë mënyrë shumë ide, si modeli i gjithësisë me qendër Tokën, janë nxjerrë jashtë agjendës së shkencës gjatë historisë.

Por teoria e evolucionit vazhdon të mbahet me vendosmëri në listën e teorive shkencore. Disa njerëz madje përpiqen t'i paraqesin kritikën në adresë të saj si "sulm ndaj shkencës". Po pse ndodh kjo gjë?

Arsyeja është se kjo teori është situatë të krijuar është një besim dogmatik i domosdoshëm për disa qarqe. Këto qarqe **janë verbërisht besnike ndaj** filozofisë materialiste dhe e pranojnë darvinizmin sepse ai është shpjegimi i vetëm materialist që mund të prezantohet për të shpjeguar funksionimin e natyrës.

Është mjaft interesant fakti se ata e pranojnë këtë fakt po ashtu kohë pas kohe. Një gjeneticist i mirënjohur dhe evolucionist i hapur, Richard C. Lewontin nga Univerziteti i Harvardit, pranon se ai është "në radhë të parë një materialist dhe më pas një shkencëtar":

Nuk është puna se metodat dhe institucionet e shkencës në njëfarë mënyre na detyrojnë të pranojmë një shpjegim material për botën, por përkundrazi, ne jemi të detyruar nga përkrahja jonë arbitrare e kauzës materialiste të krijojmë një aparat hetimi dhe një sërë konceptesh që japin shpjegime materiale, edhe nëse janë kundër intuitës, pa marrë parasysh se sa të mjegullta janë për të panisurën. Për

më tepër, materializmi është absolut, kështu që ne nuk mund të lejojmë një [ndërrhyrje] Hyjnore...20

Këto fjalë janë deklarata të qarta se **Darvinizmi është një dogmë** e mbajtur gjallë për hir të lidhjes me filozofinë materialiste. Sipas kësaj dogme asgjë nuk ekziston përveç materies. Prandaj, ajo predikon se materia e pajetë dhe e pavetëdijshme krijoi jetën. Ajo këmbëngul se miliona lloje të gjalla, (si zogjtë, peshqit, kafshët, insektet, pemët, lulet, balenat dhe qeniet njerëzore) u shfaqën si pasojë e bashkëveprimit të materies si shiut, rrufeve dhe kështu me radhë prej materies së pajetë. Ky besim është në kundërshtim të plotë si me arsyen ashtu edhe shkencën. Por darvinistët vazhdojnë të mbrojnë këtë besim me qëllim që të mos pranojnë, në sytë e tyre ekzistencën e Allahut.

Kushdo që nuk e shikon prejardhjen e gjallesave me paragjykim materialist do ta kuptojë këtë të vërtetë të qartë: **të gjitha gjallesat janë rezultat i krijimit të një Krijuesi**, i Cili zotëron fuqi, dije dhe inteligjencë superiore. Ky Krijues është All-llahu, i Cili krijoi tërë gjithësinë nga asgjëja, i Cili e konstrukttoi atë në mënyrën më të përkryer dhe u dha formë të gjitha gjallesave.

Teoria e evolucionit: Magjia më e fuqishme në botë

Çdo njeri i lirë prej paragjykimeve dhe ndikimit të çfarëdo lloj ideologjie, që përdor arsyen dhe logjikën e tij apo të saj, do të kuptojë qartë se besimi në teorinë e evolucionit, i cili na përkujton besëtytnitë e shoqërive pa dijeni të shkencës apo qytetërimit, është plotësisht i pamundshëm.

Siç u shpjegua më lartë, ata që besojnë në teorinë e evolucionit mendojnë se disa atome dhe molekula të hedhura në një fuçi të madhe do të mund të krijonin profesorë dhe studentë universiteti që janë në gjendje të mendojnë dhe gjykojnë; shkencëtarë si Ajnshtajni dhe Galileo; artistë si Hemfri Bogart, Frenk Sinatra dhe Luçano Pavaroti; si edhe antilopa, drurë limoni dhe karafila. Për më tepër, pasi që shkencëtarët dhe profesorët të cilët besojnë në këto gjepura janë njerëz të shkolluar, është krejtësisht e arsyeshme të flitet për këtë teori si për "magjinë më të fuqishme në histori." Asnjëherë më parë asnjë besim apo ide tjetër nuk ua ka larguar aftësinë e të gjykuarit të njerëzve, nuk ka pranuar t'i lejojë ata të mendojnë me mençuri dhe me arsye dhe ua ka fshehur të vërtetën sikur ata t'i kishin sytë e lidhur. Kjo është një verbëri madje edhe më e keqe dhe më e pabesueshme se adhurimi i zotit të Diellit Ra nga egjiptianët, adhurimi i totemeve në disa pjesë të Afrikës, adhurimi i Diellit nga populli i Sebes, adhurimi i idhujve që kishin mbaruar me duart e tyre nga ana e fisit të Profetit Ibrahim (paqja qoftë mbi të) apo adhurimi i Viçit të Artë nga ana e popullit të Profetit Musa (paqja qoftë mbi të).

Në të vërtetë, All-llahu ka theksuar këtë mungesë arsyeje në Kur'an. Në shumë vargje, Ai zbulon se mendjet e disa njerëzve do të jenë të mbyllura dhe se ata do të jenë të pafuqishme të shohin të vërtetën. Disa nga këto vargje jepen në vazhdim:

Sa për ata që mohojnë, njësoj është, i paralajmërove apo nuk i paralajmërove - ata nuk besojnë. All-llahu i ka vulosur zemrat e tyre, ndërsa në veshët dhe sytë e tyre kanë mbulesë; ata i pret një dënim i madh. (Surja Bekare: 6-7)

...ata kanë zemra, por nuk kuptojnë, kanë sy, por nuk shohin dhe kanë veshë, por nuk dëgjojnë. Ata janë si bagëtitë, madje edhe më zi. Pikërisht këta janë të shku-jdesurit. (Surja A'raf: 179)

Edhe sikur Ne t'u hapnim atyre një derë në qiell dhe të ngjiteshin vazhdimisht lart në të (e të shihnin engjëjt e fshehtësitë), ata vetëm do të thoshin: "Neve na janë ndalë sytë (të parët). Jo, ne jemi njerëz të magjepsur. (Surja Hixhr: 14-15)

Fjalët nuk mund ta shprehin se sa është e habitshme se si kjo magji ka arritur të mbajë një komunitet aq të gjerë në skllavëri, t'i largojë njerëzit nga e vërteta dhe të mos ndërpritet për 150 vjet. Është e kuptueshme se një apo disa njerëz do të mund të besonin në skenarë dhe pohime të pabesueshme përplot marrëzi dhe mungesë arsyeje. Mirëpo, "magjia" është shpjegimi i vetëm i mundshëm për njerëzit në mbarë botën që besojnë se atomet e pavetëdijshme dhe të pajetë papritur vendosën të bashkohen dhe të formojnë një gjithësi që funksionon me një sistem të organizimit, rregullit, arsyes dhe vetëdijes së përkryer; një planet të quajtur Tokë me të gjitha veçoritë e saj të përshtatura në mënyrë aq të përkryer për jetën; dhe gjallesat përplot sisteme të panumërta komplekse.

Në të vërtetë, Kur'ani rrëfen ngjarjen e Profetit Musa dhe Faraonit për të treguar se disa njerëz të cilët përkrahin filozofitë ateiste në të vërtetë ndikojnë tek të tjerët me anë të magjisë. Kur iu tha Faraonit për fenë e vërtetë, ai i tha Profetit Musa të ndeshet me magjistarët e tij. Kur Musai e bëri këtë, ai u tha atyre

që të tregojnë aftësitë e tyre të parët. Vargjet pasojnë:

“Hidhni ju!” – u përgjigj ai. Kur magjistarët hodhën shkopinj të tyre, i magjepsën sytë e njerëzve, i frikësuan ata dhe shfaqën një magji të madhe. (Surja A’raf: 116)

Siç kemi vënë re, magjistarët e Faraonit ishin në gjendje të mashtrojnë çdo njeri, përveç Musait dhe atyre të cilët i besuan atij. Mirëpo, dëshmia e tij zhduki magjinë, apo “gëlltiti atë që ata kishin sajuar,” siç përshkruhet në ajet.

Atëherë Ne i kumtuam Musait: “Hidhe shkopin tënd!” - dhe ai filloi të gëlltiste gjithçka që trilluan ata. Në këtë mënyrë, doli në shesh e vërteta dhe dështoi ajo që kishin bërë ata. (Surja A’raf: 117-118)

Siç mund të shohim, kur njerëzit e kuptuan se ata kishin genë të magjepsur dhe se ajo që panë ishte vetëm një iluzion, magjistarët e Faraonit humbën tërë besueshmërinë. Edhe në ditët tona po ashtu, përveç nëse ata të cilët, nën ndikimin e një magjie të ngjashme, besojnë në këto pretendime qesharake dhe kalojnë jetët e tyre duke i mbrojtur ato nën maskën e tyre shken-core, i braktisin besimet e tyre paragjykuese, ata po ashtu do të poshtërohen kur të shfaqet e vërteta e plotë dhe magjia të prishet. Në të vërtetë, Malkolm Magerixh, i cili ishte një ateist që mbrojti teorinë e evolucionit për rreth 60 vite, por i cili më pas e kuptoi të vërtetën, zbulon pozitën në të cilën do të gjendet teoria e evolucionit në të ardhmen e afërt me këto fjalë:

Unë personalisht jam i bindur se teoria e evolucionit, posaçërisht shtrirja e zbatimit të saj, do të jetë njëra prej shakave më të mëdha në librat e historisë në të ardhmen. Brezat e ardhshëm

do të çuditen se si një hipotezë aq jo bindëse dhe e dyshimtë ka mundur të pranohej me naivitetin e pabesueshëm që ajo përmban.²¹

Se e ardhmja nuk është larg: Përkundrazi, njerëzit së shpejti do ta shohin se “rasti” nuk është hyjni dhe do të shikojnë prapa në teorinë e evolucionit si në mashtrimin më të keq dhe magjinë më të tmerrshme në botë. Ajo magji tashmë ka filluar të ngrihet me shpejtësi prej shpatullave të njerëzve në mbarë botën. Shumë njerëz që e shohin fytyrën e saj të vërtetë po pyeten me habi se si është e mundur që të jenë kapluar prej saj.

*Engjëjt thanë: “Carg nga të metat je
Ti o Zot! Ne nuk kemi asnjë dije tjetër
përveç asaj që na mësove Ti. Vërtet,
Ti je i Gjithëditjshëm e i Urtë.”*

(Sure Bekare: 32

NOTES

1. Sidney Fox, Klaus Dose, *Molecular Evolution and The Origin of Life*, E.H. Freeman and Company, San Francisco, 1972, p. 4.
2. Alexander I. Oparin, *Origin of Life*, Dover Publications, NeëYork, 1936, 1953 (reprint), p. 196.
3. "Neë Evidence on Evolution of Early Atmosphere and Life", *Bulletin of the American Meteorological Society*, vol 63, November 1982, p. 1328-1330.
4. Stanley Miller, *Molecular Evolution of Life: Current Status of the Prebiotic Synthesis of Small Molecules*, 1986, p. 7.
5. Jeffrey Bada, *Earth*, February 1998, p. 40
6. Leslie E. Orgel, "The Origin of Life on Earth", *Scientific American*, vol. 271, October 1994, p. 78.
7. Charles Darëin, *The Origin of Species by Means of Natural Selection*, The Modern Library, Neë York, p. 127.
8. Charles Darëin, *The Origin of Species: A Facsimile of the First Edition*, Harvard University Press, 1964, p. 184.
9. B. G. Ranganathan, *Origins?*, Pennsylvania: The Banner Of Truth Trust, 1988, p. 7.
10. Charles Darëin, *The Origin of Species: A Facsimile of the First Edition*, Harvard University Press, 1964, p. 179.
11. Derek A. Ager, "The Nature of the Fossil Record", *Proceedings of the British Geological Association*, vol 87, 1976, p. 133.
12. Douglas J. Futuyma, *Science on Trial*, Pantheon Books, Neë York, 1983. p. 197.
13. Solly Zuckerman, *Beyond The Ivory Toëer*, Toplinger Publications, Neë York, 1970, pp. 75-94; Charles E. Oxnard, "The Place of Australopithecines in Human Evolution: Grounds for Doubt", *Nature*, vol 258, p. 389.
14. "Could science be brought to an end by scientists' belief that they have final ansëers or by society's reluctance to pay the bills?" *Scientific American*, December 1992, p. 20.
15. Alan Äalker, *Science*, vol. 207, 7 March 1980, p. 1103; A. J. Kelso, *Physical Anthropology*, 1st ed., J. B. Lipincott Co., Neë York, 1970, p. 221; M. D. Leakey, *Olduvai Gorge*, vol. 3, Cambridge University Press, Cambridge, 1971, p. 272.
16. Jeffrey Kluger, "Not So Extinct After All: The Primitive Homo Erectus May Have Survived Long Enough To Coexist Äith Modern Humans," *Time*, 23 December 1996.
17. S. J. Gould, *Natural History*, vol. 85, 1976, p. 30.
18. Solly Zuckerman, *Beyond The Ivory Toëer*, p. 19.
19. Richard Leëontin, "The Demon-Haunted Eördl," *The Neë York Revieë of Books*, January 9, 1997, p. 28.